NOMI I-DYTË

NOMI I-DYTË

Kthyerë prej Evraishtesë

MANASTIR

Shtypëshkronja Treg. Nërkombëtare

1912

NOMI I-DYTË

Krye 1.

1 Këto janë fjalëtë që i foli Moisiu gjithë
Israilit mbë këtʼ anë të Jordanit, ndë shkre-
tëtirët, ndë Arabahët*) kundrejt Sufit, ndë mest
të Paranit, e Tofelit, e Llabanit, e Hazero-
2 thit, e Di-zahabit. Është një-mbë-dhjetë dit
udhë nga Horibi, prej udhës' së malit Seir,
e gjer ndë Kadesh-barni.
3 Edhe të-dyzettinë vit, të-një-mbë-dhjettinë
muaj, të-parënë *ditë* të muajt, u foli Moisiu
të bijvet të Israilit, pas gjithʼ atyreve që e kish
4 urdhëruarë Zoti për ata; Passi vrau Sihoninë,
mbretinʼ e Amoritëvet, i-cili rrinte ndë He-
shbon, edhe Ogunë, mbretinʼ e Bashanit, i-cili
5 rrinte ndë Astaroth, ndë Edrei; Mbë këtʼ anë
të Jordanit, ndë dhet të Moabit, Moisiu zuri
të rrëfente këtë nom, dyke thënë:
6 Zoti, Perëndia ynë, na foli ndë Horib, e
na tha, Mjaft kini ndënjurë ndë këtë mal;
7 Kthehi, e mirrni udhënë tʼ uaj, edhe shkoni
ndë malësit të Amoritëvet, edhe ndër gjithë
vëndet aty afërë, ndë fushët, ndë malësit, e
ndë vëndet të-unjurë, e ndë *anët* të mes-di-
tësë, e ndë buzët të detit, ndë dhet të Hanaa-
nitëvet, e ndë Libant, gjer ndë lumët të-math,

*) Kështu thuhetë fushʼ e-thellë që shtrihetë ndë go-
rent e ndë mesditët të Detit të-Vdekurë.

8 ndë lumët Evfrat. Na unë tek e vura dhenë
përpara jush; hyni e pushtoni *atë* dhe, për
të-cilinë Zoti upërbetua atërvet t' uaj, Abraa-
mit, Isaakut, e Jakobit, t' u'a apë atyre, edhe
9 farës' s' atyre pas atyre. Edhe nd' atë kohë
u thashë juve, dyke thënë, Vetem' unë nukë
10 munt t'u mbanj juve; Zoti, Perëndia juaj, u
shumoj juve, edhe na sot tek jeni si yjt' e
11 qiellit ndë shumicët. Zoti, Perëndia i atërvet
t' uaj, u bëftë juve një mijë herë më tepërë
se sa jeni, edhe u bekoftë juve, sikundrë u-
12 zotua juve! Si munt unë i-vetëmë të mbanj
trubullimnë t' uaj, e barrënë t' uaj, e të-zë-
13 natë t' uaj? Merrni njerës të-urtë, e të-mën-
çim, e të-njohurë ndë mest të faravet t' uaj,
14 edhe dot' i vë ata të-parë mbi ju. Edhe m'
upërgjeqtë, e *më* thatë, Puna që the është' e-
15 mirë *për ne* t'a bëjmë. Kështu mora të-
parët' e faravet t' uaj, burra të-urtë, edhe të-
njohurë, edhe i vura ata të-parë mbi ju, krye-
mijës, e kryeqindës, e kryepesëdhjetës, e
kryedhjetës, edhe offiqarë, sipas faravet t'
16 uaj. Edhe urdhërova gjykatësitë t' uaj atëhere,
e u thashë, Dëgjoni punëratë ndë mest të
vëllezërvet t' uaj, edhe gjykoni drejtë ndë
mest të njeriut e të vëllajt t' ati, e të të-huajit
17 që është bashkë me atë. Ndër gjyq s' kini
për të shikuarë ndë faqe njeriu; dotë dë-
gjoni të-vogëlinë posi të-madhinë; nukë do-
të trëmbi nga faqeja e njeriut; sepse gjyqi

ësht' i Perëndisë; edhe *çdo* punë që të jetë
shum' e-vështirë te ju, dot'a bini tek unë, edhe
18 unë dot'a dëgjonj. Edhe u urdhërova juve a-
tëhere për gjithë ato që duhej të bënitë.
19 Edhe ungritmë nga Horibi, edhe shkuamë
ndëpër gjith' atë shkretëtirët të-madhe e të-
frikshime, që patë, dyke bërë udhë për ndë
malësit t' Amoritëvet, sikundrë na urdhëroj
Zoti, Perëndia ynë; edhe erthmë gjer ndë
20 Kadesh-barni. Edhe u thashë juve, Erthtë
gjer ndë malësit t' Amoritëvet, që po na ep
21 neve Zoti, Perëndia ynë. Na Zoti, Perëndia
juaj, tek e ka vënë dhenë përpara teje; hipë,
e pushto *atë*, sikudrë të foli Zoti, Perëndia i
atërvet të tu; mos ufrikëso, as mos utrëmp.
22 Edhe ju, sicilido prej jush, erthtë tek unë e
thatë, Letë dërgojmë njerës përpara nesh, që
t'a përgjonjënë dhenë për ne, edhe të na bje-
në prapë fjalë për udhënë, nga e-cila duhetë
të hipëjmë, edhe për qytetetë, ndë të-cilët kemi
23 për të vaturë. Edhe fjala më pëlqeu, edhe mora
prej jush dy-mbë-dhjetë burra, një burrë për
24 farë. Edhe shkuanë, edhe ungjitnë ndë malt,
edhe erthnë gjer ndë fushët të Eshkollit, edhe
25 e përgjuanë. Edhe muarrë ndë duart të tyre
prej pemëvet të dheut, edhe na i prunë po-
shtë, edhe na prunë zë, dyke thënë, I-mirë
është dheu që po na ep Zoti, Perëndia ynë.
26 Po ju nukë deshtë të ngjiteshitë, po
ndënjtë kundrë urdhërit të Zotit, Perëndisë

27 t' uaj. Edhe murmuristë ndër tendat t' uaj,
dyke thënë, Me-qënë-që Zoti na kishte cmir,
përandaj na nxori nga dheu i Egjyptësë, që
të na apë ndë dorët të Amoritëvet, edhe të
28 na shuanjë. Ku po ngjitemi neve? vëllezëritë
t' anë na bënë zëmërënë të tretetë, dyke thë-
në, Gjindja është më e-madhe e më e-lartë
se neve; qytetetë janë të-mëdhenj e të-thururë
me mur gjer ndë qiell; po edhe të bijt' e A-
naqimëvet i pam' atje.
29 Atëhere un' u thashë juve, Mos trëmbi, as
30 mos kini frikë nga ata; Zoti, Perëndia juaj
që shkon përpara jush, ay dotë luftonjë për
ju, pas gjith' atyreve që bëri për ju nd' E-
31 gjyptë përpara syvet t' uaj; Edhe ndë shkre-
tëtirët, ku pe me ç' mënyrë të mbajti Zoti,
Perëndia yt, sikundrë mban njeriu të birr' e
ti, ndë gjithë udhët që ectë, gjersa erthtë ndë
këtë vënt.
32 Po me gjithë këtë nuk' i besuatë Zotit,
33 Perëndisë t' uaj, Qi shkonte përpara jush nd'
udhët, që t' u gjente vënt për të ngulurë ten-
datë t' uaj, natënë me zjarr, që t' u dëftente
juve mbë ç' udhë duhej të ecënitë, edhe ditë-
në më re.
34 Edhe Zoti dëgjoj zën' e fjalëvet t'uaj, edhe
35 uzëmërua, e bëri be, dyke thënë, Me të-vër-
tetë asndonjë nga këta njerës të këti brezi
të-keq s' ka për të par' atë dhen' e-mirë, për
të-cilin' upërbetuashë [redacted] ap atërvet t' uaj,

36 Veç Halebi, i bir' i Jefunniut, e ka për të pa-
rë; edhe këti j'a kam për të dhënë dhenë,
mbi të-cilinë shkeli, edhe të bijvet t' ati; se-
37 pse ky i-tërë vate pas Zotit. Edhe kundrë
meje uzëmërua Zoti për ju, e *më* tha, As ti
38 s' ke për të hyrë atje; Joshuaj, i bir' i Naviut,
që rri përpara teje, ky ka për të hyr' atje;
forco-e atë; sepse ay e ka për të bërë Isra-
39 ilinë t'a trashëgonjë atë *dhe.* Edhe të-vegjë-
litë t' uaj, për të-cilëtë thoshitë se i kanë për
të bërë plaçkë, edhe bijtë t' uaj, të-cilëtë sot
nukë njohënë të-mirë a të-ligë, ata dotë hy-
njënë atje, edhe atyre dot' u'a ap atë, edhe
40 dot' e trashëgonjënë. Po ju kthehuni e shkoni
ndë shkretëtirët, nga udha që shpje ndë Det
të-Kuq.

41 Atëhere upërgjeqtë, e më thatë, Fëjyemë
kundrë Zotit; neve dotë ngjitemi e dotë luf-
tojmë, pas gjith' atyreve, që na urdhëroj Zoti,
Perëndia ynë. Edhe si ngjeshtë gjithësicili
armët' e luftësë, ishitë gati për të ungjiturë
42 ndë malt. Edhe Zoti më tha, Thuaj-u aty-
reve, Mos ungjitni, as mos luftoni; sepse unë
nukë jam ndë mest t' uaj; që të mos thyhi
përpara armiqvet t' uaj.

43 Kështu u fola juve, edhe nukë dëgjuatë;
po ngritte krye kundrë urdhërit të Zotit, edhe
44 plot me madhështi ungjittë ndë malt. Edhe
Amoritëtë, që rrininë nd' atë mal, duallë kun-
drë jush, edhe u ndoqnë juve, si bënjënë ble-

tëtë, edhe u ranë juve ndë Seir, gjer ndë
45 Hormah. Atëhere ukthyetë e qatë përpara
Zotit; po Zoti nuk' i dëgjoj zërit t' uaj, as u'a
46 vuri veshnë. Kështu mbettë ndë Kadesh shu-
më dit, pas ditvet që mbettë atje.

Krye 2.

1 Atëhere ukthyemë, e muarmë udhë për ndë
shkretëtirët nga udha që shpje ndë Det të-
Kuq, sikundrë më foli Zoti; edhe silleshimë
2 përqark malit Seir shumë dit. Edhe Zoti më
foli e *më* tha, Usuailtë mjaft *kohë* përqark
3 këti mali; kthehi nga an' e borësë; Edhe ur-
4 dhëro gjindjenë, e *i* thuaj, Dotë shkoni ndë-
për sinorët të vëllezërvet t' uaj, të bijvet të
Isafit, të-cilëtë rrinë ndë Seir; edhe dotë kenë
5 frikë nga ju; po vini re mirë; Mos luftoni
me ata; sepse s' u kam për të dhënë juve
nga dheu i atyre as sa shkel sholla e këm-
bësë; sepse Isafit j'a kam dhënë malin' e Se-
6 irit për trashëgim. Dotë blini nga ata të-
ngrëna me ergjënt, që të hani; po edhe ujë
dotë blini nga ata me ergjënt, që të pini.
7 Sepse Zoti, Perëndia yt, të bekoj ndë gjithë
punërat të duarvet të tua; e njeh të-udhëtu-
arëtë t' ënt ndëpër këtë shkretëtirë të-madhe;
këta të dyzet vjet Zoti, Perëndia yt, ish ba-
shkë me ty; nukë t' ushter asgjë.
8 Edhe passi shkuamë ndëpër vëllezëritë
t' anë, të bijt' e Isafit, që rrininë ndë Seir,

nga udha e Arabahësë, nga Ellathi e nga Ezion-gaberi, ukthyemë e shkuamë ndëpër
9 udhët të shkretëtirës' së Moabit. Edhe Zoti më tha, Mos nga Moabitëtë, as mos hyrë ndë luftë me ata; sepse s' të kam për të dhënë nga dheu i atyreve për trashëgim; sepse të bijvet të Llotit u'a kam dhënë Arinë
10 për trashëgim. (Më përpara rrininë nd' atë Emimëtë, një gjindje e-madhe edhe e-shumë,
11 edhe e-gjatë *ndë shtatt*, posi Anaqimetë; Edhe këta numëroneshinë *për* Refaimë, posi Anaqi-
12 mëtë; po Moabitëtë i quaninë Emimë. Edhe Horitëtë rrininë më përpara ndë Seir; po të bijt' e Isafit i trashëguan' ata, edhe i shuanë që përpara atyreve, edhe ndënjnë ndë vëntt t' atyre; sikundrë bëri Israili ndë dhet të tra-
13 shëgimit, të-cilin' u'a dha atyre Zoti.) Ngrehuni pra, edhe kapërxeni përruan' e Zeredit.
14 Edhe kapërxyemë përruan' e Zeredit. Edhe dittë që bëmë dyke udhëtuarë që nga Kadeshbarnia e gjer sa kapërxyemë përruan' e Zeredit ishinë tri-dhjet' e tetë vjet, gjersa ushua gjithë brezi i burravet luftëtarë nga mezi i fushatësë, sikundrë u upërbetua Zoti atyre.
15 Po edhe prapë dor' e Zotit ishte kundrë atyreve, për të prishur' ata nga mezi i fushatësë, gjersa s' mbetnë më.
16 Edhe passi ushuanë gjithë burratë luftë-
17 tarë, dyke vdekurë nga mezi i gjindjesë, Zoti
18 më foli, e *më* tha, Ti sot dotë kapëtonjç A-

19 rinë, sinorin' e Moabit; Edhe kur të afëronesh
kundrejt të bijvet të Ammonit, mos i nga ata,
as mos lufto me ata; sepse s' të kam për të
dhënë nga dheu i të bijvet t' Ammonit për
trashëgim; sepse u'a dhashë të bijvet të Llotit
20 për trashëgim. (Edhe ay vënt numëronej i Refa-
imëvet; Refaimë rrininë atje më përpara; po
21 Ammonitët' i quaninë ata Zamzummimë; *Këta*
ishinë një gjindje e-madhe, edhe e-shumë,
edhe e-gjatë *ndë shtatt*, si Anaqimëtë; po Zoti
i prishi ata që përpara atyre, edhe ata i
trashëguanë, edhe ndënjnë ndë vëntt t'atyre;
22 Sikundrë u'a bëri të bijvet të Isafit, që rri-
ninë ndë Seir, kur prishi Horitëtë që përpara
atyrëve; edhe i trashëguan' ata edhe ndëjnë
23 ndë vëntt t' atyre gjer mbë këtë ditë. Edhe
sapër Avvimëtë që rrininë ndër fshatra gjer
ndë Gazët, Kaftorimëtë, që duallë nga Kaftori,
i prishn' ata, edhe ndënjnë ndë vëntt t' atyre.)
24 Ngrihi e merrni udhë, edhe kapërxeni fushën'
e Arnonit; na tek t'a dhashë ndë dorë Sihon
Amoritnë, mbretn' e Heshbonit, edhe dhen' e
25 ati; zërë t'a pushtonjç, edhe lufto me atë. Sot
dotë zë t'u shtje dridhjenë t' ënde e frikënë t'
ënde kombevet që janë ndënë gjithë qiellinë,
të-cilëtë dotë dëgjonjënë emërinë t' ënt, edhe
dotë dridhenë, e dotë bjenë ndë shtrëngim
të-keq për punë t' ënde.
26 Edhe dërgjova lajmës nga shkretëtira e
Qedemothit te Sihoni, mbreti i Heshbonit, me

27 fjalë paqtimi, dyke thënë, Letë shkonj ndë-
për dhet t' at; kam për të shkuarë drejt u-
dhës së-madhe; nukë dotë prirem mbë të-
28 djathtë a mbë të-mëngjërë. Dotë më shesç të-
ngrëna me ergjënt, që të ha; edhe dotë më
apç të-pira me ergjënt, që të pi; vetëmë lë-
29 më të shkonj me këmbët' e mia, Sikundrë
bënë për mua të bijt' e Isafit që rrinë ndë Seir,
edhe Moabitëtë që rrinë ndë Ar, gjersa të
kapërxenj Jordaninë *e të vete* nd' atë dhe që
30 na ep Zoti, Perëndia ynë. Po Sihoni, mbreti
i Heshbonit, nukë desh të na lërë të shko-
nimë ndëpër dhet t' atij; sepse Zoti, Perën-
dia yt, i ashpëroj frymënë, edhe i nguroj zë-
mërënë, që t'a epte ndë duart të tua, posi *e*
shikon ndë këtë ditë.
31 Edhe Zoti më tha, Na tek zura të *t'* ap
ndë dorë Sihonë edhe dhen' e ati përpara
teje; zërë të pushtonjç, që të trashëgonjç
32 dhen' e ati. Atëhere Sihoni dolli kundrë nesh,
ay edhe gjithë gjindj' e atij, për të luftuarë
33 ndë Jahaz. Edhe Zoti, Perëndia ynë, na e dha
ndë dorë përpara nesh; edhe e vram' atë,
edhe të bijt' e ati, edhe gjithë gjindjen' e ati.
34 Edhe muarmë nd' atë kohë gjithë qytetet' e
atij, edhe prishmë fare çdo qytet, me burrat'
e me grat' e me të-vegjëlitë; nukë lamë të
35 mbesë asgjë; Vetëmë bagëtitë plaçkitmë për
vetëhenë t' ënë, bashkë me plaçkat' e qyte-
36 tevet që pushtuamë. Që nga Aroeri, që është

ndë buzët të fushës' s' Arnonit, edhe që nga qyteti që është ndë fushët, edhe gjer ndë Gillead, nuk' ugjënt qytet *që të ishte* fort i-lartë për ne; Zoti, Perëndia ynë, na i dha ndë dorë
37 të-gjitha përpara nesh; Vetëmë ndë dhet të bijvet t' Ammonit nuk' uafërove, as ndë gjithë buzët të lumit të Jabbokut, as ndë qytetet të malësisë, as ndë ndonjë tjetërë *vënt*, që nukë na la Zoti, Perëndia ynë, *t'a pushtojmë.*

Krye 3.

1 Atëhere ukthyem' edhe ungjitmë udhës' së Bashanit; edhe Ogu, mbreti i Bashanit, dolli kundrë nesh, ay edhe gjithë gjindj' e ati, për
2 të luftuarë ndë Edrei. Edhe Zoti më tha, Mos ki frikë nga ay; sepse t'a kam dhënë ndë dorë atë, edhe gjithë gjindjen' e atij, edhe dhen' e atij; edhe dot' j'a bënjç atij, sikundrë j'a bëre Sihonit, mbretit të Amoritëvet, i-cili
3 rrinte ndë Heshbon. *Kështu* Zoti, Perëndia ynë, na dha ndë dorë edhe Ogunë, mbretin' e Bashanit, edhe gjithë gjindjen' e atij; edhe e vram' atë, gjersa nuk' i mbeti atij asndonjë
4 *njeri.* Edhe muarmë gjithë qytetet' e ati nd' atë kohë; nukë mbeti qytet që nuk' e muarmë nga ata; gjashtë-dhjetë qytete, gjithë dhenë rreth e rrotull' Argobit, mbretërin' e
5 Ogut ndë Bashan. Gjithë këta qytete ishinë thururë me mure të-lartë, me dyer e me lloze: përveç shumë qyteteve të-pathururë me

6 mure. Edhe fare i prishmë ata, sikundrë j'a
bëmë Sihonit, mbretit të Heshbonit, dyke pri-
shurë çdo qytet, me burra, me gra e me të-
7 vegjëlë. Po gjithë bagëtitë, edhe plaçkat' e qy-
tetevet i plaçkitmë për vetëhenë t' ënë.
8 Edhe nd' atë kohë muarmë nga duart' e
të dy mbretërvet të Amoritëvet dhenë mbë
këť anë të Jordanit, që nga fusha i Arnonit
9 e gjer ndë malt të Hermonit; (Sidonasitë qu-
anjënë Hermoninë Sirion edhe Amoritët' e
10 quanjënë Shenir;) Gjithë qytetet' e fushësë,
edhe gjithë Gileadinë, edhe gjithë Bashani-
në, gjer ndë Sallka e ndë Edrei, qytete të
11 mbretëris' së Ogut ndë Bashan. (Sepse vetem
Ogu, mbreti i Bashanit, kishte mbeturë nga
Refaimëtë që kishinë mbeturë; na shtrati i ati
tek ishte shtrat i-hekurtë; a nuk' ësht' ay
ndë Rabba të bijvet të Ammonit? ishte nëntë
kut i-gjatë, edhe katrë kut i-gjerë, pas kutit
të burrit.)
12 Edhe atë dhe që pushtuamë nd' atë kohë,
që nga Aroeri, që është përanë fushës' s' Ar-
nonit, edhe gjysmën' e malësis' së Gileadit,
edhe qytetet' e atij, u'a dhashë Rubinitëvet e
13 Gaditëvet. Edhe ç' mbeti nga Gileadi, edhe
gjithë Bashaninë, mbretërin' e Ogut, j'a dha-
shë gjysmës' së farës' së Manashehut, gjithë
dhenë rreth e rrotull' Argobit, po, gjithë
14 Bashaninë, që quhej dheu i Refaimëvet. Jairi,
i bir' i Manassehut mori gjithë vëndinë për-

qark Argobit, gjer ndë sinorët të Gjeshuritëvet e të Maakathitëvet, edhe i quajti ata, po, Bashaninë, pas emërit të ti, Havvoth-jair, gjer
15 mbë këtë ditë. Edhe Mahirit i dhashë Gile-
16 adinë. Edhe Rubinitëvet e Gaditëvet u dhashë që nga Gileadi e gjer ndë fushët të Arnonit, mezin' e fushësë edhe sinorin' e asaj edhe gjer ndë lumët të Jabbokut, sinorit të
17 bijvet t' Ammonit; Edhe Arabahënë, edhe Jordaninë, edhe sinorin' e ati që nga Qinerethi e gjer ndë dett të Arabahësë, *ndë* Dett të-Kripurë, ndënë të-tatëpjetat të Pisgahut nga an' e lindjesë.

18 Edhe nd' atë kohë u urdhërova juve, e *u* thashë, Zoti, Perëndia juaj, u dha juve këtë dhe që t'a pushtoni atë; dotë shkoni t' armatosurë përpara vëllezërvet, të bijvet të I-
19 srailit, *ju* gjithë burrat' e-fortë; Po gratë t' uaj, edhe të-vegjëlitë t' uaj, e bagëtitë t' uaj, (e di se kini shumë bagëti,) dotë mbetenë ndër
20 qytetet t' uaj që n dhashë juve; Gjersa t' u apë Zoti të-prëjturë vëllezërvet t' uaj, sikundrë *edhe* juve, edhe të pushtonjën' edhe *ata* dhenë që u dha atyre Zoti, Perëndia juaj, përtej Jordanit; edhe *atëhere* dotë kthehi çdo njeri ndë trashëgimt të tij, që u dhashë juve.

21 Edhe nd' atë kohë urdhërova Joshuanë, e *i* thashë, Syt' e tu panë gjithë sa u bëri Zoti, Perëndia juaj, këtyre të dy mbretërve; kështu dot' u'a bënjë Zoti gjith' *atyre* mbretërive,

22 ndër të-cilat shkon. Nukë dot' u kini frikë
atyre; sepse Zoti, Perëndia juaj, ay dotë luf-
tonjë për juve.
23 Edhe i uluçë Zotit nd' atë kohë, e *i* thashë,
24 O Zot, o Perëndi, ti zure t' i dëftenjç shër-
bëtorit t' ënt madhërinë t' ënde, edhe dorënë
t' ënde të-fortë; sepse cili perëndi është ndë
qiellt a ndë dhet, që munt të bënjë pas të-
punnaravet të tua, edhe pas punëravet të tua
25 të-forta. Të lutem, letë shkonj e letë shoh
atë dhen' e-mirë, që është përtej Jordanit,
26 atë malin' e-mirë, edhe Libaninë. Po Zoti u-
zëmërua kundrë meje për punë t' uaj, edhe
nukë më dëgjoj; edhe Zoti më tha, Është
mjaft për ty; mos më flasç më për këtë punë;
27 Hipë ndë majët të Pisgahut, edhe ngre syt'
e tu nga an' e të-perënduarit, e nga an' e bo-
rësë, e nga an' e mesditësë, e nga an' e të-
lindurit, edhe vështro me syt' e tu; sepse s'
28 e ke për të kapërxyerë këtë Jordaninë. Po
porosit Joshuanë, edhe ep-i zëmërë atij, edhe
forco-e atë; sepse ay dotë shkonjë përpara
kësaj gjindjeje, edhe ay dot' i bënjë ata të
trashëgonjënë dhenë që dotë shohç.
29 Edhe kështu rrinimë ndë fushëzët kun-
drejt Beth-peorit.

Krye 4.

1 Tashi pra, pa dëgjo, o Israil, urdhërimet'
e gjyqetë, që dot' u mësonj juve t' i bëni, që

të rroni, e të hyni, e të trashëgoni dhenë, që
po u ep juve Zoti, Perëndia i atërvet t' uaj.
2 Ndë fjalët që u urdhëronj juve s' keni për të
shtuarë, as keni për të pakësuarë gjë nga
ajo, që të muntni të ruani urdhërimet' e Zotit,
Perëndisë t' uaj, që u urdhëronj unë juve.
3 Sytë t' uaj panë ç' bëri Zoti për punë të
Baall-peorit, sepse gjith' ata njerës që vanë
pas Baall-peorit Zoti, Perëndia juaj, i shoj
4 nga mezi juaj. Po ju që jeni ngjiturë pas
Zotit, Perëndisë t' uaj, të-gjithë po rroni sot.
5 Na unë tek u mësova juve urdhërime e
gjyqe, sikundrë më urdhëroj Zoti, Perëndia
im, që të bëni kështu ndë mest të dheut, ndë
6 të-cilët po hyni, që t'a trashëgoni. Ruani pra
edhe bëni ato; sepse këjo është dituria juaj
edhe urtësia juaj përpara syvet të kombevet,
të-cilëtë dotë dëgjonjënë gjithë këta urdhëri-
me, edhe dotë thonë, Me të-vërtetë gjindje e-
7 urtë e e-mënçime qënka ky komp i-math. Sepse
cili komp i-math ësht' ay që ka një perëndi
kaqë afërë vetëhes' së ti, sa është Zoti, Pe-
rëndia ynë, çdo herë që thërresëmë mbë atë?
8 Edhe cili komp i-math ësht' ay që ka urdhë-
rime e gjyqe kaqë të-drejtë, sa është gjithë
ky nom që po vë unë sot përpara jush?
9 Vetëmë vështro vetëhenë t' ënde, edhe ruaj
shpirtinë t' ënt me kujdes, semos harronjç
punëratë që panë syt' e tu, edhe ndahenë ato
nga zëmëra jote për gjithë ditt' e jetësë s'

ate; edhe bej-u'a ato të-njohura t'ët bijve, edhe
10 bijvet të bijvet të tu. *Kujto* atë ditë që qëndrove përpara Zotit, Perëndisë t' ënt, ndë Horib, kur më tha Zoti, Mblith-më gjindjenë, edhe dot' i bënj ata të dëgjonjënë fjalët' e mia, që të mësonenë të më kenë frikë gjithë dittë që *dotë*rronjënë mbi dhet, edhe të mësonjë-
11 në djemt' e tyre. Edhe ju uafëruatë e qëndruatë ndënë malt; edhe mali digjej flakë gjer ndë mest të qiellit, edhe *ishte* errësirë, *e* re,
12 edhe errësir' e-dëndurë. Edhe Zoti u foli juve nga mezi i zjarrit; ju e dëgjuatë zën' e fjalëvet, po nukë patë ndonjë fytyrë; vetëmë një-
13 zë *dëgjuatë.* Edhe u çfaqi juve *atë* dhiatën' e tij, që u urdhëroj juve të bëni, të-dhjetë porositë; edhe i shkroj ato mbi dy rrasa të-
14 gurta. Edhe nd' atë kohë Zoti me urdhëroj t'u mësonj juve urdhërime e gjyqe, që t' i bëni nd' atë dhe që po shkoni për të pushtuar' atë.

15 Ruani pra mirë shpirtëratë t' uaj; (sepse nukë patë ndonjë farë fytyre atë ditë që u
16 foli Zoti ndë Horib nga mezi i zjarrit;) Semos prishi, e bëni për vetëhenë t' uaj idhull të-gdhëndurë ndë fytyrë figure, ndë të-për-
17 gjajtnrë mashkulli a femëre, Ndë të-përgjajturë ndonjë bagëtie që është mbi dhet, ndë të-përgjajturë shpesi fluturak që fluturon ndë
18 qiellt, Ndë të-përgjajturë ndonjë shtërpiri mbi dhet, ndë të-përgjajturë ndonjë peshku që

19 është ndë ujërat ndënë dhet; Edhe semos ngrehç syt' e tu ndë qiellt, e shohç djellinë, e hënënë, e yjtë, po, gjithë ushtërin' e qiellit, edhe gënjenesh e u falesh atyre, e i lusç ato, të-cilatë Zoti, Perëndia yt, i përndau ndëpër gjithë kombet *që janë* ndënë gjithë
20 qiellinë. Po juve u mori Zoti, e u nxori nga kumina e-hekurtë, nga Egjypta, që të jeni tek ay gjindje trashëgimi, gjer mbë këtë ditë.
21 Edhe Zoti uzëmërua kundrë meje për punë t' uaj, edhe upërbetua të mos e kapërxenj unë Jordaninë, e të mos hynj nd' atë dhe të-mirë, që po të ep Zoti, Perëndia yt, për tra-
22 shëgim; Po unë duhetë të vdes ndë këtë dhe; unë nukë dot' e kapërxenj Jordaninë; po ju dot' e kapërxeni, e dotë trashëgoni atë dhe të-mirë.
23 Vini re vetëhenë t' uaj, semos harroni dhiatën' e Zotit, Perëndisë t' uaj, që bëri me ju, e bëni për vetëhenë t' uaj idhull të-gdhëndurë ndë fytyrë ndonjë gjëje, të-cilën' e ka nda-
24 luarë Zoti, Perëndia yt. Sepse Zoti, Perëndia yt, është zjarr që djek, Perëndi zilitar.
25 Si të pjellç djem, edhe djem të djemvet, edhe të bëni shumë vjet nd' atë dhe, ndë uprishçi e të bëni idhull të-gdhëndurë ndë fytyrë ndonjë gjëje, e të punoni atë që është e-ligë ndë syt të Zotit, Perëndisë t' ënt, që
26 t'a zëmëroni atë, Thërres qiellin' edhe dhenë të dëshmonjënë kundrë jush sot, se dotë

humpni fare nga ay dhe, për të-cilinë kapërxeni Jordaninë që t'a pushtoni atë; nukë dotë keni dit të-gjata nd' atë, po fare dotë shuhi.
27 Edhe Zoti dot' u përndanjë juve ndë mest të gjindjevet, edhe dotë mbeti të-pakë nga numëri ndër mest të kombevet, ndë të-cilët u
28 bje juve Zoti. Edhe atje dotë lutni perëndira, *që janë* punë duarsh njerësve, dru e gur, të-cilëtë nukë shohënë, as nukë dëgjonjënë, as nukë hanë, as *me hundë* marrënë erë.
29 Po që andej ndë e kërkofshi Zotinë, Perëndinë t' uaj, dot'a gjeni atë, ndë e kërkofshi me gjithë zëmërënë t' uaj, e me gjithë
30 shpirtinë t' uaj. Kur të gjëndesh ndë shtrëngim, edhë gjithë këto të-këqia të vinjënë mbi ty, edhe ndë ditt të-pastajme ndë ukthefsh,
31 edhe të dëgjonjç zën' e ati, Me-qënë-që Zoti, Perëndia yt, është Perëndi i-përdëllyershim, nukë dotë heqë dorë prej teje, as dotë të prishnjë, as dotë harronjë dhiatën' e atërvet të tu, që u upërbetua atyreve.
32 Sepse pyet tashi për ato ditt' e-shkuara, që qenë *më* përpara *se të jesh* ti, që atë ditë që bëri Perëndia njerinë mbi dhet, edhe që nga njëra anë e qiellit *e* gjer mbë tjatëret, ndë është bëtë *ndonjë e-këtillë gjë*, posi këjo gjëj' e-madhe, a ndë është dëgjuarë *ndonjë gjë*
33 posi këjo. A ka dëgjuarë *kurrë* ndonjë gjindje zën' e Perëndisë të flasë ndë mest të zjarrit, sikundrë dëgjove ti, edhe të ketë rruarë?

34 Apo provoj Perëndia të vej'e të marrë komp
për vetëhen' e ti nga mezi i *ndonjë tjetëri* komp
më provime, me shënja, e me luftë, e me çudi-
ra, e me dorë të-fortë, e me krah të-ndejturë, e
me tmere të-mëdhenj, sipas gjith' atyreve që
bëri Zoti, Perëndia juaj, për ty nd' Egjyptë
35 përpara syvet t' uaj? Mbë ty urrëfye këjo, që
t'a dish, se Zoti, ay është Perëndia; s' ka
36 tjetërë përveç ati. Nga qielli të bëri të dë-
gjonjç zën' e ati, që të të mësonjë; edhe mbi
dhet të bëri të shohç zjarrin' e ati të-math,
edhe i dëgjove fjalët' e ati nga mezi i zjarrit.
37 Edhe me-qënë-që deshi atërit' e tu, përandaj
sgjodhi farën' e atyreve pas atyreve, edhe të
nxori nga Egjypta me të-ardhurit' e ti, me
38 fuqin' e ti të-madhe; Që të përzërë që për-
para teje kombe më të-mëdhenj e më të-for-
të se ti, që të të kllasë ty, e të t' apë dhen'
e atyre për trashëgim, si *e sheh* sot.
39 Njih-e pra këtë ditë, edhe vër'-e ndë zë-
mërët t' ënde, se Zoti, ay është Perëndi lart
ndë qiejt, edhe poshtë mbi dhet; nukë ka
40 tjetërë. Edhe ruaj urdhërimet' e atij, e po-
rosit' e ati, që po të urdhëronj unë sot; që të
të vejë mbarë ty, edhe bijvet të tu pas teje,
edhe që të jesh jetë-gjatë mbi dhet, që të
dha Zoti, Perëndia yt, për gjithënjë.
41 Atëhere Moisiu ndau tre qytete këtej Jor-
42 danit nga të-lindurit' *e djellit;* Që të ikënjë
atje njerivrasësi, i-cili vret të-afërmin' e ti pa

dashurë, edhe pa pasurë mëri kundr' ati më
përpara, edhe dyke ikurë ndë ndonjë nga
43 këta qytete të shpëtonjë jetën' e ti: Bezerënë
ndë shkretëtirët, ndë dhet të-sheshtë, për
Rubinitëtë; edhe Ramothënë ndë Gilead, për
Gaditëtë; edhe Gollanënë ndë Bashan, për
Manassitëtë.
44 Edhe ky është nomi që vuri Moisiu për-
45 para të bijvet të Israilit; Këta janë dëshmi-
metë, e urdhërimetë, e gjyqetë, të-cilëtë Mo-
isiu u'a foli të bijvet të Israilit, si duallnë
46 nga Egjypta, Këtej Jordanit, ndë fushëzët
kundrejt Beth-peorit, ndë dhet të Sihonit,
mbretit t' Amoritëvet, që rrinte ndë Heshbon,
të-cilin' e vrau Moisiu edhe të bijt' e Isra-
47 ilit, si duallë nga Egjypta; Edhe pushtuanë
vëndin' e ati, edhe dhen' e Ogut, mbretit të
Bashanit, të dy mbretërvet t' Amoritëvet, të-
cilëtë ishinë këtej Jordanit nga të-lindurit' *e*
48 *djellit;* Që nga Aroeri, që *është* ndë buzët të
fushëzës' s' Arnonit, *e* gjer ndë malt të Sionit
49 (i-cili është Hermoni), Edhe gjithë Arabahë-
në, këtej Jordanit nga të-lindurit' *e djellit*, gjer
ndë dett të Arabahësë, ndënë të-tatëpjetat
të Pisgahut.

Krye 5.

1 Edhe Moisiu thirri gjithë Israilinë, edhe u
tha atyre, Pa dëgjo, o Israil, urdhërimet' e
gjyqetë, të-cilëtë po u flas unë juve sot ndë

veshët, që t' i xini, edhe të kujdesi t'i bëni.
2 Zoti, Perëndia ynë, bëri dhiatë me ne ndë
3 Horib. Këtë dhiatë nuk' e bëri Zoti me atë-
ritë t' anë, po me ne, po, me ne të-gjithë që
4 jemi të-gjallë këtu sot. Zoti foli me ne faqe
5 për faqe ndë malt nga mezi i zjarrit, (Edhe
unë rrinjam nd' atë kohë ndë mest të Zotit
e juve, që t' u dëftonjam fjalën' e Zotit; sepse
ishitë të-frikësuarë nga pun' e zjarrit, edhe
nuk' ungjittë ndë malt,) edhe tha:
6 Unë jam Zoti, Perëndia yt, që të nxora
nga dheu i Egjyptësë, nga shtëpia e robërisë.
7 Mos kesh të-tjerë perëndira veç meje.
8 Mos bënjç për vetëhenë t' ënde idhul, as
të-përgjajturë të ndonjë gjëje që është lart
ndë qiellt, a që është poshtë ndë dhet, a që
9 është ndër ujërat përposh dheut; Mos u fa-
lesh atyre, as mos i lusç; sepse unë Zoti,
Perëndia yt, jam Perëndi zilitar, që çpaguanj
fajet' e atërvet mbi djëmt, gjer mbë të-tre-
tinë edhe të-katrëtinë bres t' atyreve që më
10 kanë mëri; Edhe që bënj përdëllim mbë mi-
jëra *brezash* atyreve që më duanë edhe rua-
njënë porosit' e mia.
11 Mos marrç emërin' e Zotit, Perëndisë t'
ënt, mbë të-kotë; sepse Zoti nukë dotë nxje-
rrë të-pafajm atë që merr emërin' e atij mbë
të-kotë.
12 Ruaj ditën' e sabbatësë, që t'a shënjtëronjç
atë, sikundrë të urdhëroj Zoti, Perëndia yt.

13 Gjashtë dit dotë punonjç gjithë punët' e tua;
14 Po e-shtatëta ditë është sabbatë mbë Zotinë, Perëndinë t' ënt; nd' *atè ditë* nukë dotë bënjç asndonjë punë, as ti, as yt bir, as jot' bijë, as shërbëtori yt, as shërbëtoreja jote, as kau yt, as gomari yt, as ndonjë nga bagëtia jote, as i-huaji yt, që është përbrënda dyervet të tua; që të prëhetë shërbëtori edhe shërbëto-
15 reja jote, posi ti. Edhe kujto, se ke qënë shërbëtuar ndë dhet t' Egjyptësë, edhe Zoti, Perëndia yt, të nxori andej me dorë të-fortë e me krah të-ndejturë; përandaj Zoti, Perëndia yt, të urdhëroj ty të ruajsh ditën' e sabbatësë.
16 Ndero t' ët atë e t' ët ëmë, sikundrë t' urdhëroj Zoti, Perëndia yt; që të bënesh jetëgjatë e ditë-bardhë mbi dhet, që të ep Zoti, Perëndia yt.
17 Mos vrasç.
18 As mos kurvëronjç.
19 As mos vjethç.
20 Ar mos bënjç dëshmi të-rreme kundrë t' afërmit t' ënt.
21 As mos dëshëronjç gruan' e të-afërmit t' ënt; as mos dëshëronjç shtëpin' e të-afërmit t' ënt, as arën' e ati, as shërbëtorin' e atij, as shërbëtoren' e atij, as kan' e atij, as gomarin' e atij, as çdo gjë që është e të-afërmit t' ënt.
22 Këto fjalë i foli Zoti gjithë përmbledhjes' s' uaj ndë malt nga mezi i zjarrit, e i resë,

e i errësirës' së-dendurë, me një zë të-math edhe *tjetërë gjë* nukë shtoj më; edhe i shkroj ato mbi dy rrasa të-gurta, edhe m'i dha mua.

23 Edhe kur dëgjuatë zënë nga mezi i errësirësë, tek mali digjej prej zjarrit, erthtë tek unë, po, gjithë të-parët' e faravet t' uaj, edhe
24 pleqtë t' uaj; Edhe thatë, Na Zoti, Perëndia ynë, tek na dëftoj lavdin' e ti edhe madhërin' e ti, edhe dëgjuamë zën' e ati nga mezi i zjarrit; atë ditë pamë se Zoti folka me njerinë,
25 edhe njeriu rruaka. Tashi pra përse të vdesëmë? sepse ky zjarr i-math dotë na djegë; ndë dëgjofshimë neve edhe më zën' e Zotit,
26 Perëndisë t' ënë, dotë vdesëmë. Sepse cili është nga gjithë të-përmorçimitë ay që dëgjoj zën' e Perëndis' së-gjallë dyke folurë nga mezi i zjarrit, si *e dëgjuamë* neve, edhe rroj?
27 Shko ti afërë, edhe dëgjo gjithë sa dotë të thotë Zoti, Perëndia unë; edhe ti thuaj-na gjithë sa të të thotë Zoti, Perendia ynë; edhe neve dot' i dëgjojmë, edhe dot' i bëjmë.

28 Edhe Zoti dëgjoj zën' e fjalëvet t' uaj, kur flisnitë me mua; edhe Zoti më tha, Dëgjova zën' e fjalëvet të kësaj gjindjeje, që të folnë
29 ty; thanë mirë gjithë sa folnë. Makar të kishinë ata një të-tillë zëmërë, që të më kishinë frikë, e të ruaninë gjithënjë gjithë urdhërimet' e mi, që të vininë mbarë gjithënjë ata,
30 edhe djemt' e atyre. Skko e u thuaj atyre,
31 Kthehi ndër tendat t' uaj. Po sa për ty, ti

qëndro këtu bashkë me mua, edhe dotë të them gjithë porositë, e urdhërimetë, e gjyqetë, të-cilëtë dot' u'a mësonjç atyre, që t'i bënjënë ndë atë dhe që u ap atyre për trashëgim.

32 Dotë vini re pra t'i bëni, sikundrë u urdhëroj juve Zoti, Perëndia juaj; nukë dotë
33 priri mbë të-djathtë, a mbë të-mëngjërë. Dot' ecëni ndër gjith' atë udhë që u urdhëroj juve Zoti, Perëndia juaj, që të rroni, e që t'u vejë mbarë, e të jeni ditë-gjatë ndë dhet që dotë trashëgoni.

Krye 6.

1 Edhe këto janë porositë, urdhërimet' e gjyqetë, që urdhëroj Zoti, Perëndia juaj, t'u mësonj juve, që t' i bëni nd' atë dhe, ndë të-
2 clët vini për të trashëguar' atë; Që t' i kesh fikë Zotit, Perëndisë t' ënt, që t' i ruajsh gjith' urdhërimet' e atij e porosit' e ati, që po të urdhëronj unë, ti, edhe yt bir, edhe i biri i 'ët bir, gjithë ditt' e jetësë s' ate; edhe që
3 të bënesh ditë-gjatë. Dëgjo pra, o Israil, edhe vëë re t'i bëjsh, që të të vejë mbarë, edhe të shumohi fort, sikundrë t' uzotua Zoti, Perëndia i atërvet të tu, nd' atë dhe që rrjeth qunësht e mjaltë.
4 Ja dëgjo, o Israil; Zoti, Perëndia ynë, është
5 një Zot. Dotë duash pra Zonë, Perëndinë t' ën me gjithë zëmërënë t' ënde, e me gjithë shpirinë t' ënt, e me gjithë fuqinë t' ënde.

6 Edhe këto fjalë, që po t' urdhëronj unë sot,
7 dotë jenë ndë zëmërët t' ënde; Edhe dot' u'a
mësonjç me kujdes djemvet të tu, edhe dotë
flasç për ato, kur të rrish ndë shtëpit t' ënde,
e kur të ecënjç udhësë, e kur të bjesh të
8 flesh, e kur të ngrihesh. Edhe dot' i lithç ato
për shënjë mbi dorët t' ënde, edhe dotë jerë
posi një gjë përpara ballit ndë mest të syvet
9 të tu. Edhe dot' i shkruanjç ato mbi shtyllat
të dyervet të shtëpisë s' ate, edhe mbi portat të tua.

10 Edhe kur të të bjerë ty Zoti, Perëndia yt,
ndë dhet që u upërbetua atërvet të tu, Abra-
amit, Isaakut, e Jakobit, të t'a apë ty, ndër
qytete të-mëdhenj ë të-mirë, që nuk' i ke
11 ndërtuarë ti, Edhe ndër shtëpira plot megji-
thë të-miratë, që nuk' i ke mbushurë *ti*, dhe
ndë sterna të-latuara, që s' i ke latuarë *ti*,
ndë vreshta e ndë ulishta, që nuk' i ke mënë
12 *ti*, edhe të hash, edhe të nginjesh, Athere
kij mënttë semos harronjç Zotinë që tënxo-
ri nga dheu i Egjyptësë, nga shtëpia e ro-
13 bërisë. T' i kesh frikë Zotit, Perëndisë' ënt,
edhe t'i shërbesh ati, edhe të përbetonesh mbë
emërit t' ati.

14 Nukë dotë veni prapa perëndive të-tjerë, nga perëndit' e kombevet që janë reth' e
15 rrotullë jush; Sepse Zoti, Perëndia yt, që është
ndë mest t' ënt, është Perëndi zilitar semos
ndizetë zëmërimi i Zotit, Perëndis t' ënt,

kundrë teje, ë të shuan nga faqeja e dheut.
16 Nukë dotë ngitni Zotinë, Perëndinë t' uaj,
17 sikundrë e ngatë ndë Massah. Dotë ruani me kujdes porosit' e Zotit, Perëndisë t' uaj, e dëshmimet' e atij, e urdhërimet' e ati, që
18 të urdhëroj ty. Edhe dotë bënjç atë që ësht' e-mir' edhe e-drejtë përpara Zotit, që të veç mbarë, e të hynjç e të trashëgonjç atë dhen'
19 e-mirë, që u upërbetua Zoti atërvet të tu; Që të dëbonjë gjith' armiqt' e tu përpara teje, sikundrë foli Zoti.
20 Kur të të pyesë yt bir ndë kohët të-pritme, e të thotë, Ç' duanë të thonë dëshmimetë, e urdhërimetë, e gjyqetë, që u urdhëroj
21 juve Zoti, Perëndia ynë? Atëhere i ke për të thënë birit t' ënt, Ishimë robër të Faraonit nd' Egjyptë, edhe Zoti na nxori nga Egjypta
22 me dorë të-fortë; Edhe Zoti dëfteu shënja e çudira, të-mëdha e të-fështira, ndë Egjyptë, mbi Faraoninë, edhe mbi gjithë shtëpin' e ati,
23 përpara syvet t' anë; Edhe na nxori andej, që të na bjerë, e të na apë dhenë që u upër-
24 betua atërvet t' anë. Edhe Zoti na urdhëroj të bëjmë gjithë këta urdhërime, t' i kemi frikë Zotit, Perëndisë t' ënë, gjithënjë për të-mirënë t' ënë, që të na ruanjë neve të-gjallë,
25 si mbë këtë ditë. Edhe dotë jetë drejtëri ndër ne, ndë vënçimë re të bëjmë gjithë këto porosi përpara Zotit, Perëndisë t' ënë, sikundrë na ka urdhëruarë.

Krye 7.

1 Kur të të bjerë Zoti, Perëndia yt, ndë dhet,
ku vete për të trashëguar' atë, edhe të dë-
bonjë shumë kombe përpara teje, Hittitëtë, e
Girgashitëtë, e Amoritëtë,e Hanaanitëtë, e Fe-
rizzitëtë, Hivitëtë, e Jebusitëtë, shtatë kombe
2 më të-mëdhenj e më të-fortë se ti; Edhe kur
Zoti, Perëndia yt, të t' i apë ata ndë dorë
përpara teje, dot' i vrasç ata; dot' i shuash
ata fare; s' ke për të lidhurë fjalë me ata,
3 as s' ke për të rrëfyerë atyreve përdëllim; As
s' ke për të bërë krushqi me ata; t' ët bijë
s' j'a ke për të dhënë të birit t' ati, as të bi-
jën' e ati s' e ke për të marrë për t' ët bir.
4 Sepse dotë largonjënë t' ët bij prej meje,
edhe dotë lusnjënë të-tjerë perëndira; kështu
dotë ndizetë zëmërimi i Zotit kundrë jush,
5 edhe me të-çpejtë dotë të prishnjë. Po kështu
t' u'a bëni atyre; të rrëzoni theroret' e atyre,
edhe të thyeni shtyllat' e atyreve, edhe të
pritni Asherimet' e atyre, edhe të diqni i-
6 dhujt' e atyre të-gdhëndurë. Sepse ti je gjin-
dje e-shënjtëruarë te Zoti, Perëndia yt; Zoti,
Perëndia yt, të sgjodhi, që të jesh tek ay
gjindje e-veçantë, përmbi gjithë gjindjetë që
7 janë mbi faqet të dheut. Zoti nukë hodhi da-
shurin' e ti mbi ju, as nuk' u sgjodhi juve, sepse
ishitë më tepërë nga numeri se çdo tjetërë
gjindje; sepse ju ishitë m' i-vogëli i gjithë

8 gjindjevet; Po sepse u deshi Zoti, edhe që
të ruanjë benë që u upërbetua atërvet t' uaj,
Zoti u nxori juve me dorë të-fortë, edhe u
çpërbleu juve nga shtëpia e robërisë, nga
dora e Faraonit, mbretit t' Egjyptësë.
9 T'a dish pra, se Zoti, Perëndia yt, ay
është Perëndi; besëtari Perëndi, i-cili ruan
dhiatënë edhe përdëllimnë mb' ata që e duanë
edhe ruanjënë porosit' e atij gjer mbë një mijë
10 breza; Edhe përpara syvet u'a çpaguan aty-
reve që e kanë cmir, që t'i shuanjë ata; nukë
dot' j'a mënonjë ati që e cmir atë; dot' j'a
11 çpaguanjë ati përpara syvet. Ruaj pra poro-
sitë, e urdhërimetë, e gjyqetë, që po t' ur-
dhëronj unë sot, për të bërë ato.
12 Edhe ndë dëgjofshi këta gjyqe, e t' i ru-
ani, e t'i bëni, Zoti, Perëndia yt, dotë ruanjë
për ty dhiatën' edhe përdëllimnë që u upërbe-
13 tua atërvet të tu; Edhe dotë të dojë, e dotë
të bekonjë, e dotë të shumonjë, e dotë be-
konjë pemën' e barkut t' ënt, edhe pemën' e
dheut t' ënt, grurëtë t' at, e verënë t' ënde,
e vajtë t' at, tufat' e lopëvet të tua, e tufat' e
dhënvet të tua, nd' atë dhe që u upërbetua a-
14 tërvet të tu për të dhënë ty. Dotë jesh i-be-
kuarë përmbi gjithë kombet; nukë dotë ketë
mashkull e femërë që s' pjell ndë mest t' ënt,
15 a ndë mest të bagëtivet të tua. Edhe Zoti
dotë heqë prej teje çdo smundje, edhe nukë
dotë lëshonjë mbi ty asndonjë nga smundjet'

e-këqia të Egjyptësë që di ti, po dot' i lëshonjë mbi gjith' ata që të kanë cmir ty.
16 Edhe dotë shuajsh gjithë kombetë që dotë të apë ndë dorë Zoti, Perëndia yt; syrit t' ent nukë dot' i dhëmbetë për ata, as ke për të luturë perëndirat' e atyreve; sepse këjo dotë jetë dhokan për ty.
17 Ndë thënç ndë zëmërët t' ënde, Këta kombe janë më shumë se unë; qysh munt t' i
18 nxjer ata nga vëndi i tyre! Mos ki frikë nga ata; kujtohu mirë ç' u bëri Zoti, Perën-
19 dia yt, Faraonit edhe gjithë Egjyptësë; *Ato* të-ngarat' e-mëdha që panë syt' e tu, e shënjatë, e çuditë, e dorën' e-fortë, e krahun' endejturë, me të-cilatë të nxori Zoti, Perëndia yt; kështu dot' u'a bënjë Zoti, Perëndia yt, gjithë kombevet, prej të-cilëvet ti ke frike.
20 Po edhe grerëzatë Zoti, Perëndia yt, dot' i dërgonjë ndë mest t' atyre, gjersa të shuhenë që përpara teje ata që kanë mbeturë
21 edhe janë fshehurë. Të mos trëmbesh nga ata; sepse Zoti, Perëndia yt, është ndë mest
22 t' ënt Përëndi i-math e i-frikshim. Edhe Zoti, Perëndia yt, dotë përzërë ata kombe përpara teje dalë nga dalë; s' munt t' i prisç ata për-një-here, semos shumonenë egërsirat' e
23 fushësë kundrë teje. Po Zoti, Perëndia yt dotë *t'i* apë ata ndë dorë përpara teje, edhe dot' i prishnjë ata me prishje të-madhe, gjer-
24 sa të shuhenë. Edhe dotë apë ndë dorët t'

ënde mbretërit' e atyreve, edhe dotë shuajsh emërin' e atyreve që përposh qiellit; asndonjë nukë dotë muntnjë të qëndronjë përpara teje, gjersa t'i shuajsh ata.

25 Idhujt' e-gdhëndurë të perëndivet t' atyre dot' i diqni ndë zjarr; nukë dotë dëshëronjç ergjëndinë a arinë që është mbi ata, as dot' e marrç për vetëhenë t'ënde, që të mos zihesh ndë dhokan; sepse Zoti, Perëndia yt, e ka
26 të-ndohëtë. Edhe nukë dotë bjesh gjë të-ndyrë ndë shtëpit t' ënde, që të mos bënesh gjë e-mallëkuarë posi ajo; dot'a mërziç atë fare, edhe dot'a kesh atë fare të-ndyrë; sepse është gjë e-mallëkuarë.

Krye 8.

1 Gjithë porositë që po të urdhëronj sot dotë kujdesi t' i bëni, që të rroni, e të shumohi, e të hyni, e të pushtoni dhenë, për të
2 cilinë u upërbetua Zoti atërvet t' uaj. Edhe dotë kujtonjç gjithë udhënë që të hoqi Zoti, Perëndia yt, këta të dyzet vjet ndë shkretëtirët, për të përunjurë ty, për të provuarë ty, për të njohurë ato që kishe ndë zëmërët t' ënde, ndë dotë ruanjç porosit' e atij, apo jo.
3 Edhe të përunji, edhe të bëri të kesh uri, edhe të ushqeu me mannë, të-cilënë as ti nuk' e njihnje, as atërit' e tu nuk' e njihninë, që të të bënte të xësh se njeriu nukë rron vetëmë me bukë, po se njeriu rron me çdo që

4 del nga goja e Zotit. Rrobat' e tua nuk' u-
vjetëruanë mbi ty, as këmba jote nuk' uënjt,
5 këta të dyzet vjet. Edhe dotë njohç ndë zëmë-
rët t' ënde, se posi njeriu që mundon të birrë,
kështu *edhe* ty të mundoj Zoti, Perëndia yt.
6 Edhe dotë ruanjç porosit' e Zotit; Perëndisë
t' ënt, që të ecënjç nd' udhët t' atij, edhe t' i
kesh frikë atij.
7 Sepse Zoti, Perëndia yt, të pruri ndë dhe
të-mirë, ndë një dhe me lumënj uji, me kronj
e me thellësira, që buronjënë ndë fushëzat e
8 ndë malet; Ndë dhe gruri e elbi, e vreshtash,
e fiqsh, e shegësh; ndë dhe ullinjsh e mjal-
9 te; Ndë dhe, ndë të-cilët nukë dotë hash bu-
kënë *t' ënde* me kursim, nukë dotë të shteretë
asgjë nd' atë; ndë dhe, gurët' e të-cilit janë
hekurë, edhe nga malet' e të-cilit dotë rëmihsh
ramë.
10 Edhe dote has, e dotë nginjesh, e dotë
bekonjç Zonë, Perëndinë t' ënt, për atë dhen'
11 e-mirë që të dha. Ki mënttë semos harronjç
Zonë, Perëndinë t' ënt, dyke mos ruajturë po-
rosit' e atij, e gjyqet' e atij, e urdhërimet' e
12 atij, që po të urdhëronj unë sot; Semos, si
të hash e të nginjesh, e të trajtosh shtëpi
13 të-mira, e të rrish nd' ato, Edhe qet' e tu edhe
dhënt' e tua të shtonenë, edhe të shumonetë
ergjëndi yt edhe ari yt, edhe gjithë sa ke të
14 shtonenë, *Semos* atëhere lartonetë zëmëra jote,
e harron Zonë, Perëndinë t' ënt, që të nxori

nga dheu i Egjyptësë, nga shtëpia e robërisë;
15 I-cili të hoqi udhënë ndëpër *atë* shkretëtirët të-
madhe e të-frikshime, *tek* ishinë gjërpinj të-
flakëtë, e përçollakë, edhe thatësirë ku nukë
kishte ujë; i-cili të nxori ujë nga gur' i zja-
16 rrit; I-cili të ushqeu ndë shkretëtirët me
mannë, të-cilënë nuk' e njihninë atërit' e tu,
për të përunjurë ty, e për të provuarë ty, që
17 të të bënjë mirë ndë funtt t' ënt; Edhe semos
thuash ndë zëmërët t' ënde, Fuqia ime edhe
forca e dorësë s' ime më fituanë këtë pasj e
18 Po dotë kujtosh Zonë, Perëndinë t' ënt; sepse
ay është ay që të ep fuqi të fitonjç pasje,
që të forconjë dhiatën' e ti, për të-cilënë u
upërbetua atërvet të tu, sikundrë *e sheh* ndë
këtë ditë.
19 Po ndë harrofsh Zonë, Perëndinë t' ënt, e
të veç pas perëndive të-tjerë, e t' i lusç ata,
e t' u falesh atyre, thërres për dëshmim
kundrë jush sot, se me të-vërtetë dotë shuhi.
20 Posi kombetë që shuan Zoti përpara jush,
kështu dotë shuhi; sepse nuk' i dëgjuatë zë-
rit të Zotit, Perëndisë t' uaj.

Krye 9.

1 Pa dëgjo, o Israil; ti po kapërxen Jorda-
ninë sot, që të hynjç për të pushtuarë kom-
be më të-mëdhenj e më të-fortë se ti, qyte-
te të-mëdhenj e të-thururë me mur gjer ndë
2 qiell, Gjendje të-madhe e të-gjatë *ndë shtatt*,

të bijt' e Anaqimëvet, të-cilët i njeh, edhe
për të-cilët ke dëgjuarë të thonë, Cili muut
të qëndronjë përpara të bijvet t' Anakut?
3 Dij-e pra sot, se Zoti, Perëndia yt, ësht' ay
që shkon përpara teje; është zjarr që për-
vëlon; ay dot' i prishnjë ata, edhe dot' i rrë-
zonjë ata përpara teje; kështu dot' i dëbonjç
ata, edhe çpejt dot' i prishç ata, sikundrë të
tha Zoti.
4 Zoti, Perëndia yt, si të dëbonjë ata që për-
para teje, mos flasç ndë zëmërët t' ënde, dy-
ke thënë, Për drejtërinë t' ime më pruri Zoti
të trashëgonj këtë dhe; sepse për paudhërin'
e këtyre kombeve Zoti po i dëbon ata që për-
5 para teje. Jo për drejtërinë t' ënde, as për të-
drejtët' e zëmërësë s' ate, hyn të trashëgonjç
dhen' e atyreve; po për paudhërin' e këtyre
kombeve po i dëbon ata Zoti, Perëndia yt,
që përpara teje, edhe që të vërtetonjë fjalë-
në që u upërbetua Zoti atërvet të tu, Abraa-
6 mit Isaakut, e Jakovit. Dij-e pra, se Zoti,
Perëndia yt, nukë po të ep këtë dhe të-mirë
t'a trashëgonjç atë për drejtërinë t' ënde; se-
7 pse je gjindje qafë-ashpërë. Kujtohu, *e* mos
harro, si e ndeze Zonë, Perëndinë t' ënt, që
të zëmëronetë ndë shkretëtirët; që atë ditë,
që dualltë nga dheu i Egjyptësë *e* gjersa a-
rrittë ndë këtë vënt qetë kryengritës kundrë
Zotit.
8 Po edhe ndë Horib e ndestë Zonë që të

zëmëronetë, edhe Zoti uzëmërua kundrë jush
9 që t' u shuante. Kur ungjita ndë malt që të
mirnjam rrasat' e-gurta, rrasat' e dhiatësë që
bëri Zoti me ju, atëhere mbeçë ndë malt dy-
zet dit e dyzet net; as bukë nukë hëngra,
10 as ujë nukë piva. Edhe Zoti më dha të dy
rrasat' e-gurta, që ishinë shkruarë me gish-
tin' e Perëndisë; edhe mbi ato *ishinë shkru-*
arë fjalë sipas gjith' atyre fjalëve që u foli
Zoti juve ndë malt nga mezi i zjarrit ndë
11 ditët të përmbledhjesë. Edhe ndë funtt të
dyzet ditvet e të dyzet netvet Zoti më dha
të dy rrasat' e-gurta, po, rrasat' e dhiatësë.
12 Edhe Zoti më tha, Ngreu, *e* sbrit çpejt së-kë-
tejmi; sepse gjindja jote që nxore nga Egjypta
uvduar; uprornë çpejt nga udha që u urdhë-
rova atyre; bënë për vetëhen' e tyre idhull
13 të-derdhurë. Edhe Zoti më foli e *më* tha, E
pashë këtë gjindje, edhe na tek është një
14 gjindje qafë-ashpërë; Lërë-më t' i humbas
ata, edhe të shuanj emërin' e atyreve që për-
posh qiellit; edhe të kam për të bërë një
komp më të-fortë e më të-math se këta.
15 Kështu ukthyesh' e sbrita nga mali, (edhe
mali po digjej prej zjarri;) edhe të dy rrasat'
16 e dhiatësë ishinë ndër të dy duart të mia. Edhe
pashë, edhe na tek kishitë fëjyerë kundrë
Zotit, Perëndisë t' uaj; kishitë bërë për ve-
tëhenë t' uaj një viç të-derdhurë; ishitë pje-
rrë çpejt nga udha që u kishte urdhëruarë

17 Zoti juve. Edhe rroka të dy rrasatë, e i hodha nga të dy duart' e mia, edhe i theva përpara syvet t' uaj.

18 Edhe rashë përpara Zotit, si herën' e-parë, dyzet dit e dyzet net; as bukë hëngra, as ujë piva, për punë të gjithë fajevet t' uaj që fëjyetë, dyke bërë atë që ishte e-keqe ndë
19 syt të Zotit, që t'a zëmëroni; Sepse ufrikësuashë nga zëmërimi e nga mëria e-ndezurë, me të-cilënë ishte ndezurë Zoti kundrë jush për të shuarë juve. Po Zoti më dëgjoj edhe këtë
20 herë. Edhe Zoti ish zëmëruarë fort kundrë Aaronit për të shuar' atë; edhe i uluçë edhe
21 për Aaroninë nd' atë kohë. Edhe mora fajinë t' uaj, viçinë që kishitë bërë, edhe e dogja ndë zjarr, edhe e bëra copë copë e e dërmova gjersa ubë i-hollë posi pluhur; edhe pluhurin' e ati e hodha ndë përruajt që sbriste nga mali.

22 Edhe ndë Taberah, e ndë Massah, e ndë
23 Hibroth-hattaabah, zëmëruatë Zonë. Edhe kur u dërgoj Zoti juve nga Kadesh-Barnia, dyke thënë, Ngjiti, e pushtoni dhenë që u dhashë juve, atëhere ju ngrittë krye kundrë urdhërit të Zotit, Perëndisë t' uaj, edhe nuk' i besuat'
24 ati, as nuk i dëgjuatë zërit t' ati. Kini qënë kryengritës kundrë Zotit që atë ditë që u njoha juve.

25 Kështu rashë përpara Zotit dyzet dit e dyzet net, sikundrë pata rënë *edhe më për-*

para; sepse Zoti kishte thënë se dot' u pri-
26 shte. Edhe i uluçë Zotit, e *i* thashë, O Zot,
o Perëndi, mos shuaj gjindjenë t' ënde edhe
trashëgimnë t' ënt, të-cilën' e çpërbleve me
anë të madhërisë s'ate, edhe e nxore nga
27 Egjypta me dorë të-fortë. Kujto shërbëtorët'
e tu, Abraaminë, Isaakunë, e Jakobinë; mos
vështro ashpërimn' e kësaj gjindjeje, as ligë-
28 sin' e atyreve, as fajin' e atyreve; Semos thonë
njerëzit' e ati dheu, prej të-cilit na nxore,
Me-qënë-që Zoti s' muntte t'i klliste ata ndë
dhet që u uzotua atyre, edhe me-qënë-që i
kihste cmir ata, i nxori ata, që t'i vrasë ndë
29 shkretëtirët. Po këta janë gjindja jote, edhe
trashëgimi yt, të-cilën' e nxore me fuqinë t'
ënde të-madhe, edhe me krahunë t' ënt të
ndejturë.

Krye 10.

1 Nd' atë kohë Zoti më tha, Gdhënt për ve-
tëhenë t' ënde dy rrasa të-gurta posi të-pa-
ratë, edhe ngjitu tek unë ndë malt, edhe bëj
2 për vetëhenë t' ënde një arkë të-d anjtë. Edhe
unë dotë shkruanj mbi rrasat ato fjalëtë që
ishinë ndë rrasat të-para që theve, edhe t'i
3 vësh ato nd' arkët. Kështu bëra një arkë prej
druje shittimi, edhe gdhënda dy rrasa të-gurta
posi të-paratë, edhe ungjita ndë malt dyke
mbajturë të dy rrasatë ndër duart të-mia.
4 Edhe shkroj mbi rrasat, sipas shkronjës'

së-parë, të dhjetë fjalëtë, të-cilatë u'a foli juve Zoti ndë malt nga mezi i zjarrit ndë ditët të përmbledhjesë; edhe Zoti m'i dha mua ato.
5 Edhe ukthyesh' e uula nga mali, edhe i vura rrasatë ndë arkët që bëra; edhe jan' atje, sikundrë më urdhëroj Zoti.
6 (Edhe të bijt' e Israilit ungritnë nga Beeroth-Bene-jakaani për ndë Moserah; atje vdiq Aaroni, edhe atje ukall ndë varr; edhe Eleazari, i bir' i ati, ubë prift ndë vëntt t' ati.
7 S' andejmi ungritnë për ndë Gudgodah, edhe nga Gudgodahu për ndë Jotbatha, një vënt me përrënj ujërash.
8 Nd' atë kohë Zoti ndau farën' e Leviut, që të barte arkën' e dhiatës' së Zotit, që të qëndronte përpara Zotit për të shërbyer' atij, edhe që të bekonte mb' emërit t' atij, gjer mbë
9 këtë ditë. Përandaj Leviti s' ka pjesë as trashëgim bashkë me vëllezërit' e tij; Zoti është trashëgimi i atij, sikundrë Zoti, Perëndia yt, i foli ati.)
10 Edhe unë ndënja ndë malt, si herën' e pa..ë, dyzet dit e dyzet net; edhe Zoti më dëgjoj edhe këtë herë, *edhe* nukë deshi Zoti
11 të të shuante. Edhe Zoti më tha, Ngreu, *e* shko udhësë përpara gjindjesë, që të hynjën' e të pushtonjënë dhenë, për të-cilinë u upërbetuashë atërvet t' atyre t' u'a ap atyre.
12 Edhe tashi, o Israil, ç' kërkon Zoti, Perëndia yt, prej teje, veç se t' i kesh frikë

Zotit, Perëndisë t' ënt, të ecënjç ndër gjithë
udhët t' ati, t'a duash atë, edhe t' i shërbënjç
Zotit, Perëndisë t' ënt, me gjithë zëmërënë t'
13 ënde, edhe me gjithë shpirtinë t' ënt, Të ruajsh
porosit' e Zotit, edhe urdhërimet' e atij, të-
cilëtë po të urdhëronj unë sot, për të-mirënë
14 t'ënde? Na tek janë të Zotit, Perëndisë t' ënt,
qielli, edhe qielli i qiejvet, dheu, edhe gjithë
15 ç' janë nd' atë. Po Zoti gjeti pëlqim vetëmë
te atërit' e tu, për të dashur' ata, edhe sgjo-
dhi farën' e atyreve pas atyre, po, juve prej
16 gjithë gjindjevet, sikundrë *shikoni* sot. Rreth-
pritni pra lafshën' e zëmërës' s' uaj, edhe mos
17 ashpëroni më qafënë t' uaj. Sepse Zoti, Perën-
dia yt, është Perëndi i perëndivet, edhe Zot
i zotërinjvet, i-madhi Perëndi, i-forti, edhe i-
frikshimi, i-cili nukë mban anë, as merr
18 dhuratë; I-cili i bën gjyqinë të-varfërit e së-
vesë, edhe do të-huajnë, e i ep ati të-ngrë-
19 në e të-veshurë. Doni pra të-huajnë; se-
pse *edhe* ju keni qënë të-huaj ndë dhet t'
Egjyptësë.
20 T' i kesh frikë Zotit, Perëndisë t' ënt; atë
të lusç, edhe pas ati të jesh ngjiturë, edhe
21 mb' emërit t' ati të përbetonesh. Ay është
lavdia jote, edhe ay është Perëndia yt, i-cili
bëri për ty këto punëra të-mëdha e të-frik-
22 shime, që panë syt' e ty. Atërit' e tu sbritnë
nd' Egjyptë me shtatë-dhjetë veta, edhe tashi
Zoti, Perëndia yt, të bëri posi yjt' e qiellit
ndë shumicët.

Krye 11.

1 Duaj pra Zonë, Perëndinë t' ënt, edhe ruaj
urdhëratat' e atij, e urdhërimet' e atij, e gjy-
2 qet' e atij, e porosit' e ati, gjithënjë. Edhe di-
e-ni sot; sepse nukë djemtë t' uaj, (të-cilëtë
nukë njohnë e nukë panë mundimin' e Zo-
tit, Perëndisë t' uaj, madhërin' e ati, dorën'
e ati të-fortë, edhe krahun' e ati të-ndejturë,
3 Edhe shënjat' e ati, e punët' e ati, që bëri
ndë mest t' Egjyptësë mbi Faraonë, mbretin'
4 e Egjyptësë, edhe mbi gjithë dhen' e ati; Edhe
sa i bëri ushtëris' s' Egjyptianëvet, kuajvet t'
atyre, e qerrevet t' atyre; me ç' mënyrë bëri
ujërat' e Detit të-Kuq t' i mbytin' ata, kur u
ndiqninë juve së-prapësmi, edhe si Zoti i
5 shoj ata gjer mbë këtë ditë; Edhe ç' u bëri
juve ndë shkretëtirët, gjersa erthtë ndë këtë
6 vënt; Edhe ç' u bëri Dathanit e Abiramit, bij-
vet të Eliabit, birit të Rubinit, qysh dheu
hapi gojën' e ti, edhe i përpiu ata, edhe fë-
mijët' e atyre, e tendat' e atyre, edhe çdo gjë
të-gjallë t' atyreve ndë mest të gjithë Israilit;)
7 Po sytë t' uaj panë gjithë punët' e-mëdha që
bëri Zoti.

8 Përandaj të ruani gjitë porositë që po të
urdhëronj unë sot, që të forcohi, e të hyni,
e të pushtoni dhenë, ku po vini për të pu-
9 shtuar' atë; Edhe të bëhi ditë-gjatë mbi dhet,
për të-cilinë Zoti u upërbotua atërvet t' uaj

t' u'a apë atyre edhe farës' s' atyre, dhe që rrjeth qumësht e mjaltë.

10 Sepse dheu, ndë të-cilët hyn *ti* që t'a pushtonjç, nuk' është posi dheu i Egjyptësë, prej të-cilit dualltë, ku mbillnje farënë t' ënde, edhe e ujitnje me këmbënë t' ënde, posi kop-
11 shtë lakrash; Po dheu, ndë të-cilët po shkoni për të trashëguar' atë, është dhe kodrash e fushëzash, *edhe* pi ujë nga shiu i qiellit;
12 Dhe për të-cilinë kujdesetë Zoti, Perëndia yt; syt' e Zotit, Perëndisë t' ënt, janë gjithënjë mbi atë që ndë kryet të vitit *e* gjer ndë funtt të vitit.

13 Edhe ndë dëgjofshi me kujdes porosit' e mia që po u urdhëronj unë sot, të doni Zonë, Perëndinë t' uaj, edhe t' i shërbeni ati me gjithë zëmërënë t' uaj, e me gjithë shpirtinë
14 t' uaj, *Atëhere* dotë ap shin' e dheut t' uaj ndë kohët t' ati, shin' e-lashtë ,edhe shin' e-vonë, që të mblethç grurëtë t' at, e verënë
15 t' ënde, e vajtë t' at; Edhe fushavet t' uaj dot' u ap bar për bagëtit' e tua, e të hash e të nginjesh.

16 Ruani me kujdes vetëhenë t' uaj, semos gënjenetë zëmëra juaj, e dilni jashtë udhësë, e u shërbeni perëndirave të-tjerë, e adhuro-
17 ni ata; E ndizetë zëmërimi i Zotit kundrë jush, e mbyll qiellinë që të mos bjerë shi, edhe dheu të mos apë pemët' e ti; edhe shu-

hi për-së-çpejti nga dheu i-mirë që u ep juve Zoti.

18 Të vini pra këto fjalët' e mia ndë zëmërët t' uaj, e ndë shpirtt t' uaj; edhe t'i lithni ato për shënjë mbi dorët t' uaj, edhe të jenë posi gjë përpara ballit ndë mest të sy-
19 vet t' uaj; Edhe t' u'a mësoni djemvet t' uaj, dyke folurë për ato, kur të rrish ndë shtëpit t' ënde, e kur t' ecënjç udhësë, e kur të
20 bjesh të flesh, e kur të ngrihesh; Edhe t' i shkruash ato mbi shtyllat të dyervet të shtë-
21 pisë s' ate, edhe mbi portat të tua; Që të shumonenë dittë t' uaj, edhe ditt' e djemvet t' uaj nd' atë dhe, për të-cilinë u upërbetua Zoti atërvet t' uaj t' u'a apë atyre, posi ditt' e qiellit mbi dhet.

22 Sepse ndë ruajçi me kujdes gjithë këto porosi që po u urdhëronj unë juve, për të bër' ato: të doni Zonë, Përëndinë t' uaj, të ecëni ndë gjithë udhët t' ati, edhe të ngjiti
23 pas ati, Atëhere Zoti dotë dëbonjë gjithë këta kombe që përpara jush, edhe dotë pushtoni kombe më të-mëdhenj e më të-fortë
24 se ju. Çdo vënt, përmbi të-cilinë dotë shkelnjë gjurma e këmbëvet t' uaj, dotë jetë juaji; që nga shkretëtita e nga Libani, që nga lumi, nga lumi i Evfratit, e gjer ndë dett mb'
25 anë të perëndimit, dotë jetë sinori juaj. Asndonjë nukë dotë muntnjë të qëndronjë përpara jush; Zoti, Perëndia juaj, dote shtjerë

frikënë t' uaj e trishtimnë t' uaj mbi gjithë-
dhenë që dotë shkelni, sikundrë u tha juve.
26 Na unë tek po vë sot përpara jush be-
27 kim e mallëkim; Bekimnë, ndë dëgjofshi po-
rosit' e Zotit, Perëndisë t' uaj, që po u ur-
28 dhëronj unë juve sot; Edhe mallëkimnë, ndë-
mos dëgjofshi porosit' e Zotit, Perëndisë t'
uaj, e të priri nga udha që po u urdhëronj
unë juve sot, që të vini prapa perëndive të-
tjerë që s' i kini diturë.
29 Edhe Zoti, Perëndia yt, kur të të bjerë
ndë dhet, ndë të-cilët po vete për të pushtu-
ar' atë, të vesh bekimnë mbi malt të Gjeri-
zimit, edhe mallëkimnë mbi malt t' Ebalit-
30 A nukë janë këta përtej Jordanit, prapa u-
dhës' së perëndimit të djellit, ndë dhet të
Hanaanitëvet që rrinë ndë fushët kundrejt
31 Gjilgallit, përanë lisavet të Morehut? Sepse
ju kini për të kapërxyerë Jordaninë, që të-
hyni për të pushtuarë dhenë, të-cilinë po u
ep juve Zoti, Perëndia juaj, edhe dot'a pu-
32 shtoni atë, edhe dotë rrini nd' atë. Edhe të-
vini re të bëni gjithë urdhërimet' e gjyqetë-
që po i vë unë sot përpara jush.

Krye 12.

1 Këta jan' urdhërimet' e gjyqetë që dotë-
kini kujdes të bëni ndë dhet që po u ep
Zoti, Perëndia i atërvet të tu, për të pushtu-
ar' atë, gjith' *ato* dit që dotë rroni mbi dhet.

2 Pa fjalë të prishni gjithë vëndetë, ku kombetë, të-cilëtë dotë pushtoni, lusinë Perëndirat' e tyre, mbi malet të-lartë, e mbi ko-
3 drat, e ndënë çdo dru të-gjelbërë. Edhe të rrëzoni theroret' e atyreve, e të thyeni shtyllat' e atyreve, e të diqni me zjarr Ashërimet' e atyre, e të copëtoni idhujt' e-gdhëndurë të perëndivet t'atyre, e të shuani emërat' e atyre nga ay vënt.

4 Nukë dotë bëni kështu mbë Zotinë, Pe-
5 rëndinë t' uaj; Po nd' atë vënt që dotë sgjethnjë Zoti, Perëndia juaj, nga gjithë faratë t' uaj, që të vërë emërin' e ti atje, po, ndë të-ndënjurit t' ati dot'a kërkoni, edhe atje dotë
6 vini; Edhe atje dotë bini të-gjithëdjeguratë t' uaj, e kurbanëtë t' uaj, e të-dhjettatë t' uaj, dhurëtit' e duarvet t' uaj të-ngritura lart, e kushtetë t' uaj, e dhurëtitë t' uaj që dot' epni prej vetiu, e të-parëlindurit' e lopëvet e
7 të dhënvet t' uaj; Edhe atje dotë hani përpara Zotit, Perëndisë t' uaj, e dotë gëzohi ju, edhe shtëpitë t' uaj, mbë çdo që të vini duartë t' uaj, mbë çdo gjë që të bekoj Zoti, Perëndia yt.

8 S' kini për të bërë pas gjith' atyreve që bëjmë neve sot këtu; sicili bën atë që i du-
9 ket' e-drejtë ndër syt të ti. Sepse edhe s' kini ardhurë ndë të-prëjturit e ndë trashëgimt,
10 që po u ep juve Zoti, Perëndia juaj. Po kur të kapërxeni Jordaninë, e të rrini nd' atë dhe

që po u ep Zoti, Perëndia juaj, për të trashëguarë, edhe t'u apë juve të-prëjturë nga tëgjithë armiqtë t' uaj përqark, kaqë sa të rrini
11 me siguri, Atëhere nd' atë vënt që të sgjethnjë Zoti, Perëndia juaj, që të rrijë atje emërį i ati, atje dotë bini gjithë sa u urdhëronj unë juve; të-gjithëdjeguratë t' uaj, e kurbanëtë t' uaj, të-dhjettatë t' uaj, e dhurëtit' e duarvet t' uaj të-ngritura lart, e gjithë kushtetë t' uaj
12 të-sgjedhurë që i bëni kusht Zotit; Edhe dotë gëzohi përpara Zotit, Perëndisë t' uaj, ju, edhe bijtë t' uaj, e bijatë t' uaj, e shërbëtorëtë t' uaj, e shërbëtoretë t' uaj, edhe Leviti që është përbrënda dyervet t' uaj; sepse ay s' ka pjesë as trashëgim me ju.

13 Ki kujdes vetëhesë s' ate, semos bjesh tëgjithëdjegurat' e tua mbë çdo vënt që të shohç;
14 Po mb' atë vënt që të sgjethnjë Zoti ndë njërët nga faratë t' uaj, atje të bjesh të-gjithëdjegurat' e tua, edhe atje të bëjsh gjithë sa të urdhëronj unë.

15 Po munt të therç e të hash mish përbrënda gjithë dyervet të tua, pas dëshërimit të shpirtit t' ënt, pas bekimit të Zotit, Perëndisë t' ënt, që dotë të ketë dhënë; i-pastrëti e i-papastrëti munt të hanë nga ay, posi *hanë*
16 kapruallinë, edhe posi drerinë. Po gjakunë të mos e hani; dot'a derthç atë mbi dhet posi ujë.

17 S' munt të hash përbrënda dyervet të tua të-dhjettën' e grurit t' ënt, a të verësë s' ate,

a të vajit t' ënt, a të-parëlindurit' e lopëvet
a të dhënet të tua, asndonjë nga të-kushtu-
arat' e tua që dotë bënjç kusht, as dhurëtit' e
tua që ep prej vetiu dyke dashurë, as dhu-
18 rëtit' e duarvet të tua të-ngritura lart. Po
dot' i hash ato përpara Zotit, Perëndisë t' ënt,
nd' atë vënt që të sgjethnjë Zoti, Perëndia
yt, ti, edhe yt bir, edhe jot' bijë, e shërbëtori
yt, e shërbëtoreja jote, e Leviti që është për-
brënda dyervet të tua; edhe të gëzonesh për-
para Zotit, Perëndisë t' ënt, mbë gjithë që
19 dotë vësh dorënë t' ënde. Vështro semos heqç
dorë nga Leviti sa kohë të rrojsh mbi dhet
t' ënt.
20 Kur të sgjeronjë Zoti, Perëndia yt, sinorët'
e tu, sikundrë t' uzotua, e të thuash, Dotë ha
mish, (sepse shpirti im dëshëron të ha mish,)
munt të hash mish, pas gjithë dëshërimit të
21 shpirtit t' ënt. Ndë qoftë lark prej teje vëndi,
që dotë sgjedhë Zoti, Perëndia yt, për të vën'
atje emërin' e ti, atëhere të therç nga lopët'
e tua, e nga 'dhënt' e tua, që të ka dhënë
Zoti, sikundrë të urdhërova unë, edhe të hash
përbrënda dyervet të tua, pas gjithë dëshë-
22 rimit të shpirtit t' ënt. Sikundrë hahetë ka-
prualli e dreri, kështu t' i hash ato; i-pastrëti
e i-papastrëti të hanë nga ato radhazi.
23 Vetëmë ulargo fort nga të-ngrënitë gjak;
sepse gjaku është jeta; edhe nukë dotë hash
24 jetënë bashkë me mishinë. Nukë dot' e hash

25 atë; dot'a derthç atë mbi dhet posi ujë. Të
mos e hash atë; që të të vejë mbarë ty edhe
djemvet të tu pas teje, kur të bënjç atë që
ësht' e-pëlqyerë ndër syt të Zotit.
26 Vetëmë gjërërat' e-tua e-shënjtëruara sa
të kesh, ëdhe kushtimet' e tu, dot' i marrç,
e dot' i shpjesh nd' atë vënt që të sgjedhë
27 Zoti. Edhe të bjesh të-gjithëdjegurat' e tua,
mishin' edhe gjakunë, mbi theroret të Zotit,
Perëndisë t' ënt; edhe gjaku i kurbanëvet dotë
derdhetë mbi theroret të Zotit, Perëndisë t'
ënt, edhe mishinë dot'a hash.
28 Mba vesh e dëgjo gjithë këto fjalë që po
të urdhëronj unë; që të të vejë mbarë ty edhe
djemvet të tu për jetë, kur të bënjç të-mirën'
e të-pëlqyerënë ndër syt të Zotit, Perëndisë
t' ënt.
29 Zoti, Perëndia yt, kur të shuanjë kombetë
përpara teje, ku vete për të pushtuar' ata,
edhe t'i pushtonjç ata, e të rrish ndë dhet t'
30 atyre, Vështro, semos zihesh ndë dhokan pas
atyreve, si të shuhenë përpara teje; edhe mos
pyeç për perëndirat' e atyre, e të thuash, Qysh
këta kombe lusinë perëndirat' e tyre? kështu
31 dotë bënj edhe unë. Nukë dotë bëjsh kështu
mbë Zotinë, Perëndinë t' ënt; sepse çdo gjë
të-ndyrë që mërzit Zoti ata u'a bënjënë pe-
rëndivet të tyre; sepse edhe bijt' e tyre e bi-
jat' e tyre u' a djegënë ndë zjarr perëndi-
vet të tyre.

32 Gjithë ç' u urdhëronj unë juve, këtë vështroni t'a bëni; s' ke për të shtuarë mbi atë, as s' ke për të hequrë nga ajo.

Krye 13.

1 Ndë ungritë ndë mest t' ënt profit, a njeri që ëndërrit ëndërra, edhe të të apë shënjë a
2 çudi, Edhe të dalë e-vërtetë shënja a çudia, për të-cilënë të foli, edhe të thotë, Letë vemi prapa perëndirave të-tjerë, që nuk' i ke
3 diturë, edhe let' i lusëmë, Të mos u dëgjosh fjalëvet t' atij profiti, a t' atij që ëndërrit ëndëra; sepse Zoti, Perëndia juaj, u provon juve, që të dijë, ndë doni Zonë, Perëndinë t' uaj, me gjithë zëmërënë t' uaj, e me gjithë shir-
4 tinë t' uaj. Zotit, Perëndisë t' uaj, i kini për të vaturë pas, e atij i kini për të pasurë frikë, edhe kini për të ruajturë porosit' e atij, edhe kini për të dëgjuarë zërit' t' atij, edhe atë kini për të luturë, edhe pas atij të ngjiti.
5 Edhe ay profiti, a ay që ëndërrit ëndërra, dotë vritetë; sepse tha të ngrini krye kundrë Zotit, Perëndisë t' uaj, që u nxori nga dheu i Egjyptësë, edhe të çpërbleu ty nga shtëpia e robërisë, që të të nxjerrë jashtë udhësë, që të urdhëroj Zoti, Perëndia yt, të eçënjç. Kështu dotë humbasç të-keqenë nga mezi yt.
6 Ndë të nguttë fshehuraj yt vëlla, i bir' i s' at' ëme, a yt bir, a jot' bijë, a gruaja e

gjirit t' ënt, a miku yt, që e ke posi shiprtinë t' ënt, e të thotë, Letë vemi e letë lusëmë perëndira të-tjerë, të-cilëtë s' i ke di-
7 turë, *as* ti, as atërit' e tu, Nga perëndirat' e kombevet, që janë përqark jush, përanë teje, a lark teje, që nga njëra anë e dheut e gjer
8 mbë tjatërët anë të dheut, Nuk' i ke për të dëgjuarë, as nuk' i ke për të mbajturë vesh; as nuk' e ka për të kursyerë syri yt, as nukë dotë të dhëmbetë *për atë*, as e ke për të
9 fshehurë; Po pa fjalë dot'a vrasç atë; dora jote dotë jet' e-para mbi atë për të vrar' atë,
10 edhe pastaj dora e gjithë gjindjesë. Edhe dot' e vrasç atë me gurë, gjersa të vdesë; sepse kërkoj të të nxirte jashtë nga udh' e Zotit, Perëndisë t' ënt, që të nxori nga dheu i
11 Egjyptësë, nga shtëpia e robërisë. Edhe gjithë Israili dotë dëgjonjë, edhe dotë frikësonetë, edhe nukë dotë bënjë më të-tillë të-keqe ndë mest t' ënt.

12 Ndë dëgjofsh të flasënë për ndonjë nga qytetet' e tu, që t' ep Zoti, Perëndia yt, për
13 të ndënjur' atje, e të thonë, Njerës të-poshtërë duallë nga mezi yt, edhe gënjyenë vëndësit' e qytetit të tyre, dyke thënë, Letë vemi, e letë lusëmë perëndira të-tjerë, që
14 nuk' i kini diturë, Atëhere të vëshgonjç e të pyesç, e të kërkonjç me kujdes; edhe na ndë qoftë puna e-vërtetë edhe e-plotë, se ubëkej
15 një e-këtillë ndyrësi ndë mest t' ënt, Pa fjalë

dotë vrasç me presjen' e shpatësë vëndësit' e ati qyteti, edhe dot'a prish atë farë, e gjithë ç'janë nd' atë, edhe bagëtit' e ati *dot' i therç*
16 me presjen' e shpatësë. Edhe dotë mblethç gjithë plaçkat' e ati ndë mest të rrugës' s' ati, edhe dotë djekç me zjarr qytetinë, edhe gjithë plaçkat' e ati anë mb' anë, për Zotinë, Perëndinë t' ënt; edhe dotë jetë gërmadhë për gjithë jetënë; nukë dotë jetë për të ndërtu-
17 arë më. Edhe të mos të ngjitetë ndë dorët asndonjë gjë e-mallëkuarë; që të kthenetë Zoti nga të-ndezurit' e zëmërimit të ti, edhe të të dëftenjë përdëllim, e t' i dhëmbetë ati për ty, edhe të të shumonjë, sikundrë u u-
18 përbetua atërvet të tu, Kur t' i dëgjonjç zërit të Zotit, Perëndisë t' ënt, për të ruajturë gjithë porosit' e ati, që po të urdhëronj unë sot, e për të bërë atë që ësht' e-drejtë përpara Zotit, Perëndisë t' ënt.

Krye 14.

1 Ju jeni të bijt' e Zotit, Perëndisë t' uaj; nukë dotë bëni të-prera *mbi trupt t' uaj*, as dotë bëni kryetë pa lesh ndë mest të syvet
2 t' uaj, për *ndonjë* të-vdekurë. Sepse je gjindje e-shënjtëruarë mbë Zotinë, Perëndinë t' ënt, edhe Zoti të sgjodhi që të jesh një gjindje e-veçantë tek ay, përmbi gjithë gjindjet që janë mbi faqet të dheut.
3 Nukë dotë hash asndonjë gjë të-ndyrë.

4 Këto janë bagëtitë që kini për të ngrënë;
5 kau, delja, e dhia; Dreri, e kaprualli, e bualli,
e dhia e-egrë, e pygarku, e antillopa, e ka-
6 millopardhalla. Ehhe çdo katrëkëmbëse që ka
këmbënë të-ndarë *mbë dy*, edhe thundrënë
të-çarë mbë dy, edhe përtyp ushqiminë për-
së dyti, ndë mest të katrëkëmbësvet, *këto*
7 dot' i hani. Po këto s' kini për të ngrënë nga
ato që përtypnjënë ushqiminë për-së-dyti, a
nga ato që kanë thundrënë të-çarë *mbë dy;*
kamillënë, e lepurinë, e kunelinë; sepse për-
typnjënë ushqiminë për-së-dyti, po s' kanë
thundrënë të-çarë mbë dy; këto janë të-pë-
8 gëra te ju; Edhe derrinë, sepse ka thundrënë
të-çarë mbë dy, po nuk' e përtyp ushqiminë
për-së-dyti; ësht' i-pëgërë te ju. Nga mishi i
këtyre nukë dotë hani, edhe kërmët' e atyre
nukë dot' i zini me dorë.
9 Nga gjithë sa gjëndenë ndë ujërat dotë
hani këto; çdo që ka krahë e petëza dot' e
10 hani; Edhe çdo që nukë ka krahë e petëza
nukë dot' e hani; janë të-pëgëra te ju.
11 Nga gjithë shpest' e-pastrëtë dotë hani.
12 Po këto jan' ato që s' kini për të ngrënë;
shqipeja, e shqipeja me kurris, e shqipeja e-
13 zezë, E shqipeja gjype, e falkoj, e gjypsi pas
14 farës' së ti; E çdo korp pas farës' së tij,
15 E struthokamilla, e kukumaceja, e ivi, e
16 shqifteri pas farës' së tij, E huta, e kukuma-
17 cej' e-madhe, e qykni, E pelekani, e çafka,

18 e pata e detit, E lejleku, e erodhiosi pas fa-
19 rës' së ti, e gjeli i-egrë, e lakuriqësi. Edhe
giithë shtërpinjtë me krahë janë të-pëgërë
20 te ju; nukë dotë hahenë. Nga çdo shpes i-
pastrëtë dotë hani.
21 Nukë dotë hani asndonjë gjë që ngorth
prej vetiu; (munt t' j'a apç atë të-huajit që
është përbrënda dyervet të tua, që t' e hajë;
a munt t' j'a shesç ndonjë kombi të-huaj;) se-
pse je gjindje e-shënjtëruarë te Zoti, Perën-
dia yt.

Nukë dotë zjesh kec ndë qumështt të
s' ëmësë.

22 Dotë apç pa fjalë të-dhjettën' e gjithë
pronjavet të farësë s' ate, që të sjell ara për
23 vit. Edhe dotë hash përpara Zotit, Perëndisë
t' ënt, nd' *atë* vënt që të sgjedhë për të vënë
emërin' e tij atje, të-dhjettën' e grurit t' ënt,
e të verësë s' ate, e të vajit t' ënt, edhe të-
parëlindurit' e lopëvet të tua e të dhënvet
të tua; që të mësonesh t' i kesh frikë Zotit,
Perëndisë t' ënt.
24 Edhe ndë qoftë udha fort lark për ty, ka-
që sa të mos munç t' i shpjesh ato, sepse
është fort lark prej teje *ay* vënt, të-cilinë dotë
sgjedhë Zoti, Perëndia yt, për të vënë emë-
rin' e tij atje, kur dotë të bekonjë Zoti, Pe-
25 rëndia yt, Atëhere dot' i bënjç ato ergjënt, e
ergjëndinë dot' e lithç mbi dorët t' ënde, edhe
dotë veç nd' atë vënt që dotë sgjedhë Zoti,

26 Perëndia yt; Edhe dot'a apç ergjëndinë për
çdo gjë që dëshëron shpirti yt, për qe, a për
dhen, a për verë, a për të-pira të-forta, a për
çdo gjë që kërkon shpirti yt prej teje; edhe
dotë hash atje përpara Zotit, Perëndisë t' ënt,
27 edhe dotë gëzonesh, ti, edhe shtëpia jote; Edhe
Levitinë që është përbrënda dyervet të tua
nukë dot' e lësh; sepse ay s' ka pjesë as
trashëgim bashkë me ty.
28 Ndë funtt të çdo tre vjetve dotë bjesh gji-
thë të-dhjettën' e të-ardhuravet të tua t' atij
viti, edhe dot'a vësh përbrënda dyervet të tua;
29 Edhe Leviti, (sepse ay s' ka pjesë as trashë-
gim bashkë me ty,) e i-huaji, e i-varfëri, e
e-veja, që janë përbrënda dyervet të tua, të
vinjënë, e të hanë, e të nginjenë; që të të be-
konjë Zoti, Perëndia yt, ndë gjithë punërat
të dorësë s' ate që punon.

Krye 15.

1 Edhe ndë funtt të çdo shtatë vjetve dotë
2 bënjç liri. Edhe këjo është mënyra e liri-
së; çdo huadhenës, çdo që t' i ketë dhënë
hua të-afërmit të tij, dot' j'a lërë ati; nukë
dot' e kërkonjë nga i-afërmi i tij e nga vë-
3 llaj i ti; sepse liria e Zotit ulëçit. Nga i-
huaji munt t'a kërkonjç; po çdo që të ketë
yt vëlla prej t' ëndevet dora jote dot' *j'a* lërë
4 *ati;* Që të mos ketë të-vobek te ti; sepse
Zoti me të-vërtetë dotë të bekonjë ndë dhet

që të ep Zoti, Perëndia yt, për trashëgim që
5 të zotëronjç mbi atë; Vetëmë ndë dëgjofsh
me kujdes zërin' e Zotit, Perëndisë t' ënt,
që të vësh re të bëjsh gjithë këto porosi
6 që po të urdhëronj unë sot. Sepse Zoti, Pe-
rëndia yt, dotë të bekonjë, sikundrë t' uzo-
tua; edhe dot' u huajsh shumë kombeve; po
ti nukë dotë huhesh; edhe dotë mbretëronjç
përmbi shumë kombe, po mbi ty s' kanë për
të mbretëruarë.
7 Ndë qoftë me ty ndonjë i-vobek, ndonjë
nga vëllezërit' e tu, përbrënda dyervet të tua,
ndë dhet t' ënt që të ep Zoti, Perëndia yt,
nukë dotë ashpëronjç zëmërënë t' ënde, as
dotë mbyllç dorënë t' ënde nga yt vëlla *që*
8 *është* i-vobek; Po me të-vërtetë dot' e hapç
dorënë t' ënde tek ay, edhe pa fjalë dot' i
huajsh ati mjaft për nevojën' e ati, ndë të-ci-
9 lët gjëndetë. Shiko të mos shkonjë mendim
i-keq ndë zëmërët' t' ënde, e të thuash, Po
afëronetë i shtatëti vit, viti i lirisë; edhe syri
yt të bënetë i-keq kundrë t' ët vëllaj të-vo-
bek, edhe të mos i apç ati asgjë; e ay të
thërresë mbë Zotinë kundrë teje, e të zihetë
10 ty për faj. Pa fjalë dot' i apç ati, edhe zë-
mëra jote nukë dotë hidhëronetë, kur t'i apç
ati; sepse për këtë gjë Zoti, Perëndia yt, dotë
të bekonjë ndë gjithë punërat të tua, edhe
11 ndë çdo gjë që të vësh dorënë t' ënde. Sepse
nukë dotë mbetetë kurrë dheu yt pa të-vo-

bek; përandaj unë po të urdhëronj, e po të them, Pa fjalë dotë hapç dorënë t' ënde te yt vëlla, te i-nevojshimi yt, edhe te i-vobeku yt, ndë dhet t' ënt.

12 Ndë ushittë te ti yt vëlla, Ebre a Ebrejkë, edhe të të shërbenjë gjashtë vjet, atëhere të-shtattinë vit dot'a lësh atë të-liruarë të shko-
13 një prej teje. Edhe kur t'a lësh atë të liruarë të shkonjë prej teje, nukë dot' e lësh të shko-
14 një duar-thatë; Dot' i apç ati me dorë tëhapurë nga dhënt' e tua, e nga lëmi yt, e nga tirra jote; dot' i apç atij sipas gjësë që
15 të ka bekuarë Zoti, Perëndia yt. Edhe dotë kujtonesh, se rop ke qënë ndë dhet të Egjyptësë, edhe të çpërbleu Zoti, Perëndia yt; përandaj unë po të urdhëronj këtë gjë sot.

16 Po ndë të thëntë, Nukë dal prej teje; sepse të deshi ty edhe shtëpinë t' ënte, sepse
17 është mirë me tynë, Atëhere dotë marrç një shtijëzë, e dot' i çponjç veshinë te dera, edhe dotë jetë shërbëtori yt për gjithënjë. Kështu dot' i bësh edhe shërbëtoresë s' ate.

18 Nukë dotë të vinjë rëndë, kur t'a lësh atë të shkonjë i-liruarë prej teje; sepse të shërbeu dy herë më tepërë se një shërbëtuar i-pajtuarë, gjashtë vjet; edhe Zoti, Perëndia yt, dotë të bekonjë mbë çdo që të bënjç.

19 Gjithë meshkujtë të-parëlindurë, që lindenë prej lopëvet të tua e prej dhënvet të tua, dotë j'a përhieronjç Zotit, Perëndisë t' ën

nukë dotë bësh punë me të-parëlindurin' e lopësë s' ate, as dotë qethç të parëlindurin' e
20 delesë s' ate. Për mot dot'a hash atë përpara Zotit, Perëndisë t' ënt, ti, edhe shtëpia jote, nd' atë vënt që të sgjedhë Zoti.
21 Edhe ndë pastë ndonjë të-metë, *si* ndë qëntë i-çalë, a i-verbërë, a ndë pastë ndonjë të-metë të-keqe, nukë dot'a bësh atë kurban
22 te Zoti, Perëndia yt. Përbrënda dyervet të tua dot'a hash atë; i-papastrëti e i-pastrëti *dot'a hajë atë* radhazi, posi kapruallinë e posi
23 drerinë. Vetëmë nukë dotë hash gjakun' e ati; posi ujë dot'a derthç përmbi dhet.

Krye 16.

1 Ruaj muajn' e Abibit, edhe bëj-i pashkënë Zotit, Perëndisë t' ënt; sepse ndë muajt të Abibit natënë të nxori Zoti, Perëndia yt,
2 nga dheu i Egjyptësë. Dot' i bënjç pra kurban pashkënë Zotit, Perëndisë t' ënt, prej dhënsh e prej qesh, nd' atë vënt që të sgje-
3 dhë Zoti për të ndënjur' atje emëri i ti. Nukë dot' e hash atë me bukë të-mbrumurë; shtatë dit dotë hash me atë bukë të-pambrumurë, po, bukën' e shtrëngimit, (sepse me nxitim dolle nga dheu i Egjyptësë;) që gjithë ditt' e jetësë s' ate të kujtonjç ditën' e të-
4 dalit t' ënt nga dheu i Egjyptësë. Edhe shtatë dit të mos duketë brumë te ti ndër gjithë sinorët të tu; edhe nga mishi që bëre kurban

ditën' e-parë mbrëmanet të mos mbetetë asgjë tërë natënë gjer ndë mëngjest.

5 Nukë munt të bënjç kurban pashkënë as mbë ndonjë nga qytetet' e tu, që të ep Zoti,
6 Perëndia yt; Po nd' atë vënt që të sgjedhë Zoti, Perëndia yt, që të rrijë atje emëri i tij, atje dotë bënjç kurban pashkënë mbrëmanet, mbë të-perënduarët të djellit, nd' *atë* kohë që
7 dolle nga Egjypta. Edhe dot'a pjekç e dot'a hash atë nd' atë vënt që të sgjedhë Zoti, Perëndia yt; edhe ndë mëngjest dotë kthe-
8 nesh e dotë veç ndë tendat të tua. Gjashtë dit dotë hash bukë pa brumë; edhe të-shtattënë ditë dotë jetë përmbledhje e-shënuarë për Zotinë, Perëndinë t' ënt; nukë dotë bënjç asndonjë punë.

9 Dotë numëronjç shtatë javë për vetëhenë t' ënde; dotë zësh të numëronjç *këto* të-shtatë javë, që nga koha që zure të vësh drapërinë
10 ndë grunjat të-lashta. Edhe dotë mbash tëkremten' e javëvet për Zotinë, Perëndinë t' ënt, dyke dhënë dhurëti me dorënë t' ënde atë që të dojë zëmëra jote për të prurë, sipas asaj që dotë të ketë bekuarë Zoti, Pe-
11 rëndia yt. Edhe dotë gëzonesh përpara Zotit, Perëndisë t' ënt, ti, e yt bir, e jot' bijë, e shërbëtori yt, e shërbëtoreja jote, e Leviti që është përbrënda dyervet të tua, e i-huaji, e i-varfëri, e e-veja, që janë ndë mest t' ënt, nd' atë vënt që të sgjethnjë Zoti, Perëndia yt, që

12 të rrijë atje emëri i tij. Edhe dotë kujtonesh se ke qënë shërbëtuar ndë Egjyptë; edhe dotë ruanjç e dotë bënjç këto urdhërata.

13 Dotë mbanjç të-kremten' e tendë-ngrehjesë shtatë dit, passi të mblethç pronjat' e
14 lëmit e të tirrësë s' ate; edhe dotë gëzonesh ndë të-kremtet t' ënde, ti, e yt bir, e jot' bijë, e shërbëtori yt, e shërbëtoreja jote, e Leviti, e i-varfëri, e e-veja, që janë përbrënda dy-
15 ervet të tua. Shtatë dit dotë kremtëronjç për Zotinë, Perëndinë t' ënt, nd' atë vënt që dotë sgjethnjë Zoti; sepse Zoti, Perëndia yt, dotë të bekonjë ndë gjithë pronjat të tua, e ndë gjithë punërat të duarvet të tua; edhe dotë jesh fare i-gëzuarë.

16 Tri herë ndë vitt dotë dukenë gjithë meshkujt' e tu përpara Zotit, Perëndisë t' ënt, nd' atë vënt që të sgjedhë; të-kremten' e pabrumjevet, të-kremten' e javëvet, edhe të-kremten' e tendë-ngrehjevet; edhe nukë dotë du-
17 kenë përpara Zotit me duar të-sbrazëta; Gjithësicili do të apë sa të muntnjë, sipas bekimit që të ka dhënë Zoti, Perëndia yt.

18 Dotë vësh gjykatës e të-parë për vetëhënë t' ënde ndëpër gjithë qytetet të tu, që të ep Zoti, Perëndia yt, pas faravet të tua; edhe dotë gjykonjënë gjindjenë me gjyq të-drejtë.

19 Nukë dotë bëjsh gjyq të-shtrëmbërë; nukë dotë mbash anë asnjeriu; as dotë marrç mtë; sepse mita verbon syt' e të-urtëvet, edhe pish

20 fjalët' e të-drejtëvet. Dotë veç fare pas së-
drejtësë, që të rrosh e të trashëgojsh atë dhe-
në që të ep Zoti, Perëndia yt.
21 Nukë dotë mbjellç për vetëhenë t' ende
pyll as prej ndonjë farë druri përanë the-
rores' së Zotit, Perëndisë t' ent, që dotë bënjç
22 për vetëhenë t' ënde; As dotë bëjsh idhull
për vetëhenë t' ëndë; gjerëra të-cilatë i mër-
zit Zoti, Perëndia yt.

Krye 17.

1 Nukë dot' i bënjç kurban Zotit, Perëndisë
t' ënt, ka a berr, që të ketë të-metë, a ndo-
një gjë të-keqe; sepse e ka të-ndyrë Zoti,
Perendia yt.
2 Ndë ugjëntë ndë mest t' ënt, brënda ndë
ndonjë nga qytetet' e tu që të ep Zoti, Pe-
rëndia yt, burr' a grua, që bën atë që ësht'
e-keqe përpara Zotit, Perëndisë t' ënt, dyke
3 shkelurë dhiatën' e ati, Edhe vete e lus pe-
rëndira të-tjerë, e u falet' atyre, a djellit, a
hënësë a ndonjëj nga ushtëria e qiellit, *gjë*
4 që s' e kam urdhëruarë; Edhe t' epetë zë ty,
edhe e dëgjove, atëhere dotë vëshgosh me
kujdes; edhe na, nde qëntë e-vërtetë, edhe
puna e-pakundrështuarshime, se një e-këtillë
5 ndyrësi upunua ndë Israilt, Atëhere dot'a
bjesh jashtë ndë dyert të tua atë burrë a
atë grua që dotë ketë bërë këtë punë të-ke-
qe, po, burrinë a gruanë; edhe dot' u bjesh
me gurë, që të vdesënë.

6 Me gojën' e dy dëshmimtarëve, a tre
dëshmimtarëve, dotë vritetë ay që është për
të vrarë; me gojën' e një dëshmimtari nukë
7 dotë vritetë. Duart' e dëshmimtarëvet dotë jenë
të-paratë mbi atë, për të vrar' atë, edhe pas-
taj duart' e gjithë gjindjesë. Kështu dotë
nxierrç të-keqenë nga mezi yt.
8 Ndë qëlloftë ndonjë punë fort e-vështirë
që t'a gjykonjç, ndë mes gjaku e gjaku, ndë
mes gjyqi e gjyqi, e nde mes të-rrahuri e të-
rrahuri, punëra, për të-cilatë hahenë përbrën-
da qytetevet të tu, atëhere dotë ngrihesh e
dotë hippënjç nd' atë vënt që dotë ketë sgje-
9 dhurë Zoti, Perendia yt; Edhe dotë vish te
priftëritë Levitër, edhe te gjykatësi që dotë
jetë ato dit, e dote pyeç; edhe *ata* dotë të
10 dëftenjënë vendimin' e gjyqit; Edhe dotë bënjç
pas fjalës' së vendimit, që dotë të rrëfenetë
nga ay vëndi që dotë ketë sgjedhurë Zoti;
edhe dotë kujdesesh të bënjç pas gjith' aty-
11 reve që dotë të mësonjënë; Pas fjalës' së
nomit që të kanë për të mësuarë, edhe pas
gjyqit që të kanë për të thënë, dotë bënjç;
nukë dotë priresh nga vendimi që dotë të
rrëfenjënë, *as* mbë të-djathtë as mbë të-
12 mëngjërë. Edhe ay njeri që punon me ma-
dhështi, e nuk' i dëgjon priftit që rri atje
për të shërbyerë përpara Zotit, Perëndisë t'
ënt, a gjykatësit, po, ay njeri dotë vritetë;
edhe kështu dotë nxjerrç të-keqenë nga Is-

13 raili. Edhe gjithë gjindja dotë dëgjonjë, e
dotë frikësonetë, edhe nukë dotë punonjënë
më me madhështi.
14 Kur të hynjç nd' atë dhe që të ep Zoti,
Perendia yt, e t'a bënjç t' ëndinë, e të rrish nd'
atë, edhe të thuash, Dotë vë mbret mbi mua,
posi gjithë kombetë që janë rreth e rrotullë
15 meje, Me të-vërtetë ke për të vënë mbret
mbi ty atë që të sgjethnjë Zoti, Perëndia yt;
një nga vëllezërit' e ty dotë vësh mbret mbi
ty; nukë munt të vësh mbi ty njeri të-huaj,
njeri që s' është vëllaj yt.
16 Vetëmë nukë dotë shumonjë kuaj për ve-
tëhen' e ti, as dotë bjerë përsëri gjindjenë
nd' Egjyptë, me qëllim që të shtonjë *numë-*
rin' e kuajvet; sepse Zoti u tha juve, Nukë
17 dotë kthehi më nd' atë udhë. As dotë shu-
monjë gratë për vetëhen' e tij, që të mos gë-
njenetë zëmëra e ati; as dotë shumonjë fort
ergjënt e ar për vetëhen' e tij.
18 Edhe kur të rrijë mbi front të mbretëris'
së tij, dotë shkruanjë për vetëhen' e ti një
kundrëshkrim të këti nomi mbë një vivli
nga *ajo vivlia që është* përpara priftërvet Le-
19 vitër; Edhe këtë dot'a ketë me vetëhe, edhe
dot'a këndonjë gjithë ditt' e jetës' së tij; që
të mësonetë t' i ketë frikë Zotit, Perëndis'
së tij, të ruanjë gjithë fjalët' e këti nomi, e
20 këto urdhërata, që t' i bënjë ato; Që të mos
lartonetë zëmëra e ati përmbi vëllezërit' e ti,

edhe të mos priretë nga porositë mbë të-djathtë a' mbë të-mëngjërë; që të bënetë ditë--gjatë ndë mbretërit të ti, ay edhe të bijtë, ndë mest të Israilit.

Krye 18.

1 Priftëritë Levitër, gjithë fara e Leviut, nukë dotë kenë pjesë as trashëgim me Israilinë; kanë për të ngrënë dhurëtit' e Zotit që bënenë me anë zjarri, edhe trashëgimn' e ati.
2 Përandaj nukë dotë kenë trashëgim ndë mest të vëllezërvet të tyre; Zoti është trashëgimi i atyre, sikundrë u tha atyre.
3 Edhe këjo dotë jetë e-drejt' e priftërvet nga gjindja, nga ata që bënjënë kurban, a ka a berr; dot' i apënë priftit shpatullënë,
4 edhe të dy nofullatë, edhe plëndësinë. Pemët' e-para të grurit t' ënt, të verësë s' atë, e të vajit t' ënt, e leshin' e-parë të dhënvet të tua,
5 dot' j'a apç ati. Sepse atë sgjodhi Zoti, Perëndia yt, nga gjithë farat' e tua, që të rrijë përpara për të shërbyerë mb' emërit të Zotit, ay edhe të bijt' e ati për *gjithë* jetënë.
6 Edhe ndë arthtë ndonjë Levit prej ndonjëj të qytetevet të tu, nga çdo an' e Israilit, ndë të-cilët rri, e të vinjë me gjithë mallin' e shpirtit të tij nd' atë vënt që të sgjeth-
7 një Zoti, Atëhere dotë shërbenjë mb' emërit të Zotit, Perëndis' së tij, posi gjithë të vëllezërit' e ti Levitër, që rrin' atje përpara Zo-

8 tit. Dotë kenë pjesë si-një-një për të ngrë-
në, përveç asaj që u vjen nga të-shiturit' e
gjës' s' atërvet të tyre.
9 Kur të hynjç nd' atë dhe që të ep Zoti,
Perëndia yt, të mos xesh të bësh sipas të-
10 ndyravet t' atyre kombeve. Të mos gjëndetë
te ti ndonjë *njeri* që shkon ndëpër zjarrt të
birrë a të bijënë, a që shtje shortë, a që
njeh kohëratë që përpara, a që shikon të-flu-
11 turuarëtë, a magjistar, A kënkëtuar, a që flet
më djajtë, a që bën çudira, a që pyet të-
12 vdekuritë. Sepse kushdo që bën këto ësht'
i-ndyrë të Zoti; edhe për punë të këtyre
ndyrësive Zoti, Perëndia yt, i dëbon ata që
13 përpara teje. I-sosurë të jesh përpara Zotit,
14 Perëndisë t' ënt. Sepse këta kombe që dotë
pushtonjç u dëgjonjën' atyre që njohënë ko-
hëratë që përpara, e shortëthënësvet; po sa
për ty, Zoti Perëndia yt, nukë të la ty të
bëjsh kështu.
15 Zoti, Perëndia yt, dotë ngrerë te ti një
profit nga mezi yt, nga vëllezërit' e tu, posi
16 mua; atij t' i dëgjoni; Pas gjith' atyreve që
kërkove prej Zotit, Perëndisë t' ënt, ndë Ho-
rib ndë ditët të përmbledhjesë, kur the, Letë
mos dëgjonj më zën' e Zotit, Perëndisë t' im,
as të mos shoh më këtë zjarr të-math, që të
17 mos vdes. Edhe Zoti më tha, Mirë thanë sa
18 që folnë. Dot' u ngre atyre një profit nga
mezi i vëllezërvet t' atyre, posi ty; edhe dotë

vë fjalët' e mia ndë gojët t' ati, edhe dot' u
flasë atyre gjith' ato që dot' i urdhëronj unë
19 atij. Edhe ay njeri që të mos u dëgjonjë fja-
lëvet të mia që dot' u flasë ay mb' emërit
t' im, unë e kam për të kërkuarë këtë prej atij.
20 Po ay profit që dotë kuxonjë të flasë mb'
emërit t' im fjalë që s' e kam urdhëruarë atë
t'a flasë, a ay që të flasë mb' emërit të pe-
rëndirave të-tjerë, ay profit dotë vritetë.
21 Edhe ndë thënç ndë zëmërët t' ënde, Qysh
dot'a njohëm' atë fjalë që nuk' e ka folurë
22 Zoti? Kur të flasë ndonjë profit mb' emërit
të Zotit, edhe ajo fjalë të mos dalë, as të
mos bënetë, këjo është një fjalë që nuk' e
ka folurë Zoti; profiti e foli atë me madhë-
shti; nukë dotë kesh frikë prej atij.

Krye 19.

1 Kur të shuanjë Zoti, Perëndia yt, ata kom-
be, dhen' e të-cilëvet Zoti, Perëndia yt, po
t'a ep ty, e të trashëgonjç ata, e të rrish ndër
qytetet t' atyreve, e ndër shtëpirat t' atyreve,
2 Dotë ndajsh ndë mest të dheut t' ënt, që të
ep Zoti, Perëndia yt, për të pushtuar' atë, tre
3 qytete për vetëhenë t' ënde. Dotë bëjsh gati
udhënë për vetëhenë t' ënde; edhe dotë ndajsh
mbë tri pjesë sinorët' e dheut t' ënt, që të ep
Zoti, Perëndia yt, për të trashëguar' atë, që
çdo njerivrasës të muntnjë të ikënjë atje.
4 Edhe këjo është regulla për njerivrasësi-

në, i-cili dotë ikënj' atje edhe dotë rronjë;
kushdo që vret të-afërmin' e ti pa dashurë,
edhe pa pasurë mëri kundr' ati më përpara,
5 Posi ay që vete bashkë me të-afërmin' e ti
ndë pullt për të prerë dru, edhe, tek dor' e
ti po bje me sopatë për të prerë drurinë, del
sopata nga bishti, e godit të-afërmin' e tij,
edhe ay vdes; ky të ikënjë ndë një nga ata
6 qytete, edhe dotë shpëtonjë jetëne; Semos e
ndjekë shpagim-marrësi i gjakut, tek është'
e-ndezurë zëmër' e atij, edhe e arrin, (ndë
qëntë udha e-largë,) edhe e vret atë, ndo-
nëse nuk' është për të vrarë, sepse nukë
kishte mëri kundr' ati më përpara.
7 Përandaj unë po të urdhëronj, e po të
them, Te ndajsh tre qytete për vetehenë t'
8 ënde. Edhe ndë sgjeroftë Zoti, Perëndia yt,
sinorët' e tu, sikundrë u është përbetuarë
atërvet të tu, edhe të t' apë gjith' atë dhe,
9 të-cilin' uzotua t' u'a apë atërvet të tu, Ndë
ruajç gjithë këto porosi, për të bër' ato, që
po të urdhëronj une sot, të duash Zotinë,
Perëndinë t' ënt, edhe të eçënjç gjithënjë nd'
udhët t' ati, atëhere dotë shtojsh për vetëhenë
10 t' ënde edhe tre qytete ndër këta të tre; Që
të mos derdhetë gjak i-pafajm ndë mest të
dheut t' ënt, të-cilinë po të ep ty Zoti, Pe-
rëndia yt, për trashëgim, edhe kështu të *mos*
mbetetë gjak mbi ty.
11 Po ndë pastë mëri kundrë të-afërmit të

ti, edhe të rrijë ndë pritë për atë, edhe të ngrihetë kundr' ati, e t' i bjerë ati për vdekje, edhe ay të vdesë, edhe të ikënjë mbë
12 ndonjë nga këta qytete, Atëhere të dërgonenë pleqt' e qytetit t' ati e t'a marrënë s' andejmi , edhe t'a apënë ndë dorët t' ati që ker-
13 kon çpagimn' e gjakut, që të vritetë. Syri yt të mos ketë përdëllim për atë, po të shuash nga Israili *fajin' e të-derdhurit* gjak të-pafajm, që të të vejë mbarë.
14 Mos luaj nga vëndi kufinjt' e të-afërmit t' ënt, që kanë vënë që moti ndë trashëgimt t' ënt, që dotë trashëgojsh nd' atë dhë që të ep Zoti, Perëndia yt, për të pasur' atë.
15 Një dëshmimtar *i-vetëmë* të mos dalë kundrë ndonjë njeriu për ndonjë paudhëri, a për ndonjë faj, për çdo faj që të ketë fëjyerë; me gojën' e dy dëshmimtarëve, a me gojën' e tre dëshmimtarëve, dotë vërtetonetë çdo punë.
16 Ndë daltë ndonjë dëshmimtar i-paudhë kundrë ndonjë njeriu, për të dëshmuarë kun-
17 drë ati për ndonjë paudhëri, Atëhere të dy njerëzitë, ndë mest të të-cilëvet është puna, dotë qëndronjenë përpara Zotit, përpara priftërvet e gjykatësvet që dotë jenë nd' ato
18 dit; Edhe gjykatësitë dotë shikonjënë me kujdes; edhe na, ndë është dëshmimtari dëshmimtar i-rrem, edhe dëshmoj me të-rrem
19 kundrë vëllajt të ti, Atehere dot' i bëni atij, sikundrë mendoj t' i bënte vellajt të ti; kë-

shtu dotë nxjerrç të-keqenë nga mezi yt.
20 Edhe të-tjerëtë dotë dëgjonjënë e dotë frikësonenë, edhe nukë dotë bënjënë më pas-
21 këtaj të-tillë të-keqe ndë mest t' ënt. Edhe syrit t' ënt të mos i vinjë keq; dotë epetë jetë ndë vënt jete, sy ndë vënt syri, dhëmp ndë vënt dbëmbi, dorë ndë vënt dore, këmbë ndë vënt këmbe.

Krye 20.

1 Kur të dalç mbë luftë kundrë armiqvet të ty, e të shohç kuaj e qerre, edhe gjëndje më tepërë se ti, mos u kij frikë atyre; sepse Zoti, Perëndia yt, që të nxori nga dheu i Egjyptësë, është bashkë me ty.
2 Edhe kur të afërohi ndë luftët, prifti dotë
3 qaset' afërë, e dot' i flasë gjindjesë, E dot u ftotë atyre, Pa dëgjo, o Israil; ju po afërohi sot ndë luftë kundrë armiqvet t' uaj; letë mos u frikësonetë zëmëra; mos kini frikë, as mos trëmbi, as mos tmerohi nga faqeja
4 e atyre; Sepse Zoti, Perëndia juaj, ësht' ay që shkon përpara bashkë me ju, që të lëftonjë për ju kundrë armiqvet t' uaj, që t' u shpëtonjë juve.
5 Edhe të-parëtë dot' i flasënë gjindjesë, e dot' i thonë, Cili ësht' ay njeri që ka ndërtuarë shtëpi të-rë, edhe s' e ka *edhe* përhieruarë atë? letë shkonjë, e letë kthenetë ndë shtëpit të tij, semos vdesë ndë luftët, e tje-

6 tërë njeri e përhieron atë. Edhe cili ësht' ay njeri që ka vënë veshtë, edhe nukë ka ngrënë *edhe* nga pem' e ati? letë ikënjë, e letë kthenetë ndë shtëpit të ti, semos vdesë ndë luftët, e tjetëre njeri ha nga pem' e
7 ati. Edhe cili ësht ay njeri që është vluarë me grua, edhe nuk' e ka marr' atë? letë i-kënjë, e letë kthenetë ndë shtëpit të ti, semos vdesë ndë luftët, edh' e merr atë tjetërë
8 njeri. Edhe të-parëtë dot' i flasën' edhe më gjindjesë, e dot' i thonë, Kush është frikacar e i-pakuxuarshim let' ikënjë, e letë kthenetë ndë shtëpit të tij, semos tretetë zëmër' e të
9 vëllezërvet t' atij, posi zëmëra e atij. Edhe si të mbaronjënë të-parëtë së foluri gjindjesë, dotë vënë krerë të ushtërivet, që të jenë mbi kryet të gjindjesë.
10 Kur të afëronesh ndë ndonjë qytet për
11 të lëftuarë kundr' ati, *më* përpara thirr-e atë ndë paqtim; E ndë t' upërgjeqtë me paqtim, e të të hapnjë *dyertë*, atëhere gjithë gjindja që gjëndetë nd' atë të vihetë ndënë pagë,
12 e të të shërbenjë. Po ndë mos dashtë të bënjë paqtim me ty, edhe do të bënjë luftë kundrë teje, atëhere dot'a qerthëllonjç atë;
13 Edhe kur të t'a apë ndë dorë Zoti, Perëndia yt, dotë vrasç çdo mashkull t' ati me presjen'
14 e shpatësë; Po gratë, e të-vegjëlitë, e bagëtitë, gjithë ç' gjëndenë ndë qytett, po, gjithë plaç-kat' e ati dot' i marrç për vetëhenë t ënde; edhe

dotë hash plaçkat' e armiqvet të tu, që të dha Zoti, Perëndia yt.

15 Kështu dotë bënjç ndër gjith' ata qytete, që janë shumë lark prej teje, të-cilëtë nukë
16 janë prej qytetevet të këtyre kombeve. Po nga qytetet' e këtyre gjindjeve, që të ep Zoti, Perëndia yt, për trashëgim, nukë dotë
17 lësh të rronjë asdonjë gjë e-gjallë; Po dot' i shuanjç ata fare; Hittitëtë, e Amoritëtë, Hanaanitëtë, e Ferizzitëtë, Hivitëtë, e Jebusitëtë,
18 sikundrë të urdhëroj Zoti, Perëndia yt; Që të mos u mësonjënë juve të bëni pas gjithë ndyrësiravet t' atyre, që u bëninë perëndiravet të tyre, e të fëjeni kundrë Zotit, Perëndisë t' uaj.

19 Kur të qerthëllonjç ndonjë qytet shumë kohë, e të bënjç luftë kundrë ati për të pushtuar' atë, dotë mos prishç drurët' e ati dyke sjellë sopatënë kundrë atyreve; sepse prej atyreve munt të ushqehesh; edhe dotë mos
20 i presç ata. Sepse njeri eshtë drur' i fushësë, që të qerthëllonetë prej teje? Vetëmë drurëtë që i di se nukë janë drurë *për të dhënë* pemë, këta dot' i prishç e dot' i presç; edhe dotë bënjç fortesa kundrë qytetit që lëfton me ty, gjersa të bjerë.

Krye 21.

1 Ndë ugjentë ndonjë i-vrarë ndë dhet që po të ep Zoti, Perëndia yt, për të trashëgu-

ar' atë, rënë ndë fushët, edhe të mos dihetë
2 cili e ka vrarë; Atëhere dotë dalënë pleqt' e tu e gjykatësit' e tu, e dotë masënë *mërgimnë* gjer ndë qytetet që janë rreth e rro-
3 tullë të-vrarit; Edhe qyteti që të jetë më afërë të-vrarit, do-me-thenë pleqt' e ati qyteti dotë marrënë një mëshqere, e-cila të mos jetë vënë ndë punë, as të mos ketë he-
4 qurë sgjedhë; Edhe pleqt' e atij qyteti dot'a sbresënë mëshqerenë ndë një fushëzë me ujë që rrjeth, e-cila as lëronetë, as mbilletë; e-dhe atje ndë fushëzët t' i prësënë qafënë mëshqeresë.
5 Edhe priftëritë, të bijt' e Leviut, dotë a-fëronenë; (sepse ata sgiodhi Zoti, Perëndia yt, që t' i shërbenjën' ati, edhe të bekonjënë mb' emërit të Zotit; edhe pas fjalës' s' atyre dot' i *epetë funt* çdo qarte e çdo plage;)
6 Edhe gjithë pleqt' e atij qyteti që është më afërë të-vrarit dotë lanjënë duart' e tyre mbi
7 mëshqeret të-therurë ndë fushëzët; Edhe dotë përgjigjen' e dotë thonë, Duartë t' ona s' e kanë derdhurë këtë gjak, as sytë t' anë s' e
8 kanë parë. Ndjej-e, o Zot, llauzinë t' ënt Is-rail që çpërbleve, edhe mos duro *të mbetetë faji i të-derdhurit* gjak të-pafajm ndë mest të llauzit t' ënt Israil. Edhe dot' u ndjenetë
9 atyre gjaku. Kështu dotë heqç nga mezi yt *të-derdurit'* e gjakut të-pafajm, kur të bësh atë që ësht' e-drejtë ndër syt të Zotit.

10 Kur të dalç të lëftojsh kundrë armiqvet
të tu, edhe Zoti, Perëndia yt, t' i apë ata
ndër duart të tua, e të marrç skllever nga
11 ata, E të shohç ndër mest të skllevërvet
ndonjë grua të-bukurë, edhe ndjen dashuri
12 mb' atë, edhe do t'a marrç për grua; Dot' a
bjesh atë ndë shtëpit t' ënde, edhe dot' i
13 rruajsh kryetë, e dot' i presç thonjtë; E dot'
i svesç rrobat' e skllavërisë që përsipër' a-
saj, e dotë rrijë ndë shtëpit t' ènde, e dotë
qanjë t' an' e t' ëmënë një muaj te-tërë; e
pastaj dotë hyjsh te ajo, e dotë jesh burri i
14 asaj, edhe ajo dotë jetë gruaja jote. Edhe
ndë godittë të mos të pelqenjë, atëhere dot'a
lësh të vejë ku të dojë; po nukë dot'a shesç
ate asfare me ergjënt, as dot'a përdorç si
skllave, sepse e përunje atë.
15 Ndë pastë ndonjë dy gra, njërënë të-da-
shurë, e tjetërënë të-mërziturë, edhe e-da-
shura edhe e-merzitura t' i pjellën' atij djem,
edhe i-parëlinduri bir të jet' i së-mërzitu-
16 rësë, Atëhere, atë ditë që të bënjë të bijtë
të trashëgonjënë *gjënë* që ka, nukë munt të
bënjë birin' e së-dashurësë për të-parëlin-
durë bir përpara djalit të së-mërziturësë, i-
17 cili është *me të-vërtetë* i parëlinduri; Po dotë
njohë për të-parëlindurë të birin' e së-mër-
ziturësë, edhe dot' i apë atij dy pjesë nga
gjithë ç' ka; sepse është kryet' e fuqis' s' ati;
të-drejtat' e të-parëlindurit janë të këtij.

18 Ndë pastë ndonjë *njeri* bir zëmërak e të-
pabindurë, që nuk' i dëgjon zërit të t' et, a
zërit të s' ëmësë, edhe, ndonëse e mundo-
19 njënë, nukë do t' u dëgjonj' atyre, Atëhere
i ati e e ëma dot'a zënë, e dot'a nxjerrënë te
pleqt' e qytetit t' atij, edhe ndë portët të
20 vëndit t' atij; E dot' u thonë pleqvet të qy-
tetit t' atij, Ky biri ynë është zëmërak e i-
pabindurë, nuk' i dëgjon zërit t' ënë; është
21 plankprishës e pianec. Atëhere gjithë njerë-
zit' e qytetit t' ati dot' i bjenë me gurë, e
dotë vritetë. Kështu dotë heqç të-keqenë nga
mezi yt; edhe gjithë Israili dotë dëgjonjë, e
dotë frikësonetë.
22 Edhe ndë pastë ndonjë njeri faj për të vra-
rë, edhe të dënonetë ndë vdekje, e t'a varç atë
23 mbi dru, Të mos mhetetë trupi i atij tërë
natënë mbi drut, po t'a klasç pa fjalë ndë
varr q' atë ditë, (Sepse i-varuri është i-ma-
llëkuarë nga Perëndia;) që të mos pëgërç
dhenë t' ënt, të-cilinë po t' ep Zoti, Perëndia
yt, për trashëgim.

Krye 22.

1 Nde pafsh kan' e t' yt vëllaj a delen' e
ati se kanë humbur' udhënë, nukë dotë bë-
hesh sikur nuk' i sheh; pa fjalë dot' i *për-*
2 *mblethç e dot' i* shpiesh tek yt vëlla. Edhe
ndë qottë se yt vëlla nukë rri afërë teje, a
se nuk' e njeh atë, atëhere dot' e bjesh ndë

shtëpit t' ënde, edhe dotë jetë bashkë me ty
gjersa t'a kërkonjë yt vëlla, edhe dot' j'a apç
3 ati prapë. Kështu dotë bëjsh edhe me go-
marin' e atij; kështu dotë bëjsh edhe me
rrobën' e atij. Kështu dotë bëjsh edhe me
çdo gjë të-humburë të t' yt vëllaj, që e ka
humburë, e e ke gjeturë ti; nukë munt të
bëhesh sikur nuk' i sheh.
4 Ndë pafsh gomarin' e t' yt vëllaj a kan'
e ati të-rëne nd' udhët, nukë dotë bëhesh
sikur nuk' i sheh; pa fjalë dot' i ndihç ati
t' i ngrerë prapë.
5 Gruaja nukë dotë veshnjë *rroba* burri, as
burri nukë dotë vishetë me rroba gruaje;
sepse kushdo që bën kështu ësht i-ndyrë të
Zoti, Perëndia yt.
6 Ndë qëlloftë të jetë mb' udhë përpara
teje ndonjë fole shpesi mbi ndonjë dru a
përdhe, me zoq a me ve, edhe e ëma të ketë
ndenjurë mbi zoqt a mbi vet, nukë dotë
marrç mëmënë bashkë me te-vegëlit' *e asaj;*
7 Memënë me çdo mënyrë dot'a lësh të shko-
një, po të-vegëlitë munt t' i marrç për ve-
tëhenë t' ënde; që të të vejë mbarë, e të jesh
ditë-gjatë.
8 Kur të ndërtosh shtëpi të-re, dotë bënjç
një të-thururë përqark pulazit t' ënt, që të mos
bjesh gjak mbë shtëpinë t' ënde, ndë rentë
ndonjë njeri q' andej.
9 Nukë dotë mbjellç ndë veshtët t' ënt dy

lloj farash, që të mos prishetë tërë pronja, fara që mbolle, edhe pema e veshtit.
10 Nukë dotë lërojsh me ka e me gomar bashkë.
11 Nukë dotë veshç rrobë të-përzjerë, lesh e li bashkë.
12 Nukë dotë bëjsh tufëza mbë të katrë çipet të rrobësë s' ate me të-cilënë mbulonesh.
13 Ndë marrtë ndonjë njeri grua, e të hynjë te ajo, e t'a mërzitnjë atë, e t'apë shkak të
14 flasënë keq për atë, e t' i nxjerrë emërë tëlik, e të-thotë, Mora këtë grua, edhe, kur i uafërova, nukë gjeta tek ajo shënja të vër-
15 gjirisë, Atëhere i at' i vashësë edhe e ëm' e asaj dotë marrën' e dotë bjenë shënjat' e vërgjiris' së vashësë te pleqt' e qytetit ndë por-
16 tët; Edhe i at' i vashësë t' u thotë pleqvet, I dhashë t' ime bijë këtij njeriu për grua,
17 edhe ay e mërzit; Edhe na tek dha shkak të flasënë keq *për atë*, sepse thotë, Nukë gjeçë tek jot' bijë shënjat' e vërgjirisë; po na tek janë shënjat' e vërgjiris' së s' ime bijë. Edhe dotë hapnjënë rrobënë përpara pleqvet të qy-
18 tetit. Edhe pleqt' e ati qyteti dot'a marrën'
19 atë njeri, e dota mundonjënë; E dot'a dënonjënë ndë çdëmim një qint shekllash ergjëndi, e dot j'a apënë ato t' et të vashësë, sepse i nxori emërë të-lik një vërgjireshe Israilite; edhe dotë jetë gruaj' e ati; nukë dotë mun-
20 një t'a përzërë gjithë jetën' e tija. Po nd' është

këjo punë e-vërtetë, edhe të mos gjëndenë
21 te vasha shënjat' e vërgjirisë, Atëhere dot'a nxjerrënë vashënë ndë derët të shtëpis' së t' et, edhe njerëzit' e qytetit t' asaj dot' i bjenë me gurë, edhe dotë vdesë; sepse punoj marrëzi ndë Israilt, dyke bërë kurvëri ndë shtëpit të t' et. Kështu dotë nxjerrç të-keqenë nga mezi yt.
22 Ndë ugjënttë ndonjë njeri rënë me grua të-martuarë me burrë, atëhere që të dy dotë vritenë, burri që ra me gruanë, edhe gruaja. Kështu dotë nxjerrç të-keqenë nga Israili.
23 Ndë është vluarë me burrë ndonjë vashë
vërgjireshë, edhe t'a gjenjë atë ndonjë njeri
24 ndë qytett, e të bjerë bashkë me atë, Atehere dot' i nxirni ata të dy ndë portët t' atij qyteti, edhe dot' u shtini me gurë, që të vdesënë; vashënë, sepse nukë thërriti, kur ishte ndë qytett; edhe njerinë, sepse përunji gruan' e të-afërmit të tij. Kështu dotë nxjerrç të-keqenë nga mezi yt.
25 Po ndë e gjettë njeriu nd' arët vashën' e-
vluarë, edhe njeriu t'a shtrëngonjë atë, e të bjerë bashkë me atë, atëhere dotë vritetë
26 vetëmë njeriu që ra bashkë me atë; Po vashësë nukë dot' i bëjsh asgjë; te vasha nukë ka faj për vdekje; sepse këjo punë është sikur një njeri të ngrihetë kundrë t' afërmit
27 të ti, edhe t'a vrasë; Sepse e gjeti nd' arët; vasha e-vluarë thërriti, po atje s' kishte njeri t'a shpëtonte.

28 Ndë gjettë ndonjë njeri vashë vërgjireshë,
që të mos jet' e-vluarë, edhe t'a zër' atë, e
29 të bjerë me atë, edhe të gjëndenë; Atëhere
njeriu qe ra me vashënë dot' i apë t' et të
vashësë pesë qint *shekla* ergjëndi, edhe ajo
dotë jetë gruaj' e ati, sepse e përunji atë;
nukë munt t'a lëshonj' atë tërë jetën' e tij.
30 Asndonjë nukë dotë marrë gruan' e t' et,
as dotë sbulonjë anën' e mbulesës' së t' et.

Krye 23.

1 Kush të ketë mbolet' e tia të-shtypura, a
të-këputura, nukë dotë hynjë ndë mbledhjet
2 të Zotit. Doçi nukë dotë hynjë ndë mble-
dhjet të Zotit; gjer mbë të-dhjettinë bres
nukë dotë hynjë ndë mbledhjet të Zotit.
3 Ammonit a Moabit nukë dotë hynjë ndë
mbledhjet të Zotit; gjer mbë të-dhjettinë bres
të tyre kurrë nukë dotë hynjënë ndë për-
4 mbledhjet të Zotit; Sepse nuk' u duallë juve
përpara me bukë e me ujë ndë udhët, kur
dualltë nga Egjypta; edhe sepse pajtuanë
kundrë teje Ballaaminë, të birin' e Beorit, nga
Pethori i Mesopotamisë, që të të mallëkonte.
5 Me gjithë këto Zoti, Perëndia yt, nukë deshi
t' i dëgjonte Ballaamit; po Zoti, Perëndia yt,
e ktheu mallëkimnë ndë bekim për ty, sepse
6 Zoti, Perëndia yt, të deshi. Gjithë ditt' e tua
ndë jetët *të jetëvet* nukë dotë kërkonjç paq-
timin' e atyre, as të-mirën' e atyre.

7 Nukë dot' e kesh të-mërzitur Edomitnë;
sepse është vëllaj yt; nukë dot' e kesh të-
mërzitur Egjyptianinë; sepse ke qënë i-huaj
8 ndë dhet t' ati. Djemtë që lintnjënë nga ata
të-tretinë bres dotë hynjënë ndë përmble-
dhjet të Zotit.
9 Kur të dalç ndë luftë kundrë armiqvet
të tu, dotë ruhesh prej çdo gjëje së-keqe.
10 Ndë qëntë ndë mest t' ënt ndonjë njeri që
s' ësht' i-pastrëtë për gjë që i gjau atij na-
tënë, dotë dalë jashtë fushatësë, nukë dotë
11 hynjë brënda ndë fushatët; po ndaj mbrëma
dotë lahetë me ujë, edhe si të perëndonjë
12 djelli, dotë hynjë brënda ndë fushatët. Edhe
dotë kesh një vënt jashtë fushatësë, edhe
13 atje dotë dalç për të dalë jashtë; Edhe dotë
kesh një terplotë *të-vogëlë* ndë mest t' armë-
vet të tua; edhe kur të dalç jashtë, dotë rëmosh
me atë, edhe dotë kthenesh e dotë mbulosh
14 të-dalëtë t' at. Sepse Zoti, Perëndia yt, ecën
ndë mest të fushatësë s' ate, që të të shpë-
tonjë, e t' apë ndë dorë armiqt' e tu përpara
teje; përandaj fushata jote dotë jet' e-shënj-
tëruarë; që të mos shohë ndonjë ndyrësi te
ti, e të mos kthenetë prej teje.
15 Nukë dotë apç ndë dorët të të zot ndo-
një shërbëtuar që ka ikurë nga i zoti *e udha*
16 *ndë dorët* t' ënde; Dotë rrijë bashkë me ty,
ndë mest t' ënt, nd' atë vënt që të sgjethnjë

përbrënda dyervet të tua, tek t' i pëlqenjë;
nukë dot' e shtrëngonjç atë.
17 Nukë dotë ketë kurvë nga të bijat' e Is-
railit, as dotë ketë të-shkërdhuerë nga të bijt'
18 e Israilit. Nukë dotë bjesh pagë kurve, as
pagesë qëni, ndë shtëpit të Zotit, Perëndisë
t' ënt, për asndonjë kushtim; sepse që të
dyja këto janë të-ndyra te Zoti, Perëndia yt.
19 Nukë dot' i huajsh t' yt vëllaj ergjënt me
uzurë, të-ngrëna me uzurë, asndonjë gje që
20 epetë hua me uzurë. Të-huajit munt t' i huash
me uzurë; po t' yt vëllaj nukë dot' i huajsh
me uzurë; që të të bekonjë Zoti, Perëndia
yt, mbë çdo që të vesh dorënë, nd' atë dhe
qe po vete për të trashëguar' atë.
21 Kur dot' i kushtonesh ndonjë kushtim
Zotit, Perëndisë t' ënt, nukë dotë mënojsh
t' j'a apç atë; sepse Zoti, Perëndia yt, me
të-vërtetë dot'a kërkonjë atë prej teje, edhe
22 dotë jetë faj për ty. Po ndë mos daç të ku-
23 shtonesh, nukë dotë jetë faj për ty. Çdo që
del prej buzëvet të tua dot'a ruajsh edhe
dot'a bëjsh; sikundrë i ukushtove Zotit, Pe-
rëndisë t' ënt, dhurëtinë prej vetiu, që uzo-
tove me gojënë t' ënde.
24 Kur të hynjç ndë veshtët të të-afërmit t'
ënt, munt të hash rrush pas dëshirësë s' ate,
gjersa të nginesh; po nukë dotë vësh ndë enët
25 t' ënde. Kur të hynjç ndë grunjat të të-afër-
mit t' ënt, munt të këpuç kallinj me dorënë

t' ënde; po nukë munt të vësh drapër ndër grunjat të të-afërmit t' ënt.

Krye 24.

1 Kur të marrë ndonjë njeri grua, edhe të martonetë me atë, edhe të goditnjë të mos gjenjë hir ndë syt t' ati, sepse gjeti tek ajo gjë që s' gjan të jetë, atëhere dot' i shkruanjë asaj kartë ndarjeje, edhe dot' j'a apë ndë dorët, edhe dot'a dëbonjë nga shëpia e ti.
2 Edhe *ajo* si të ikënjë nga shtëpia e ati, munt
3 të vejë e të martonetë me tjetërë burrë. Edhe ndë e mërzittë atë i-dyti burrë, e t' i shkruanjë asaj kartë ndarjeje, e t' j'a apë ndë dorët, edhe t'a dëbonjë atë nga shëpia e tij, a ndë vdektë burri i-dytë, i-cili e mori për grua,
4 Burr' i-parë i asaj që e pat lëshuarë atë nukë munt t'a marrë atë prapë për grua, passi u-pëgë; sepse këjo *punë* ësht' e-ndyrë përpara Zotit; edhe nukë dotë bëjsh të fëjenjë dheu që po t' ep Zoti, Perëndia yt, për trashëgim.
5 Ndë pastë marrë grua ndonjë njeri rish-tazi, *ay* nukë dotë dalë ndë luftë, as dot' i ngarkonetë ndonjë punë; dotë jet' i-lirë një vit ndë shtëpit të tij, edhe dotë gëzonjë gruan' e tij që mori.
6 Nukë dotë marrë njeri për penk as të-siprëminë as te-poshtërminë gur të mullirit; sepse merr jetë *njeriu* për penk.
7 Ndë uzëntë ndonjë njeri se vodhi ndo-

një vetë nga vëllezërit' e ti, nga të bijt' e Israilit, edhe e përdor atë si skllaf, a e shet, atëhere ky vjedhës dotë vritetë; edhe *kështu* dotë heqç të-keqenë nga mezi yt.

8 Kij kujdes plagën' e krromësë, që t' e ruajsh me kujdes, e të bëjsh sipas atyreve që dotë të mesonjënë priftëritë, Levitëritë; si-kundrë i urdhërova ata, kështu dotë kini
9 kujdes të bëni. Kujtohu ç' i bëri Mariamësë Zoti, Perëndia yt, nd' udhet, passi dualltë nga Egjypta.

10 Kur t' i huajsh ndonjë gjë të-afërmit t' ënt, nukë dotë hynjç ndë shtëpit t' ati për
11 të marrë pengun' e ati. Dotë qëndronjç jashtë, edhe njeriu që i huan dotë t' a bjerë
12 ty pengunë jashtë. Edhe ndë qëntë njeri i-vobek, nukë dotë flesh me pengun' e ati;
13 Pa fjallë dot' j'a apç prapë, ndaj të-perënduarit të djellit, që të flerë ndë rrobët të tij, e të të uronjë; edhe dotë jetë drejtëri mbi ty përpara Zotit, Perëndisë t' ënt.

14 Nukë dotë mundonjç shërbëtuar të-pa; tuarë, që është i-vobek ε skamës, ose nga vëllezërit' e tu është, ose nga të-huajt' e tu që janë ndë dhet t' ënt, përbrënda dyervet të
15 tua. Q' atë ditë dot' j'a apç pagën' ati, as të perëndonjë djelli mb' atë; sepse ësht' i-vobek, edhe zëmërën' e ti e ka vënë mb' atë; që të mos kelthasë kundrë teje mbë Zotinë, e të zihetë për faj.

16 Atëritë nukë dotë vritenë për djemtë, as djemtë nukë dotë vritenë për atëritë; çdo njeri dotë vritetë për fajin' e tij.

17 Nukë dotë bëjsh shtrëmbërë gjyqin' e të-huajit, *as* të të-varfërit, as rrobën' e të-vesë

18 dotë marrç për penk; Po dotë kujtonesh se ke qënë rop nd' Egjyptë, edhe Zoti, Perëndia yt, të çpërbleu s' andejmi; përandaj unë po të urdhëronj të bënjç këtë punë.

19 Kur të korrç të-korrëtë t' ënt nd' arët t' ënde, edhe të harronjsh ndonjë dorëzë nd' arët, nukë dotë kthenesh t'a marrç; letë jetë për të-huajinë, për të-varfërinë, e për të-venë; që të të bekonjë Zoti, Perëndia yt, ndër gjithë punërat të duarvet të tua.

20 Kur të shkunç ullinjt' e tu, nukë dotë për koqç përsëri degatë; dotë jetë për të-huajnë, për të-varfërinë, e për të-venë.

21 Kur të vjelç veshtinë t' ënt, nukë dot' e përkoqsh përsëri; dotë jetë për të-huajinë,

22 për të-varfërinë, e per të-venë. Edhe dotë kujtonesh, se ke qënë skllaf ndë dhet t' Egjyptësë; përandaj unë po të urdhëronj të bënjç këtë punë.

Krye 25.

1 Ndë gjaftë ndonjë grindje ndë mes njerësve, edhe të vinjënë ndë gjyq, *e gjykatësitë* t' i gjykonjënë, atëhere dotë nxjerrënë të-drejtë të-drejtinë, edhe dotë dënonjënë fajtorinë.

2 Edhe ndë është fajtori për të urrahurë,
gjykatësi dotë urdhëronjë t'a vënë poshtë, e-
dhe dotë rrihetë përpara faqes' s' ati, sipas
3 fajit t' atij, me numër. Dyzet shkopinj munt
t' i bjerë atij, jo më tepërë; semos, ndë te-
përoftë e i bjerë ati më tepërë se kaqë shko-
pinj, duketë yt vëlla i-poshtëruarë ndër syt
të ty.
4 Nukë dotë lithç gojën' e kaut, kur shin.
5 Ndê vëllezër rrinë bashkë, edhe njëri nga
ata të vdesë, e të mos ketë djem, gruaja
e të-vdekurit nukë dotë martonetë jashtë mbë
ndonjë të-huaj; i vëllaj i burrit t' asaj dotë
hynjë tek ajo, edhe dot'a marr' atë për grua,
edhe dot' i mbushnjë asaj detyrën' e kunatit.
6 Edhe i-parëlinduri që dotë pjell' ajo dotë
quhetë mb' emërit të vëllajt t' atij të-vdekurë,
7 që të mos shuhetë emër' i atij nga Israili. Po
ndë mos dashtë njeriu të marrë gruan' e të
vëllajt, atëhere gruaja e të vëllajt letë vejë
ndë portët te pleqtë, e let' *u* thotë, I vëllaj i
t' im shoq s' do t' i ngrerë të vëllajt emërë
ndë Israilit; s' do të me lanjë detyrën' e
8 kunatit. Atëhere pleqt' e qytetit t' ati dot' e
thërresënë, e dot' i flasën' atij; edhe ay ndë
9 qëndroft' e të thotë, S' dua t'a marr; Atëhere
gruaja e të vëllajt dotë vinjë tek ay për-
para pleqvet, edhe dotë sgithnjë shollëzen'
e atij prej këmbës' s' atij, edhe dot'a pshty-
një ndë faqet, edhe dotë përgjigjet' e t' *i* thotë,

Kështu dot' i bënet' atij njeriu që s' do të
10 ndërtonjë shtëpin' e të vëllajt. Edhe emër' i atij dotë quhetë ndë Israilt, Shtëpia e ati që ka të-sgidhurë shollëzën' e tij.
11 Ndë qoftë së zihenë njerës njëri me tjatërinë, edhe gruaja e njërit afëronetë për të shpëtuarë burrin' e saj nga dora e atij që e rreh, edhe të sgjatnjë dorën' e saj e t'a zërë
12 nga mboletë, Atëhere t' i presç dorën' asaj; syrit t' ënt nukë dot' i dhëmbetë për atë.
13 Nukë dotë kesh ndë thest t' ënt zigje të-
14 ndryshm, të-math e të-vogëlë. Nukë dotë kesh ndë shtëpit t' ënde masa të-ndryshme, të-
15 madhe e të-vogëlë. Dotë kesh ziq të-vërtetë e të-drejtë; që të shumohenë ditt' e tua mbi
16 dhet që po të ep Zoti, Perëndia yt. Sepse gjith' ata që bënjënë këto, gjith' ata që bënjënë paudhëri, janë të-ndyrë te Zoti, Perëndia yt.
17 Kujtohu se ç' të bëri Amaliku mb' udhët,
18 kur dualltë nga Egjypta; Si të priti udhësë, edhe të vrau *njerëzit'* e-prapësm, gjith' ata që ishinë të-pafuqishim prapa teje, tek ishe i-lodhur' e i-këputurë; edhe s' pat frikë nga
19 Perëndia. Përandaj Zoti, Perëndia yt, kur të t' apë të-prëjturë nga të-gjith' armiqt' e tu rreth e rrotullë, nd' atë dhe që të ep Zoti, Perëndia yt, për trashëgim që t'a trashëgonjç atë, *atëhere* dotë shuajsh emërin' e Amalikut që përposh qjellit; nukë dotë harronjç.

Krye 26.

1 Edhe kur të hynjç nd' atë dhe që të ep
Zoti, Perëndia yt, për trashëgim, edhe t'a
2 pushtonjç atë, e të rrish nd' atë, Dotë marrç
nga *dor'* e-parë e gjithë pemëvet të dheut,
të-cilatë dot' i mblethç nga dheu yt, që të ep
Zoti, Perëndia yt, edhe dot' i vësh ndë një
çportë, edhe dot' i shpjesh nd' atë vënt që të
sgjethnjë Zoti, Perëndia yt, për të ndënjur'
3 atje emëri i tij. Edhe dotë veç të prifti, që
dotë jetë ndër ato dit, e dot' i thuash ati,
Po i ap sot zë Zotit, Perëndisë t' ënt, se hyra
nd' atë dhë, për të-cilinë u upërbetua Zoti
4 atërvet t' anë të na e apë. Edhe prifti dotë
marrë çportënë nga dora jote, edhe dot'a vërë
përpara therores' së Zotit, Perëndisë t' ënt.
5 Edhe dotë flasç e dotë thuash përpara
Zotit, Perëndisë t' ënt, Im atë ish një Syrian
që kishtë humburë udhënë, edhe sbriti nd'
Egjyptë, edhe ndënji atje i-huaj *e* i-pakë nga
numëri; edhe atje ubë komp i-math, *e* i-fortë,
6 e i-shumë; Edhe Egjyptianëtë na munduanë
keq, e na shtrënguanë, e vunë mbi ne një
7 skllavëri të-aspërë; Edhe klithmë mbë Zo-
tinë, Perëndin' e atërvet t' anë, edhe Zoti
dëgjoj zënë t' ënë, edhe pa shtrëngimnë t' ënë,
8 e mundimnë t' ënë, e acarimnë t' ënë; Edhe
Zoti na nxori nga Egjypta me dorë të-fortë,
e me krah të-ndejturë, e me çudira të-mëdha,

9 e me shënja, e me mërekulli; Edhe na pruri
ndë këtë vënt, edhe na dha këtë dhe që rrjeth
10 qumësht e mjaltë. Edhe tashi, na tek prura
të-paratë pemë t' atij dheut që më dhe ti,
o Zot.

Edhe dot' i vësh ato përpara Zotit, Perëndisë t' ënt, edhe dotë falesh përpara Zo-
11 tit, Perëndisë t' ënt. Edhe dotë gëzonesh për gjithë të-miratë që të dha Zoti, Perëndia yt, ty edhe shtëpisë s' ate, ti, edhe Leviti, edhe i-huaji që është ndë mest t' ënt.

12 Si të mbarojsh së dhjetuari gjithë të-dhjettat' e drithit t' ënt mbë të-tretinë vit, i-cili është moti i të-dhjetuarit, dot' j'a apç Levitit, *e* të-huajit, *e* të-varfërit, e së-vesë, që të hanë përbrënda portavet të tua, e të nginjenë;
13 Edhe dotë thuash përpara Zotit, Perëndisë t' ënt, Nxora nga shtëpia ime ato që ishinë të-shënjtëruara, edhe u'a dhash' ato Levitit, *e* të-huajit, *e* të-varfërit, e së-vesë, pas gjithë urdhërimevet që më urdhërove; nukë shkela asnjë nga porosit' e tua, as nuk' i harrova;
14 Nukë hëngra nga ato ndë vajët t' ime, as mora nga ato, dyke qën' i-papastrëtë, as nukë dhashë prej atyreve për të-vdekurë; i dëgjova zërit të Zotit, Perëndisë, t' im; bëra
15 pas gjith' atyreve që më urdhërove. Vështro poshtë nga shtëpia jote e-shënjtëruarë, nga qjelli, edhe beko gjindjenë t' ënde Israil, edhe dhenë që na dhe, sikundrë u upërbetove

atërvet t' anë, *atë* dhenë që rrjeth qumësht e mjaltë.

16 Sot të urdhëroj Zoti, Perëndia yt, të bëjsh këta urdhërime e këta gjyqe; përandaj dot' i bësh me gjithë zëmërënë t' ënde e me gjithë
17 shpirtinë t' ënt. Sot tregove, se Zoti dotë jetë Perëndia yt, edhe se dotë ecënjç ndë udhët t' atij, edhe se dotë ruajsh urdhërimet' e atij, e gjyqet' e atij, edhe se dot' i dëgjonjç
18 zërit t' atij; Edhe Zoti të tregoj sot se dotë jesh tek ay gjindje e-veçantë, sikundrë t' uzotua ty, edhe se dotë ruajsh gjithë porosit' e
19 ati; Edhe se dotë të bënjë ty të-lartë përmb i gjithë kombet që ka bërë, për lavdi, e për emërë, e për nder; edhe dotë jesh gjindje eshënjtëruarë te Zoti, Perëndia yt, sikundrë foli.

Krye 27.

1 Edhe Moisiu edhe pleqt' e Israilit urdhëruanë gjindjenë, dyke thënë, Ruani gjithë po-
2 rositë që po u urdhëronj unë sot. Edhe atë ditë që dotë kapërxeni Jordaninë për nd' atë dhe që t' ep Zoti, Perëndia yt, dotë ngrehç për vetëhenë t' ënde gurë të-mëdhenj, edhe
3 dot' i lyenjç me këlqere; Edhe dotë shkruajsh mbi ata gjithë fjalët' e këtij nomi, si të kapërxenjç *Jordaninë*, që të hynjç nd' atë dhe që të ep Zoti, Perëndia yt, *nd' atë* dhe që rrjeth qumesht e mjaltë, sikundrë t' uzotua Zoti, Perëndia i atërvet të tu.

4 Përandaj, si të kapërxeni Jordaninë, dotë
ngrihni këta gurë, që po u urdhëronj unë
sot, ndë malt t' Eballit, edhe dot' i lyenjç
5 me këlqere. Edhe atje dot' i ndërtonjç the-
rore Zotit, Perëndisë t' ënt, therore prej gu-
6 rësh; hekurë nukë dotë shkonjç mbi ata. Dot'
e ndërtojsh therorën' e Zotit, Perëndisë t' ënt,
prej gurësh të-tërë, edhe dot' i bjesh mbi
atë Zotit, Perëndisë t' ënt, *dhurata* të-gjithë-
7 djegura; Edhe dotë bjesh dhurata paqtimi,
edhe dotë hash atjë; edhe dotë gëzonesh
8 përpara Zotit, Perëndisë t' ënt; Edhe dotë
shkruajsh mbi gurët gjithë fjalët' e këtij no-
mi fort çquarë.

9 Edhe Moisiu e priftëritë Levitër i folnë
gjith' Israilit, e thanë, Hesht, edhe dëgjo, o
Israil; këtë ditë ubëre gjindje e Zotit, Pe-
10 rëndisë t' ënt. Dot' i dëgjosh pra zërit të Zo-
tit, Perëndisë t' ënt, e dotë bëjsh porosit' e
atij, e urdhërimet' e atij, që po të urdhëronj
unë sot.

11 Edhe Moisiu urdhëroj gjindjenë atë ditë,
12 e tha, Këta dotë qëndronjënë mbi malt të
Gjerizinit, që të bekonjënë gjindjenë, si të
kapërxeni Jordaninë; Simoni, e Leviu, e Ju-
13 da, e Issahari, e Josifi, e Beniamini; Edhë
këta dotë qëndronjënë mbi malt të Eballit.
që të mallëkonjënë: Rubini, Gadi, e Ashiri, e
14 Zabulloni, Dani, e Nefthaliu. Edhe Levitëritë
dotë flasënë, e dot' u thonë gjithë njerësvet
të Israilit me zë të-math,

15 Qoft' i-mallëkuar' ay njeri që të bënjë i-dhull të-gdhëndur' a të-derdhurë, të-ndyrë te Zoti, punë duarsh mjeshtëri, e t' a vërë lart *ndë vënt* të-fshehurë. Edhe gjithë gjindja dotë përgjigjet' e dotë thotë, Amin.

16 Qoft' i-mallëkuarë kush të shanjë t' anë a t' ëmënë. Edhe gjithë gjindja dotë thotë, Amin.

17 Qoft' i-mallëkuarë kush të luanjë vëndit kufirin' e t' afërmit të tij. Edhe gjithë gjindja dotë thotë, Amin.

18 Qoft' i-mallëkuarë kush të bënjë të-verbërinë të humbasë udhënë. Edhe gjithë gjindja dotë thotë, Amin.

19 Qoft' i-mallëkuarë kush t' ja bënjë shtrëmbërë gjyqinë të-huajit, e të-varfërit, e së-vesë. Edhe gjithë gjindja dotë thotë, Amin.

20 Qoft' i-mallëkuarë kush të bjerë me gruan' e t' et; sepse sbuloj mbulesën' e t' et. Edhe gjithë gjindja dotë thotë, Amin.

21 Qoft' i-mallëkuarë kush të bjerë me çdo farë shtëze. Edhe gjithë gjindja dotë thotë, Amin.

22 Qoft' i-mallëkuarë kush të bjerë me të-motrënë, të bijën' e t' et a të bijën' e s' ëmësë. Edhe gjithë gjindja dotë thotë, Amin.

23 Qoft' i-mallëkuarë kush të bjerë me të-vjehërrënë. Edhe gjithë gjindja dotë thotë, Amin.

24 Qoft' i-mallëkuarë kush të vrasë fshehu-

raj të-afërmin' e tij. Edhe gjithë gjindja dotë thotë, Amin.

25 Qoft' i-mallëkuarë kush të marrë dhuratë për të vrarë njeri të-pafajm. Edhe gjithë gjindja dotë thotë, Amin.

26 Qoft' i-mallëkuarë kush nukë qëndron ndë fjalët të këtij nomi, për të bër' ato. Edhe gjithë gjindja dotë thotë, Amin.

Krye 28.

1 Edhe ndë i dëgjofsh me kujdes zërit të Zotit, Perëndisë t' ënt, për të ruajtur' *e* për të bërë gjithë porosit' e atij që po të urdhëronj unë sot, Zoti, Perëndia yt, të ka për të
2 lartuarë përmbi gjithë kombet' e dheut; Edhe gjithë këta bekime dotë vinjënë mbi ty, edhe dotë të gjenjënë, ndë i dëgjofsh zërit
3 të Zotit, Perëndisë t' ënt. Dotë jesh i-bekuarë ndë qytett, edhe i-bekuarë dotë jesh nd'
4 arët. E-bekuarë dotë jetë pema e barkut t' ënt, edhe pema e dheut t' ënt, edhe pema e bagëtivet të tua, të-shtuarët' e lopëvet të
5 tua, edhe të-vegjëlit' e dhënvet të tua. E-bekuarë dotë jetë çporta jote edhe mageja e
6 të-gatuarit t' ënt. I-bekuarë dotë jesh, kur të hynjç, edhe i-bekuarë dotë jesh, kur të dalç.

7 Armiqt' e tu, që ngrihenë kundrë teje, Zoti i ka për të berë të thyhenë përpara tejë; prej një udhe dotë dalënë kundrë teje, edhe

prej shtatë udhëve dot' ikënjënë përpara teje.
8 Zoti dotë dërgonjë bekimnë mbi ty ndë grunarët të tu, edhe ndë çdo që të vësh dorënë t' ënde; edhe Zoti, Perëndia yt, dotë të bekonjë nd' atë dhe që po t' ep.
9 Zoti dotë të bënjë për vetëhen' e tij gjindje të-shënjtëruarë, sikundrë t' upërbetua, ndë ruajsh porosit' e Zotit, Perëndisë t' ënt, edhë
10 ndë ecsh nd' udhët t' atij. Edhe gjithë gjindjet' e dheut dotë shohënë, se je quajturë me emërin' e Zotit; edhe dotë trishtonenë prej teje.
11 Edhe Zoti dotë të shumonjë të-miratë, pemën' e barkut t' ënt, e pemën' e bagëtivet të tua, e pemën' e dheut t' ënt, mb' atë dhe qe u upërbetua Zoti atërvet të tu të t' apë
12 ty. Zoti dotë të hapë thesarin' e tij të-mirë, qiellinë, që të apë shin' e dheut t' ënt ndë kohët të tij, edhe dotë bekonjë gjithë punët' e duarvet të tua; edhe dot' u huajsh shumë
13 kombeve, po ti nukë dotë huhesh. Edhe Zoti dotë të bënjë krye, e jo bisht; edhe dotë jesh vetëmë përsipërë, edhe nukë dotë jesh përposh, ndë u dëgjofsh porosivet të Zotit, Perëndisë t' ënt, që po të urdhëronj unë sot,
14 që t' i ruajsh e t' i bëjsh; Edhe nukë dotë priresh nga ndonjë prej fjalëvet që po u urdhëronj unë juve sot, mbë të-djathtët a mbë të-mëngjërët, që të veç prapa perëndive tëtjerë për të lutur' ata.

15 Po ndë mos i dëgjofsh zërit të Zotit, Pe-
rëndisë t'ënt, që të vësh re të bëjsh gjithë
porosit' e atij e urdhërimet' e atij që po të
urdhëronj unë sot, gjithë këta mallëkime
dotë vinjënë mbi ty, edhe dotë të gjenjënë.
16 I-mallëkuarë dotë jesh ndë qytett, e i-ma-
17 llëkuarë dotë jesh ndë arët. E-mallëkuarë
dotë jetë çporta jote, edhe magjeja e të-ga-
18 tuarit t' ënt. E-mallëkuarë dotë jetë pema e
barkut t' ënt, edhe pema e dheut t' ënt, të-
shtuarët' e lopëvet të tua, edhe të-vegjëlit' e
19 dhënvet të tua. Dotë jesh i-mallëkuarë, kur
të hynjç, edhe i-mallëkuarë dotë jesh, kur
të dalç.
20 Zoti dotë dërgonjë mbi ty mallëkim,
shtrëngim, e prisje, mbë gjithë sa të vësh do-
rënë t' ënde për të bërë, gjersa të prishesh
e të humbesh për-së-çpejti, për punë të të-
keqit të punëvet të tua, me anë të të-cila-
21 vet hoqe dorë prej meje. Zoti dotë të ngjit-
një murtajënë, gjersa të të shuanjë prej dhe-
22 ut, ku po vete që t'a trashëgonjç. Zoti të ka
për të rënë me të-fyshkurë, e me ethe, e me
të-përvëluarë, e me të-nxehëtë të-keq, e me
shpatë, e me erë prishjeje, e me bastrë, edhe
23 dotë të ndjekënë, gjersa të shuhesh. Edhe
qielli yt që është përsipërë kryesë s' ate
dotë jetë i-ramtë, edhe dheu përposh teje
24 i-hekurtë. Zoti dotë bënjë shinë e dheut t' ënt

pluhur e baltë; dotë sbresë nga qielli mbi ty,
gjersa të shuhesh.
25 Zoti dotë të bënjë të thyhesh përpara ar-
miqvet të tu; prej një udhe dotë dalç kundr'
atyreve, e prej shtatë udhëve dotë ikënjç
përpara atyreve; edhe dotë përndahesh
26 ndëpër gjithë mbretërit' e dheut. Edhe kër-
ma jote dotë jetë ushqim i gjithë shpesvet
t' egre të qiellit, edhe të bishavet të dheut,
27 edhe nukë dotë ketë njeri t' i trëmpnjë. Zoti
të ka për të rënë me plagën' e Egjyptësë, e
me të-rrjedhura gjaku, e me krromë, e me
të-kruajturë, prej të-cilavet sëmundje nukë
28 dotë munç të shëronesh. Zoti të ka për të
rënë me marrëzi, e me verbësirë, e me të-
29 habiturë zëmëre; Edhe dotë kërkojsh me dorë
ndë mest të ditësë, posi i-verbëri që kërkon
më dorë nd' errësirë, edhe nukë dotë veç
mbarë nd' udhët të tua; edhe vetëmë dotë
të mundonjënë e dotë të rjepënë gjithë dittë,
edhe nukë dotë ketë asdonjë të të shpëto-
30 një. Dotë vlonesh me grua, edhe tjetërë nje-
ri dotë bjerë *të flerë* me atë; dotë ndërtojsh
shtëpi, e nukë dotë rrish nd' atë; dotë vësh
veshtë, e nukë dotë hash nga pem' e atij.
31 Kau yt dotë theretë përpara syvet të tu, e-
dhe nukë dotë hash nga ay; gomari yt dotë
rrëmbehetë që përpara teje, edhe nukë dotë
të kthenetë prapë; dhënt' e tua dotë epenë ndë
dorët t' armiqvet të tu, edhe nukë dotë kesh

32 asdonjë të të shpëtonjë. Bijt' e tu e bijat' e
tua dotë epenë ndë tjetërë komp, edhe syt' e
tu dotë shohënë e dotë vdirenë dykë deshëru-
arë ata me mall gjithë ditënë; edhe nukë dotë
33 kesh fuqi ndë dorët t' ëndë. Pemën' e dheut
t' ënt, edhe gjithë mundimet' e tu, dot' i hajë
ndonjë komp që nuk' e njeh; edhe dotë jesh
vetëmë i-munduarë e i-shtypurë gjithë dittë.
34 Edhe dotë shkallojsh mënç nga të-parat'
e-tmeruara të syvet të tu që dotë shohç.
35 Zoti dotë të godinjë ndë gjunjët e ndë kof-
shët me plagë të-keqe, prej së-cilësë nukë
dotë munç të shëronesh, që nga sholla e
këmbësë e gjer ndë majët të kokësë.
36 Zoti dotë sjellë ty, edhe mbretinë që dotë
ketë vënë mbi ty, mbë një komp që nuk' e
ke njohurë ti, as atërit' e tu; edhe atje dotë
37 lusç perëndira të-tjerë, dru e gurë. Edhe dotë
jesh për të-maniturë, për fjalë udhësh, e për
të-treguarë ndë mest të gjithë kombevet,
kudo që të të shpjerë Zoti.
38 Dotë bjesh shumë farë nd' arët, e dotë
mblethç pak; sepse karkaleci dot' a hajë.
39 Dotë vësh vreshta, e dot' i punojsh, po nukë
dotë pish verë, as dotë vjelç; sëpse krimbi
40 dot' i hajë. Dotë kesh drurë ullinjsh ndë gji-
thë sinorët të tu, po me vaj nukë dotë lyhesh;
sepse ulinjt' e tu dotë bjenë përdhe *para se*
41 *të bënenë*. Dotë të lintnjënë bij e bija, po
nukë dotë jenë të tutë; sepse dotë venë ndë

42 skllavëri. Karkaleci dotë prishnjë gjithë dru-
43 rët' e tu e pemën' e dheut t' ënt. I-huaji që është ndë mest t' ënt dotë hipënjë përsipërë teje lart e më lart, e ti dotë sbresç posht' e
44 më poshtë. Ay dotë të huanjë, e ti nukë dot' i huajsh atij; ay dotë jetë krye, e ti dotë jesh bisht.
45 Edhe gjithë këta mallëkime dotë vinjënë mbi ty, e dotë të ndjekënë, edhe dotë të arrinjënë, gjersa të shuhesh; sepse nuk' i dëgjove zërit të Zotit, Perëndisë t' ënt, që të ruanje porosit' e ati e urdhërimet' e ati që të
46 urdhëroj; Edhe dotë jenë mbi ty e mbi farënë t' ënde gjithënjë për shënjë e për çudi.
47 Me-qënë-që nukë i shërbeve Zotit, Perëndisë t' ënt, me gëzim, e me gas të zëmërësë, për
48 plotësirën' e gjithë gjërëravet *që të dha*, Përandaj dot' u shërbejsh armiqvet të tu, që dotë dërgonjë Zoti kundrë teje, me uri, e me et, e me të-sveshurë, e me të-shterurë të gjithë gjërëravet; edhe dotë vërë mbi qafët t' ënde sgjedhë të-hekurtë, gjersa të të shuanjë.
49 Zoti dotë bjerë një komp kundrë teje prej së-largu, nga an' e dheut, posi me fluturim shqiponje; një komp, të-cilit nukë dot' i ku-
50 pëtojsh gjuhënë; Një komp me fytyrë t' ashpërë, i-cili nukë dotë ketë nder mbë faqen' e plakut, as dotë tregonjë përdëllim për të-
51 rinë; Edhe dotë hajë pemën' e bagëtivet të tua, edhe pemën' e dheut t' ënt, gjersa të

shuhesh; i-cili nukë dotë të lerë grurë, verë,
a vaj, të-shtuarët' e lopëvet të tua, a të-ve-
gjëlit' e dhënvet të tua, gjersa të të shuanjë.
52 Edhe dotë të qerthëllonjë ndër gjithë qy-
tetet të tu, gjersa të bjenë muret' e tu të-
lartë e të-thururë, mbë të-cilët shprenje ndë-
për gjithë dhenë t' ënt; edhe dotë të qerthë-
llonjë ndër gjithë qytetet të tu, ndëpër gjithë
53 dhenë t' ënt që të dha Zoti, Perëndia yt. Edhe
ndë të-qerthëlluarët e ndë shtrëngatët, me të-
cilënë dotë të shtrëngonjënë armiqt e tu, dotë
hash pemën' e barkut t' ënt, mishërat' e bij-
vet të tu e të bijavet të tua, që të dha Zoti,
54 Perëndia yt. Burri i-butë ndë mest t' ënt,
edhe fort i-dhëmçurë, dotë shikonjë me sy
të-keq mbë të vëllanë, e mbë gruan' e gjirit
të tij, edhe mbë djemt' e ti që i kanë mbeturë,
55 sa i mbetnë; Që të mos i apë asndonjëj nga
ata prej mishravet të djemvet të tij, të-cilëtë
dot' i hajë *vetë;* sepse nuk' i mbeti as farë
gjëje ndë të-qerthëlluarët, e ndë shtrëngatët,
me të-cilënë dotë të shtrëngonjë armiku yt
56 ndë gjithë qytetet të tu. Gruaja e-butë e e-
dhëmçurë ndë mest t' uaj, e-cila për dhëm-
çurinë e për butësirënë nukë dotë kuxonte
të vinte këmbën' e saj mbi dhet, dotë shi-
konjë me sy të-keq mbë burrin' e gjirit të
saj, edhe mbë të birin' e saj, e mbë të bijën
57 e saj, Edhe mbë foshnjën' e saj që ka dalë
nga mezi i këmbëvet të saj, edhe mbë djemt'

e saj që ka pjellë; sepse dot' i hajë fshehuraj, për të-shterurit' e gjithë gjërëravet, ndë të-qerthëlluarët e ndë shtrëngatët, me të-cilënë dotë të shtrëngonjë armiku yt ndër qytetet të tu.

58 Ndë mos vënjç re të bëjsh gjithë fjalët' e këtij nomi, që janë shkruarë ndë këtë vivli, dyke pasurë frikë nga ky emër' i-lavdu-
59 arë e i-frikshim, **Zoti, Perëndia yt,** Atëhere Zoti dotë bënjë plagët' e tua të-frikshime, edhe plagët' e farësë s' ate, po, plagë të-mëdha e të-papushuara, e sëmundje të-këqia e
60 të-papushuara. Edhe dotë sjellë mbi ty gjithë dhëmbjet' e Egjyptësë, prej të-cilavet dri-
61 dheshe, edhe dotë të ngjitenë. Edhe çdo *tjetërë* sëmundje, e çdo tjetërë plagë, që s' është shkruarë ndë vivlit të këtij nomi, këto dot' i
62 sjellë mbi ty, gjersa të shuhesh. Edhe nga numëri dotë mbeti të-pakë, ndonëse ishitë si yjt' e qiellit ndë shumicët; sepse nuk' i dëgjove zërit të Zotit, Perëndisë t' ënt.

63 Edhe sikundrë Zoti ugëzua mbë ju, që t' u bënte mirë juve, e t' u shumonte juve, kështu dotë gëzonetë Zoti mbë ju, që t' u prishnjë e t' u shuanjë juve; edhe dotë çkuli
64 nga dheu, ku po vete që t'a pushtonjç. Edhe Zoti dotë të çpërndanjë ndëpër gjithë kombetë, që nga njëra anë e dheut *e* gjer ndë tjetërët anë të dheut; edhe dotë lutni atje perëndira të-tjerë, të-cilëtë nuk' i ke njojturë

65 as ti, as atërit' e tu, dru e gurë. Po edhe ndë-
mest të këtyre kombeve nukë dotë gjesh
prëhje, edhe nukë dotë ketë të-prëjturë për
shollëzën' e këmbësë s' ate; edhe Zoti dotë-
të apë atje zëmërë të-trishtuarë, e të-errësu-
66 arë të syvet, e të-dridhurë të shpirtit. Edhe
jeta jote dotë jetë e-varurë ndë dyshim përpara
teje; edhe dotë kesh frikë nat' e ditë, edhe
nukë dotë kesh asnjë siguri të jetësë s' ate.
67 Ndë mëngjest dotë thuash, Makar të ishte
mbrëmje! edhe mbrëmanet dotë thuash, Ma-
kar të ishte mëngjes! për frikën' e zëmërësë
s' ate që dotë kesh frikë, edhe për të-parat'
e syvet të tu që dotë shohç.
68 Edhe Zoti dotë të shpjerë prapë ndë Egjyp-
të me ania, nga ajo udha, për të-cilënë të
thashë, Nukë dot'a shohç më atë tjetërë herë;
edhe dotë shitni vetëhenë t' uaj te armiqtë
t' uaj për shërbetorë e për shërbëtore, edhe
nukë dotë ketë njeri t' u blerë juve.

Krye 29.

1 Këto janë fjalët' e dhiatësë, që urdhëroj
Zoti Moisinë të bënjë me të bijt' e Israilit
ndë dhet te Moabit, përveç asaj dhiatësë që
kishte bërë me ata ndë Horib.
2 Edhe Moisiu thirri gjithë Israilinë, e u
tha atyre, Ju patë gjithë sa i bëri Zoti për-
para syvet t' uaj ndë dhet t' Egjyptësë Fa-
raonit, edhe gjithë shërbëtorëvet t' ati, edhe

3 gjithë dheut t' atij; *Ato* ngasjet' e-mëdha që
panë syt' e tu, *ato* shënjatë, edhe ato çudit'
4 e-mëdha; Po Zoti nuk' u dha juve zëmërë
që të kupëtoni, edhe sy që të shihni, edhe
5 veshë që të dëgjoni, gjer mbë këtë ditë. E-
dhe u hoqa juve udhënë dyzet vjet ndë shkre-
tëtirët; rrobatë t' uaj nuk' uvjetëruanë përsi-
përë jush, edhe këpuca jote nuk' uvjetërua ndë
6 këmbët t' ënde. Nukë hëngrëtë bukë, as nukë
pitë verë a të-pira të-forta; që t'a dini se
7 unë jam Zoti, Perëndia juaj. Edhe kur erthtë
ndë këtë vënt, Sihoni, mbreti i Heshbonit, e-
dhe Ogu, mbreti i Bashanit, duallnë kundrë
8 nesh për luftë, edhe neve i prishm' ata; E-
dhe pushtuamë dhen' e atyre, edhe u'a dha-
më për trashëgim Rubinitëvet, e Gaditëvet, e
9 gjysmësë farë së Manassitëvet. Ruani pra fja-
lët' e kësaj dhiate, edhe i bëni, që të vini
mbarë mbë gjithë punëtë që të bëni.
10 Ju sot që të-gjithë po qëndroni përpara
Zotit, Perëndisë t' uaj; krerëtë t' uaj, faratë
t' uaj, e të-parëtë t' uaj, gjithë burrat' e Is-
11 railit, Djemtë t' uaj, gratë t' uaj, e i-huaji yt,
i-cili është ndë mest të fushatësë s' ate, që
12 nga druvari juaj e gjer mbe atë që të mban
ujë; Që të hynjç ndë dhiatët të Zotit, Perën-
disë t' ënt, edhe ndë bet, që po bën Zoti
13 Perëndia yt, sot me ty; Që të të bënjë sot
gjindje për vetëhen' e tij, edhe ay të jetë te
ti Perëndi, sikundrë të tha ty, edhe sikun-

drë u upërbetua atërvet të tu, Abraamit, Isa-
14 akut, e Jakobit. Edhe unë nukë po bënj ve-
15 tëmë me ju këtë dhjatë e këtë be; Po edhe
me atë që rri këtu sot bashkë me ne për-
para Zotit, Perëndisë t' ënë, edhe me atë që
16 nukë eshtë këtu sot bashkë me ne; (Sepse
ju e dini, qysh ndënjmë ndë dhet t' Egjy-
ptësë, edhe qysh shkuamë ndëpër mest t'
17 atyre kombeve, ndëpër të-cilët shkuatë; Edhe
patë ndyrësit' e atyreve, e idhujt' e atyreve,
dru e gurë, ergjënt e ar, që ishinë ndë mest
18 t' atyreve;) Qe të mos ketë ndër ju burrë, a
grua, a shtëpi, a farë, zëmëra e të-cilëvet të
priretë sot nga Zoti, Perëndia ynë, që të vejë
e të lutnjë perëndirat' e atyre kombeve; që
të mos ketë ndër ju rrënjë që bje helm e
19 shtarë; Edhe kur të dëgjonjë fjalët' e këtij
mallëkimi, të *mos* lumëronjë vetëhen' e tij ndë
zëmërët të tij, dyke thënë, Unë dotë kem
paqtim, ndonëse jam dyke ecurë ndë ash-
përimt të zëmërësë s' ime, që të prish lagë-
20 sirënë me thatësirë. Zoti nukë dot'a ndjenjë
atë, po atëhere zëmërimi i Zotit edhe zilia
e ati dotë ndizenë kundrë atij njeriu; edhe
gjithë mallëkimetë që janë shkruarë ndë këtë
vivli dotë bjenë mbi atë, edhe Zoti dotë shu-
21 anjë emërin' e atij që përposh qjellit. Edhe
Zoti dotë ndanjë atë për prishje nga të-gji-
thë farat' e Israilit, sipas gjithë mallëkime-
vet të dhiatësë që janë shkruarë ndë këtë

22 vivli të nomit. Edhe brezi që ka për të ar-
dhurë, djemtë t' uaj që dotë ngrihenë pas
jush, edhe i-huaji që dotë vinjë prej dheu të-
largë, dotë thonë, kur të shohënë plagët' e
atij dheu, edhe sëmundjetë, me të-cilatë Zoti
23 e mundoj, *Edhe se* gjithë vëndi i atij dheu
është squfur e kripë, *edhe zjarr* që digjetë,
i-cili as mbilletë as mbin, as bar rritetë nd'
atë, pas prishjes' së Sodhomavet e të Gomor-
ravet, t' Admas' e të Seboimëvet, të-cilët' i
prishi Zoti ndë zëmërimt të tij e ndë mërit
24 të tij, Po, gjithë kombetë dotë thonë, Përse
Zoti j'a bëri kështu këtij dheu? Ç' do me
thënë të-ndezurit' e këtij zëmërimi të-math?
25 Atëhere njerëzitë dotë thonë, Sepse hoqnë
dorë nga dhiata e Zotit, Perëndis' s' atërvet
të tyre, që pat bërë me ata, kur i nxori nga
26 dheu i Egjyptësë; Edhe vanë e lutnë Perën-
dira të-tjerë, edhe u ufalnë atyreve, *po*, pe-
rëndirave, që nuk' i njihninë, e nuk' u'a pat
27 dhëne atyreve; Përandaj undes zëmërimi i
Zotit kundrë atij dheu, që të sjellë mbi atë
gjithë mallëkimetë që janë shkruarë ndë këtë
28 vivli; Edhe Zoti i çkuli ata prej dheut të
tyre me zëmërim, e me mëri, e me zëmëratë
të-madhe, edhe i hodhi ata ndë tjetërë dhe,
sikundrë janë sot.

29 Të-fshehuratë janë të Zotit, Perëndise t'
ënë; Po gjer'ratë që janë të-sbuluara janë

për ne edhe për bijtë t' anë gjithënjë, që të bëjmë gjithë fjalët' e këtij nomi.

Krye 30.

1 Edhe kur të vinjënë mbi ty gjithë këto
gjërëra, bekimi edhe mallëkimi, që vura për-
para teje, edhe t' i sjellç ndë mëndjet *t' ën-*
de ndë mest të gjithë kombevet, ku dotë të
2 ketë përndarë Zoti, Perëndia yt, Edhe të
kthenesh te Zoti, Perëndia yt, edhe t' i dë-
gjosh zërit t' atij me gjithë zëmërënë t' ënde,
e me gjithë shpirtinë t' ënt, ti edhe bijt' e
tu, pas gjith' atyreve që t' urdhëronj unë
3 sot, Atëhere Zoti, Perëndia yt, dotë kthenetë
atje ku je skllaf, edhe dot' i dhëmbetë për
ty, edhe përsëri dotë të përmbledhë nga gjithë
kombetë atje tek dotë të ketë përndarë Zoti,
4 Perëndia yt. *Edhe* ndë qofshinë të-përndarë
njerëzit' e tu ndë më të-largat anë të qiellit,
edhe q' andej dotë të përmbledhë Zoti, Pe-
rëndia yt, edhe q' andej dotë të kërkonjë;
5 Edhe Zoti, Perëndia yt, dotë të bjerë ndë
dhet që patnë atërit' e tu, edhe dot' e tra-
shëgonjç; edhe dotë të bënjë mirë, e dotë
6 të shumonjë më tepërë se atërit' e tu. Edhe
Zoti, Perëndia yt, dotë rrethpresnjë zëmërënë
t' ënde, edhe zëmërën' e farësë s' ate, që të
duash Zotinë, Perëndinë t' ënt, me gjithë zë-
mërënë t' ënde, e me gjithë shpirtinë t' ënt,
që të rrojsh.

7 Edhe Zoti, Perëndia yt, dotë sjellë gjithë
këta mallëkime mbi armiqt' e tu, edhe mbi
ata që të kanë cmir ty, të-cilëtë dotë të kenë
8 ndjekurë. Edhe ti dotë kthenesh e dot' i dë-
gjosh zërit të Zotit, edhe dotë bëjsh gjithë
porosit' e atij, të-cilatë po të urdhëronj unë
9 sot. Edhe Zoti, Perëndia yt, dotë të bënjë
të-pasurë ndë gjithë punët të duarvet të tua,
ndë pemët të barkut t' ënt, edhe ndë pemët
të bagëtivet të tua, e ndë pronjat të dheut
t' ënt, për të-mirë; sepse Zoti dotë gëzonetë
përsëri mbë ty për të-mirë, sikundrë ugëzua
10 mb' atërit' e tu, Ndë i dëgjofsh zërit të Zotit,
Perëndisë t' ënt, që të ruajsh porosit' e atij,
e urdhërimet' e atij, që janë shkruarë ndë
vivlit të këtij nomi; ndë ukthefsh te Zoti,
Perëndia yt, me gjithë zëmërënë t' ënde, e
me gjithë shpirtinë t' ënt.
11 Sepse këjo porosi që po të porosit unë
sot, nukë është shum' e-rëndë për ty, as
12 lark. Nuk' është ndë qiell, që të thuash,
Kush dotë hipënjë për ne ndë qiell, e të na
e bjerë, e të na bënjë t'a dëgjojmë, që t'a
13 bëjmë? As nuk' është tej detit, që të thuash,
Kush dotë kapërxenjë detinë për ne, e të na e
bjerë, e të na benjë t'a dëgjojmë, që t'a bëj-
14 më? Po fjala është shumë afërë teje, *mun*
ndë gojët t' ënde, e *mun* ndë zëmërët t' ënde,
që t'a bëjsh.
15 Na unë tek vura përpara teje sot jetënë

edhe të-mirënë, edhe mortjenë edhe të-ke-
16 qenë. Sepse unë po të urdhëronj sot të duash Zotinë, Perëndinë t' ënt, të ecënjç ndër udhët t' atij, edhe të ruajsh porosit' e atij, e urdhërimet' e atij, e gjyqet' e atij, që të rrojsh e të shumonesh, edhe që të të bekonjë Zoti, Perëndia yt, ndë dhet, ndë të-ci-
17 lët hyn, për të trashëguar' atë. Po ndë uktheftë andej e këtej zëmëra jote, edhe ndë mos daç të bindesh, po të humbasç udhënë, edhe të adhuronjç perëndira të-tjerë, e t' i
18 lusç, Unë po u ap juve zë sot, se me të-vërtetë dotë shuhi; nukë dotë keni dit të-gjata nd' atë dhë, ndë të-cilët, dyke kapërxyerë Jordaninë, hyn, për të trashëguar' atë.
19 Thërres qiellin' edhe dhenë, që të dëshmonjënë sot kundrë jush, se vura përpara teje jetën' edhe mortjenë, bekimnë edke mallëkimnë; përandaj sgjith jetënë, që të rrosh, ti
20 edhe fara jete; Që të duash Zotinë, Perëndinë t' ënt, që t' i dëgjojsh zërit t' atij, edhe që të ngjitesh pas atij; sepse ay është jeta jote, edhe të-gjatët' e ditvet te tua; që të rish nd' atë dhe, të-cilin' u upërbetua Zoti atërvet të tu, Abraamit, Isaakut, e Jakobit, t' u'a apë atyreve.

Krye 31.

1 Edhe Moisiu vate e i foli gjith' Israilit
2 këto fjalë. Edhe u tha atyre, Unë jam sot

një qint e njëzet vjeç; s' munt më të dal e
të hynj; edhe Zoti më tha, S' e ke për të
3 kapërxyerë këtë Jordaninë. Zoti, Perëndia
yt, ay dotë shkonjë përpara teje; ay dotë
prishnjë këta kombe që përpara teje, edhe ti
dot' i trashëgojsh ata; Joshuaj, ay dotë shko-
4 një përpara teje, sikundrë foli Zoti. Edhe
Zoti dot' u'a bënjë atyre, si u'a bëri Sihonit
e Ogut, mbretërvet t' Amoritëvet, edhe dhe-
5 ut t' atyre, të-cilëtë i prishi. Edhe Zoti dot'
i apë ata ndë dorë përpara jush, edhe dot'
u'a bëni atyre pas gjithë urdhërimevet që u
6 urdhërova juve. Bëhi burra e mirrni zëmërë, *e*
mos kini frikë, as mos utrëmpni nga ata;
sepse Zoti, Perëndia yt, ay ësht' ay që shkon
bashkë me ty; nukë dotë të lërë, as nukë
dotë heqë dorë prej teje.
7 Edhe Moisiu thirri Joshuanë, edhe i tha ati
përpara gjith' Israilit, Beju burrë e merr zë-
mërë, sepse ti dotë veç me këtë gjindje ndë
dhet, të-cilin' u upërbetua Zoti atërvet t' atyre
t' u'a apë atyre, edhe ti dot' i bëjsh ata t'a tra-
8 shëgonjënë. Edhe Zoti, ay ësht' ay që shkon
përpara teje; ay dotë jetë bashkë me ty;
nukë dotë të lërë, as nukë dotë heqë dorë
prej teje; mos ki frikë, as mos utrëmp.
9 Edhe Moisiu shkroj këtë nom, edhe u'a
dha atë ndë dorë priftërvet, të bijvet të Le-
vitit, që mbarninë arkën' e dhiatës' së Zotit,
10 edhe gjithë pleqvet të Israilit. Edhe Moisiu

i urdhëroj ata, dyke thënë, Nde funtt te *çdo* shtatë vjetve, nde kohët të vitit të lirisë, ndë
11 të-kremtet të tendë-ngrehjesë, Kur gjithë Israili dotë vinjë që të duketë përpara Zotit, Perëndisë t' ënt, nd' atë vënt që të sgjethnjë, dotë këndosh këtë nom përpara gjith' Israi-
12 lit me mënyrë që t'a dëgjonjënë. Mblith gjindjenë, burrat' e gratë e të-vegjëlitë, edhe të-huajinë t' ënt që është përbrënda dyervet të tua, që të dëgjonjënë, e të xënë, e t' i kenë frikë Zotit, Perëndisë t' ënt, edhe të vënë re të bënjënë gjithë fjalët' e këtij nomi.
13 Edhe që të dëgjonjënë djemt' e atyrë, të-cilëtë nukë kanë diturë, edhe të xënë t' i kenë frikë Zotit, Perëndisë t' uaj, gjithë dittë, sa të rroni ndë dhet, për të-cilinë po kapërxeni Jordaninë për të pushtuar' atë.
14 Edhe Zoti i tha Moisiut, Na tek po afëronenë ditt' e vdekjesë s' atë; thirrë Joshuanë, edhe dukuni ndë tendët të përmbledhjesë, që t' i ap ati urdhëret' *e mi.* Moisiu edhe Joshuaj vanë pra, e duallë ndë tendët të përmble-
15 dhjesë. Edhe Zoti uduk ndë tendët ndë shtyllë reje; edhe shtylla e resë qëndroj mbi
16 derët të tendësë. Edhe Zoti i tha Moisiut, Na ti tek dotë flesh bashkë me atërit' e tu; edhe këjo gjindje dotë ngrihetë, e dotë kurvëronjë prapa perëndirave të-huaj të-cilëtë dotë jenë ndë mest t' atyre ndë dhet, ndë të-cilët venë, edhe dotë heqënë dorë prej

meje, edhe dotë shkelnjënë dhjatënë t' ime
17 që bëra me ata. Atëhere dotë ndizetë zëmërimi im kundrë atyreve atë ditë, edhe dotë heq dorë nga ata, edhe dotë fsheh faqenë t' ime nga ata, edhe dotë prishenë; edhe dotë vinjënë mbi ata shumë të-këqia e shtrëngata, kaqë sa dotë thonë atë ditë, A nukë erthnë mbi ne këto të-këqia, sepse Perëndia ynë
18 nuk' është ndë mest t' ënë? Edhe unë me tëvërtetë dotë fsheh faqenë t' ime *nga ata* atë ditë për gjithë të-këqiatë që dotë kenë bërë,
19 sepse ukthyenë ndër perëndira të-huaj. Tashi pra shkruani për vetëhenë t' uaj këtë këngë, edhe u'a mësoni të bijvet të Israilit; vi-e-ni atë ndë gojët t' atyre, që të jetë tek unë ajo këngë *për* dëshmim kundrë të bij-
20 vet të Israilit. Sepse si t' i shpje ata nd'atë dhe, *për* të-cilinë u upërbetuashë atërvet t' atyre, *nd' atë dhe* që rrjeth qumësht e mjaltë, edhe ata si të hanë, e të ngjnjenë, e të ndrashenë, atëhere dotë kthenenë ndër perëndira të-tjerë, e dot' i lutnjën' ata, edhe dotë më poshtëronjënë, edhe dotë shkelnjënë
21 dhiatënë t' ime. Edhe si të vinjënë mbi ata shumë të-këqia e shtrëngata, këjo këngë dotë dëshmonjë përpara atyreve posi dëshmimtar; sepse nuke dotë harronetë nga goja e farës' s' atyrëve; sepse unë njoh mendimn' e atyre që po mendonenë edhe sot,

para se t' i shpje ata nd' *atè* dhet që upër-
betuashë.
22 Kështu Moisiu shkroj këtë kënkë q' atë
23 ditë, edhe u'a mësoj të bijvet të Israilit. E-
dhe i dha urdhër Joshuajt, të birit të Naviut,
dyke thënë, Bëju burrë e merr zëmërrë; se-
pse ti dotë shpjesh të bijt' e Israilit nd' atë
dhe që u upërbetuashë atyre, edhe unë dotë
jem bashkë me ty.
24 Edhe kur mbaroj së shkruari Moisiu fja-
lët' e këti nomi ndë një vivli, gjer ndë funtt,
25 Atëhere Moisiu urdhëroj Levitëritë, të-cilëte
mbaninë arkën' e dhiatës' së Zotit, dyke thë-
26 në, Merrni ketë vivli të nomit, edhe vi-e-ni
ndë brinjët të arkës' së dhiatës' së Zotit,
Perëndisë t' uaj, që të jet' atje për dëshmim
27 kundrë teje. Sepse un' e di të-pabinduritë t'
at, edhe qafënë t' ëndë t' ashpërë; na, tek
jam edhe gjall bashkë me ju sot, kini qënë
kryengritës kundrë Zotit; po sa shumë më
28 tepërë pas vdekjesë s' ime? Mblith-më-ni
gjithë pleqt' e faravet t' uaj, edhe të-parëtë
t' uaj, që të flas këto fjalë ndë veshët t'
atyreve, edhe të thërrës qiellin' edhe dhenë
29 për dëshmimtarë kundrë atyreve. Sepse e
di se pas vdekjesë s' ime dotë prishi fare,
edhe dotë priri nga udha që u urdhërova
juve; edhe dot' u gjenjënë juve të-këqia ndë
ditt të-pastajme, sepse dotë bëni atë që ësht'
e-keqe ndër syt të Zotit, kaqë sa të zëmë-
roni atë me punët' e duarvet t' uaj.

30 Edhe Moisiu foli nder veshët të gjithë përmbledhjes' s' Israilit fjalet' e kësaj kënkë gjer ndë funtt.

Krye 32.

1 Mbani vesh, ju o qiej, edhe dotë flas;
Edhe letë dëgjonjë dheu fjalët' e gojësë s' ime.
2 Mësimi im dotë pikonjë posi shiu,
Fjala ime dotë bjerë qosi vesa,
Posi pika e shiut mbi barin' e-njomë,
Edhe posi shiu i-rrefkëtë mbi barinë;
3 Sepse dotë lëçis emërin' e Zotit;
Epni madhëri Perëndisë t' ënë.
4 *Ay është* Shkëmbi, punët' e ati janë të-sosura;
Sepse gjithë udhët' e ati janë gjyq;
Perëndi besëtar, edhe tek ay s' ka paudhëri;
Ay ësht' i-drejt' e i-vërtetë.
5 Këta uprishnë; njolla e atyre nuk' është *njoll'* e të bijvet t' atij;
Këta janë një bres dredharak e i-shtrëmbërë.
6 Kështu j'a çpaguani Zotit,
O gjindje e-marrë e pa mënt?
A nuk' ësht' ay ati yt që të çpërbleu?
Ay të krioj, edhe të forcoj ty.
7 Kujto ditt' e-lashta,
Mendo vitet' e shumë brezave;
Pyet të t' atë, edhe ay dotë të rrëfenjë;

Pleqt' e tu, edhe ata dotë të thonë.
8 Kur i-Larti i të-lartëvet u dha kombevet
trashëgimn' e tyre,
Kur ndau të bijt' e njerësvet,
Vuri sinorët' e gjindjevet
Pas numërit të bijvet të Israilit.
9 Sepse pjesa e Zotit është gjindja e atij;
Jakobi është shorta e trashëgimit t' atij.
10 E gjeti atë ndë një dhe të-shkretë,
Edhe ndë shkretëtirë të-shkretuarë e me
ulërima;
E rrethoj atë rreth e rrotullë, pati kujdes
për atë,
E ruajti atë posi dritën' e syrit të ti;
11 Posi shqiponja, që folen' e asaj,
Që fluluron rrotullë përmbi të-vegjëlit' e
saj,
Dyke ndejturë krahët' e saj, i merr ata,
E i ngre ata mbi krahët të saj,
12 *Kështu* Zoti vetë i hoqi udhën' atij,
Edhe s' kishte bashkë me atë perëndi të-
huaj.
13 E hipi atë ndë më të-lartët vënde të dheut,
Edhe *ay* hëngri pronjat' e aravet;
Edhe e bëri atë të thëthinjë mjaltë prej
shkëmbit,
Edhe vaj nga guri i-ashpërë;
14 Gjalpë lopësh, e qumësht dhënsh,
Me dhjamë shqerash,
E deshësh të farës' së Bashanit, e cjepsh,

Dot' i ndes ata ndë zëmërim me një komp
të-marrë.
22 Sepse zjarr ndizetë ndë zëmërimt t' im,
Edhe djek gjer ndë te-poshtërmet *anë të*
Hadhit,
Edhe ha dhenë bashkë me pronjat' e atij,
Edhe përvëlon themelit' e malevet.
23 Dotë grumbullonj mbi ata të-keqia,
Dotë derth shëgjetat' e mia mbi ata.
24 Dotë shuhenë nga uria, dote humbenë
me thëngjij të-ndezurë,
E me prishje të-hidhurë;
Edhe dhëmbët' e bishavet dotë dërgonj
mbi ata,
Bashkë me vrerin' e shtërpinjvet të dheut.
25 Përjashta dot' i prishnjë shpata,
Edhe ndëpër dhomat tmeri,
Edhe djaloshin' edhe vashëzënë,
Foshenë që pi sisë, edhe plakunë me qi-
me të-bardha.
26 Thashë, Dot' i përndanjam ata lark,
Dotë bënjam të shuhetë kujtimi i atyre
nga mezi i njerësvet;
27 Po të mos kishnjam frikë nga zëmërimi
i armikut,
Semos gjykonjënë keq kundrështarët' e
atyre,
Semos thonë, Dora jonë ësht' e-lartë,
Edhe nuk' i bëri Zoti këto të-gjitha.
28 Sepse janë një komp që s' ka mënt,

Edhe kupëtim ndër ata nukë ka.
29 Makar të ishinë të-urtë, që t'a kupëtoninë këtë,
Edhe të mendoninë fundin' e tyre të-pastajm.
30 Një njeri qysh munt të ndiqtë një mijë veta,
Edhe dy të thyenjënë dhjetë mijë veta,
Ndë qoftë se nuk' i shiste ata Shkëmbi i atyreve,
Edhe nuk' i epte ndë dorë ata Zoti?
31 Sepse shkëmbi i atyrevë nuk' është si Shkëmbi ynë;
Edhe vetë armiqtë t' anë letë jenë gjykatës *mbë këtë.*
32 Sepse hardhia e atyreve është nga hardhia e Sodhomavet,
Edhe nga arat' e Gomorrësë;
Rrushi i atyreve është rrush helmi,
Edhe bishtakët' e atyreve janë të-hidhurë;
33 Vera e atyreve është helm dragonjsh,
Edhe i-keq vrer aspidhash.
34 A nuk' është këjo vluarë tek unë,
Vulosurë ndër thesarët të mi?
35 Të-marrëtë çpagim është t' imtë, edhe të-dhënëtë çpagim,
Ndë kohët kur të shkasë këmb' e atyreve;
Sepse dita e prishjes' s' atyre është afërë,

Bashkë me ballin' e grurit më të-mirë;
Edhe nga gjaku i rrushit pive verë.
15 Po Jeshuruni umajt, edhe hodhi me shkelm;
Umajtë, undrashe, umbushe;
Atëhere e hodhi tej Perëndinë që e bëri,
Edhe s' e nderoj Shkëmbin' e shpëtimit të tij.
16 E ndesnë ndë zili me *perëndira* të-huaj,
Me ndyrësit' e tyre e ndesnë ndë zëmërim.
17 U bënë kurban djajvet, jo Perëndisë,
Perëndirave që nuk' i dininë,
Perëndirave të-rinj të-futurë rishtazi,
Prej të-cilëvet atëritë t' uaj nukë trëmbeshinë.
18 Hoqe dorë nga Shkëmbi që të polli,
Edhe harrove Perëndinë që të gatoj.
19 Edhe Zoti pa, edhe *i* mërziti,
Sepse e zëmëruanë të bijt' e të bijat' e ati.
20 Edhe tha, Dotë fsheh faqenë t' ime nga ata,
Dotë shoh ç' dotë jetë fundi i atyreve;
Sepsë ata janë bres i-shtrëmbërë,
Bij, nde të-cilët nukë ka besë.
21 Ata më ndesnë ndë zili me atë që s' është Perëndi;
Me ndesnë ndë zëmërim me kotësirat' e tyre;
Edhe unë dot' i ndes ndë zili me ata që s' janë gjindje;

Edhe ato që kanë për të ardhurë mbi ata
çpejt dotë vinjënë.
36 Sepse Zoti dotë gjykonjë gjindjen' e tij,
Edhe dotë pendonetë për shërbëtorët' e tij,
Kur të shohë se shkoj fuqia e atyreve,
Edhe nukë *mbeti* sllaf a i-liruarë.
37 Edhe dotë thotë, Ku janë perëndirat' e
atyreve,
Shkëmbi, mbë të-cilinë kishinë pshtetjen'
e tyre,
38 Të-cilëtë haninë dhjamët' e kurbanëvet
t' atyre,
Edhe pininë verën' e dhuratavet t' atyre
prej të-pirash?
Letë ngrihenë, e let' u ndihnjënë juve,
Let' u mbronjënë juve.
39 Shihni tashi së unë, unë jam,
Edhe nukë ka perëndi përveç meje;
Unë vras, edhe ap jetë;
Unë plagos, edhe shëronj;
Edhe s' ka ndonjë që munt të shpëtonjë
nga dora ime.
40 Sepse ngre dorënë t' imë ndë qiell,
Edhe them, Unë rronj ndë jetët të jetëvet.
41 Nde prehsha shpatënë t' ime që vetëtin,
Edhe të vë dorënë t' ime ndë gjyq,
Dot' u ap çpagim armiqvet të mi,
Edhe dot' u'a çpaguanj atyreve që më
mërzitnjënë.
42 Dotë dej shëgjetat' e mia me gjak,

Edhe shpata ime dotë hajë mish,
Me gjakun' e të-vrarëvet e të-skllevërvet,
Nga kryet' e të-parëvet t' armikut.
43 Gëzohi, o kombe, me gjindjen' e atij,
Sepse dotë marrë çpagim për gjakun' e shërbëtorëvet të tij,
Edhe dot' u apë çpagim kundrështarëvet të tij,
Edhe dotë bënjë çpërblim për dhen' e tij, për gjindjen' e tij.
44 Edhe Moisiu erdhi, e foli gjithë fjalët' e kësaj kënke ndë veshët të gjindjesë, ay, edhe Joshuaj, i bir' i Naviut.
45 Edhe Moisiu mbaroj së foluri gjithë këto
46 fjalë gjithë Israilit; Edhe u tha atyre, Vini zëmërënë t' uaj ndë gjithë fjalët që po u dëshmonj juve unë sot, për të-cilatë të porositni djemtë t' uaj të kenë kujdes të bë-
47 njënë gjithë fjalët' e këtij nomi. Sepse këjo nuk' është fjal' e-kotë për ju; sepse këjo është jeta juaj, edhe me anë të kësaj fjale dotë kini dit të-gjata nd' *atë* dhe, për të-cilinë po kapërxeni Jordaninë që t'a pushtoni atë.
48 Edhe Zoti i foli Moisiut gjith atë ditë, e i tha,
49 Hipë ndë ketë mal t' Abarimit, ndë malt të Nebojt, i-cili është ndë dhet të Moabit, kundrejt Jerihosë; edhe vështro dhen' e Hanaanit, që u'a ap bijvet të Israilit për të pushtu-
50 arë; Edhe vdis nd' atë mallt, ndë të-cilët

hipën, edhe përmblidhu ndë gjindjet t' ënde,
posi yt vëlla, Aaroni, që vdiq ndë malt të
Horit, edhe upërmbloth ndë gjindjet të tij;
51 Sepse fëjyetë kundrë meje ndë mest të bij-
vet të Israilit, nder ujërat të Mëribah-Ka-
deshit, ndë shkretëtirët të Sinit; sepse nukë
më shënjtëruatë ndë mest të bijvet të Israi-
52 lit. Përandaj dot'a shohç dhenë përpara teje,
po nukë dotë hynjç atje, nd' atë dhe që u
ap të bijvet të Israilit.

Krye 33.

1 Edhe ky është bekimi, me të-cilinë Moi-
siu, njeriu i Perëndisë, bekoj të bijt' e Israi-
2 lit përpara vdekjes' së tij; Edhe tha,
Zoti erdhi nga Sinaj,
Edhe uduk ndër ata nga Seiri;
Ndriti nga mali i Faranit,
Edhe erdhi bashkë me dhjetë mijë shënj-
torë;
Nga e-djatht' e ati dolli zjarr nomi për
ata.
3 Po, e deshi gjindjenë;
Gjithë shënjtorët' e atij janë ndë dorët
t' atij;
Edhe rrininë ndë këmbët të tua;
Sicili dotë marrë nga fjalët' e tua.
4 Moisiu na urdhëroj një nom,
Trashëgim të përmbledjes' së Jakobit.
5 Edhe ishte mbret ndë Jeshurun,

Kur umblothnë të-parët' e gjindjesë,
Gjithë farat' e Israilit bashkë.
6 Rroftë Rubini, e mos vdektë;
Edhe njerëzit' e atij *mos* qofshinë të-pakë.
7 Edhe ky është bekimi i Judësë; edhe tha,
Dëgjo, o Zot, zën' e Judësë,
Edhe bjer'-e atë ndë gjindjet t' atij.
Duart' e ati qofshinë mjaft për atë;
Edhe ndih-i atij kundrë kundrështarëvet t' atij.
8 Edhe për Levitnë tha,
Thummimet' e tu edhe Urimet' e tu janë me njerinë t' ënt të-shënjtëruarinë.
Të-cilit i sgjodhe zëmërënë ndë Massah,
Edhe me të-cilinë uhëngre me fjalë ndë ujërat të Meribahësë;
9 I-cili tha për t' an' e për t' ëmënë, Nuk' e kam par' atë;
As njihtë vëllezërit' e ti,
As dintë të bijt' e ti;
Sepse ruajtnë fjalënë t' ënde,
Edhe mbajtnë dhiatënë t' ënde.
10 Dot' i mësonjënë Jakobit qjyqet' e tu,
Edhe Israilit nomnë t' ënt;
Dotë vënë thimjamë përpara teje,
Edhe *dhurata* të-gjithëdjegura mbi thëroret t' ënde.
11 Beko, o Zot, qënjen' e ati,
Edhe prit punën' e duarvet t' ati;

Thyej mezin' e atyre që ngrenë krye
kundr' atij,
Edhe t' atyreve që mërzitnjënë atë, sa të
mos ngrihenë më.
12 Për Beniamininë tha,
I-dashuri i Zotit dotë rrijë ndë siguri
përan' atij;
Zoti dot'a mbulonjë gjithë dittë,
Edhe dotë prëhetë ndë mest të krahëvet
t' atij.
13 Edhe për Josifinë tha,
I-bekuarë qoftë prej Zotit dheu i atij,
Nga të-paçëmuaratë dhurata të qiellit,
nga vesa,
Edhe nga thellësira që gjëndetë poshtë;
14 Edhe nga të-paçëmuaratë pemë të djellit,
Edhe nga të-paçëmuaratë pemë të hënëvet,
15 Edhe nga të-mirat' e-sgjedhura të ma-
levet të-moçim,
Edhe nga të-mirat' e-pacëmuara të ko-
dravet të-përjetëshme,
16 Edhe nga të-mirat' e-paçëmuara të dheut,
e nga të-mbushurit' e ati.
Edhe mirësia e atij që uduk ndë ferrët
Arthte mbi kryet të Josifit,
Edhe mbi majët të kryes' s' ati që ishte
i-çquarë nga mezi i vëllezërvet të ti.
17 Madhëria e atij është *posi* e demit t' atij
të-parëlindurë,

Edhe brirët' e ati posi brirët' e kaut t' egërë;
Me ata dot' u bjerë kombevet gjer mb' anët të dheut;
Edhe këto janë të dhjetë mijërat' e Efraimit,
Edhe këto janë mijërat' e Manassehut.
18 Edhe për Zabuloninë tha,
Gëzohu, o Zabulon, ndë te-dalët t'ënt,
Edhe ti, o Issahar, ndë tendat të tua.
19 Dotë thërresënë gjindjetë ndë malt,
Atje dotë bënjënë kurbanë drejtërie;
Sepse dotë thëthinjënë të-plotët' e detit,
Edhe thesarët' e-fshehurë të rërësë.
20 Edhe për Gadinë tha,
I-bekuarë qoft' ay që sgjeron Gadinë;
Rri posi leoneshë,
Edhe çqyen krah e krye.
21 Edhe sgjodhi pjesën' e-parë për vetëhen' e tij;
Sepse atje ishte ruajturë pjesa e nom-vënësit;
Edhe erdhi me të-parët' e gjindjesë;
Mbushi drejtërin' e Zotit,
Edhe gjyqet' e ati me Israilinë.
22 Edhe për Daninë tha,
Dani është këlysh leoni,
I-cili këcen nga Bashani.
23 Edhe për Nefhtalinë tha,
O Nefthali, i-nginjurë me hire,
E i-mblushurë me bekimin' e Zotit,

Pushto anën' e perëndimit e te mesditësë.

24 Edhe për Ashirinë tha,
I-bekuarë qoftë Ashiri me bij;
Qoft' i-priturë ndër vëllezërit te tij,
Edhe ngjyeftë këmbën' e tij ndë vaj.

25 Këpucët' e tua dotë jenë hekur' e ramë,
Edhe posi ditt' e tua dotë jetë fuqia jote.

26 Nuk' është, o Jeshurun, asdonjë si Perëndia,
I-cili hipën mbi qiejt për ndihmënë t' ëndë,
Edhe ndë madhërit të tij mbi qëndresët.

27 Perëndia i-përjetëshm është vëndi i tëndënjurit *t' ënt*,
Edhe përposh *teje* janë krahët' *e*-përjetëshm;
Edhe përzë armikunë që përpara teje,
Edhe thotë, Prish-e.

28 Edhe Israili rri ndë siguri,
Vetëmë burimi i Jakobit.
Është ndë dhe gruri e vere;
Po; qiejt' e ati pikonjënë vesë.

29 Lum ti, o Israil;
Kush është si ti, gjindje e-shpëtuarë prej Zotit,
I-cili është mburonja e ndihmësë s' ate,
Edhe kordha e madhërisë s' ate!
Edhe armiqt' e tu dotë unjënë krye ndënë ty; edhe ti dotë shkelç ndë vëndet t' atyre të-lartë.

Krye 34.

1 Edhe Moisiu hipi nga fushat' e Moabit ndë
malt të Nebojt, ndë majët të Pisgahut, që
është kundrejt Jerihosë. Edhe Zoti i rrëfeu
atij gjithë dhen' e Gjileadit, gjer ndë Dan;
2 Edhe gjithë *dhen'* e Nefthaliut, edhe dhen' e
Efraimit e të Manassehut, edhe gjithë vëndin'
3 e Judësë, gjer ndë dett prapa *atyreve;* E-
dhe mes-ditënë, edhe fushën' e grykës' së
Jerihosë, qytetit të drurëvet të hurmavët, gjer
4 ndë Zoar. Edhe Zoti i tha atij, Ky është
dheu, që i upërbetuashë unë Abraamit, Isa-
akut, e Jakobit, dyke thënë, Farësë s' ate
dot' j'a ap atë; unë të bera t'a shohç me
syt' e tu, po atje s' ke për të shkuarë.
5 Kështu Moisiu, shërbëroti i Zotit, vdik
atje, ndë dhet të Moabit, pas fjalës' së Zo-
6 tit. Edhe e varruanë ndë fushëzët, ndë dhet
të Moabit kundrejt Beth-peorit; po asdonjë
nukë di për varrin' e atij gjer mbë sot.
7 Edhe Moisiu, kur vdiq, ishtë një qint e
njëzet vjeç; nuk' uerrnë syt' e atij, as nuk'
udobëtua fuqia e atij naturake.
8 Edhe të bijt' e Israilit e qanë Moisinë
ndë fushat të Moabit tri-dhjetë dit; kështu
umbaruanë dit' e të-qarit të vajësë për Moi-
sinë.
9 Edhe Joshuaj, i bir' i Naviut, ishte plot me
frymë urtësie; sepse Moisiu kishte vënë du-

art' e tia mbi atë; edhe të bijt' e Israilit i
dëgjonin' atij, edhe bënë sikundrë e urdhë-
roj Zoti Moisinë.

10 Edhe nuk' ungrit më ndë Israilit profit
11 si Moisiu, të-cilinë Zoti e njohu faqe për
faqe ndë gjithë shënjat e çudirat, të-cilatë
e kishtë dërguarë Zoti t' i bënte ndë dhet
t' Egjyptësë, të Faraoni, e ndër gjithë shër-
12 bëtorët t' atij, e ndë gjithë dhet t' atij; E ndë
gjithë dorët të-fortë, e ndë gjithë punërat të-
mëdha e të-frikshimë, të-cilatë Moisiu bëri
ndër syt të gjithë Israilit.

Toger Spiro Ilioji
Ajutanti i Kumandatës
fuqisë Armate Tiranë
Nela rrugë te Durrësit

Shtepija ështu mbë krahë
të shtëpisë Hristo Suarasit